

REKOMANDIMI NR. 15 I POLITIKËS SË PËRGJITHSHME TË ECRI-T

PËR LUFTIMIN E GJUHËS SË URREJTJES

MIRATUAR MË 8 DHJETOR 2015

Translation co-funded
by the European Union



STRASBURG, 21 MARS 2016

Publikuar nga:
Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)
Këshilli i Evropës - 2016
Shtypur në Strasburg

@ 2016 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrjeje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Ky përkthim është prodhuar me fondet e Projektit "Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri" në kuadër të Instrumentit Horizontal II, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu, në asnjë rast nuk mund të pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI):

Duke ritheksuar rëndësinë themelore, për një shoqëri demokratike dhe pluraliste, të lirisë së shprehjes dhe mendimit, tolerancës dhe respektimit të dinjitetit të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore;

Duke rikujtuar, sidoqoftë, faktin që liria e shprehjes dhe mendimit nuk është e drejtë absolute dhe nuk duhet të ushtrohet në mospërputhje me të drejtat e të tjerëve;

Duke rikujtuar gjithashtu se trashëgimia historike e Evropës i imponon detyrimin e kujtesës, vigjilencës dhe rezistencës përballë avancimit të fenomeneve të racizmit, diskriminimit racor, diskriminimit me bazë gjinore, seksizmit, homofobisë, transfobisë, ksenofobisë, antisemitizmit, islamofobisë, anticiganizmit dhe intolerancës, ashtu si në rastin e krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit apo krimeve të luftës dhe mohimit, banalizimit, justifikimit apo legjitimitetit publik të krimeve të tilla;

Duke rikujtuar që kjo detyrë e kujtesës, vigjilencës dhe rezistencës është pjesë e pandashme e mbrojtjes dhe nxitjes së të drejtave universale dhe të pacenueshme të njeriut, që përfaqësojnë të drejtat që duhet të gëzojë çdo qenieje njerëzore;

Duke pasur parasysh mënyrat e ndryshme se si përkufizohet dhe kuptohet gjuha e urrejtjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe format e ndryshme që mund të marrë;

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, inkurajim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes

apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"¹, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

Duke pranuar që gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e mohimit publik, banalizimit, justifikimit apo legjitimitetit të krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës të konstatuara nga gjykatat, si edhe lartësimi i personave të dënuar për kryerjen e krimeve të tilla;

Duke pranuar edhe që format e shprehjes që fyejnë, tronditin apo shqetësojnë nuk përbëjnë gjuhë urrejtje vetëm mbi këtë bazë dhe se masat ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes duhet të shërbejnë për të mbrojtur individët dhe grupe personash dhe jo besime, ideologji apo fe të caktuara;

Duke pranuar që përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të pasqyrojë apo të promovojë supozimin e pajustificuar se personi që shpërndan këtë gjuhë është në njëfarë mënyrë superior ndaj një personi apo grupit të personave të shënjestruar;

Duke pranuar që gjuha urrejtjes mund të përdoret që të nxitë, apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të ketë efektin e nxitjes të të tjerëve për të kryer akte dhune, frikësimi, armiqësi apo diskriminimi ndaj atyre të shënjestruar, si dhe që kjo është një formë shprehjeje veçanërisht e rëndë;

¹ Meqë të gjitha racat e qenieve njerëzore u përkasin të njëjtit lloj, ECRI refuzon teoritë e bazuara në ekzistencën e "racave" të ndryshme. Gjithsesi, në këtë Rekomandim, ECRI përdor

termin "racë" me qëllim që personat të cilët përgjithësisht dhe gabimisht perceptohen se i përkasin një "race tjetër" të mos përjashtohen nga sfera e mbrojtjes të parashikuar në këtë Rekomandim.

Të vetëdijshëm për rreziqet e rënda që paraqet gjuha e urrejtjes për kohezionin brenda një shoqërie demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, por të ndërgjegjshëm për nevojën që kufizimet mbi gjuhën e urrejtjes të mos keqpërdoren për t'u mbyllur gojën pakicave dhe për të shtypur opozitën politike, kritikën ndaj politikave zyrtare apo besimet fetare;

Të ndërgjegjshëm se gjuha e urrejtjes ndaj grave është problem i veçantë dhe i rëndë, bazuar në seksin, gjininë dhe/se identitetin gjinor të tyre, por edhe kur ndërthuret me një apo disa karakteristika të tjera të tyre;

Duke pranuar që përdorimi i gjuhës së urrejtjes duket në rritje, sidomos përmes sistemeve të komunikimit elektronik që kontribuojnë në zmadhimin e ndikimit, por shkalla e përhapjes mbetet e paqartë për shkak se mungon raportimi sistematik dhe mbledhja e të dhënave për episodet e konstatuara dhe, si dhe duke pranuar nevojën që kjo situatë të korrigjohet, veçanërisht përmes mbështetjes së përshtatshme për personat e shënjestruar apo të prekur prej saj;

Të vetëdijshëm se padija dhe njohuritë e mangëta mediatike, ashtu si veçimi, diskriminimi, indoktrinimi dhe marxhinalizimi mund të shfrytëzohen për të inkurajuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes pa matur plotësisht natyrën e vërtetë dhe pasojat;

Duke theksuar rëndësinë e edukimit në çrënjësorjen e paragjykimeve dhe dezinformimit mbi të cilat bazohet gjuha e urrejtjes, si edhe nevojën që ky edukim t'u drejtohet veçanërisht të rinjve;

Duke pranuar faktin që një metodë thelbësore për t'u përballur me gjuhën e urrejtjes është kundërvënia dhe dënimi i drejtpërdrejtë me argumente që tregojnë qartë natyrën shkatërruese dhe të papranueshme të saj;

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

Të vetëdijshëm për kontributin e veçantë që mund të japin të gjitha format e medias, qoftë *online* apo *offline*, si në përhapjen e gjuhës së urrejtjes ashtu edhe në luftimin e saj;

Të vetëdijshëm për efektet e dëmshme të gjuhës së urrejtjes mbi personat objekt i saj, të rrezikut të veçimit dhe radikalizimit që vijnë si rrjedhojë dhe të dëmtimit të kohezionit social nëse nuk luftohet;

Duke pranuar që vetërregullimi dhe miratimi vullnetar i kodeve të sjelljes mund të jenë mjete efektive për parandalimin dhe dënimin e gjuhës së urrejtjes, të cilat duhet të inkurajohen;

Duke theksuar rëndësinë e aftësisë të personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes që të reagojnë dhe ta dënojnë me kundërnarrativa, si edhe të ngrenë padi pranë gjykatave dhe autoriteteve përgjegjëse;

Duke pranuar që sanksionet penale nuk janë në vetvete të mjaftueshme për të eliminuar plotësisht përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe nuk janë gjithnjë të përshtatshme, por, megjithatë, të bindur për nevojën për ta bërë penalisht të dënueshme në rrethana të caktuara;

Duke pasur parasysh testin bazuar në pragun prej gjashtë kriteresh të Planit të Veprimtimit të miratuar në Rabat mbi ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore apo fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës, si dhe të bindur se sanksionet penale janë të nevojshme në rrethanat ku gjuha e urrejtjes synon apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi ndaj personave që shënjestrohen;

Duke theksuar rëndësinë e mosmbështetjes së organizatave që inkurajojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe nevojën për të ndaluar ato që synojnë apo kanë pritshmëri të arsyeshme që të nxisin aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar;

Duke theksuar nevojën për hetim të shpejtë dhe efikasë në rast denoncimi të gjuhës së urrejtjes, si edhe shmangien e interpretimeve tepër kufizuese të dispozitave mbi përdorimin e saj;

Duke rikujtuar që detyrimi i parashikuar nga e drejta ndërkombëtare për të njohur si vepra penale forma të

caktuara të gjuhës së urrejtjes, edhe pse të zbatueshme për të gjithë, është vendosur për të mbrojtur pjesëtarët e grupeve vulnerabël si dhe duke konstatuar me shqetësim se kanë qenë objekt i procedimeve penale joproportionale apo se veprat penale iu janë atribuar për arsye të gabuara;

Duke rikujtuar se aktiviteti i ECRI-t fokusohet në luftimin e gjuhës së urrejtjes mbi shkaqet e "racës", ngjyrës, gjuhës, fesë, kombësisë, përkatësisë kombëtare apo etnike, identitetit, por duke pranuar që gjuha e urrejtjes mund të bazohet njësoj edhe mbi shkaqe të tjera të konstatuara tashmë, si dhe që rekomandimet në këtë tekst duhet të zbatohen për to *mutatis mutandis*;

U rekomandon qeverive të Shteteve anëtare që:

1. të ratifikojnë, nëse nuk e kanë bërë ende, **Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik, lidhur me kriminalizimin e akteve të racizmit dhe ksenofobisë përmes sistemeve kompjuterike, Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Protokollin nr. 12 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.**
2. të tërheqin çdo rezervë lidhur me nenin 4 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe me nenin 20 të Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike si edhe të njohin kompetencën e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor që të marrë dhe të shqyrtojë ankesat e individëve apo grupeve të individëve në kuptimin e nenit 14 të Konventës;
3. të angazhohen që të evidentojnë kushtet që mund të favorizojnë fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe format e ndryshme që mund të marrë, si edhe të matin shkallën dhe dëmet që shkakton, me qëllim parandalimin dhe dekurajimin e përdorimit të saj dhe reduktimin e efekteve të dëmshme dhe korrigjimin e dëmit të shkaktuar, përmes masave të mëposhtme:
 - a. të miratojnë instrumente të besueshme për këtë qëllim;
 - b. të sigurohen që të ngarkojnë autoritete publike për qëllimin e përdorimit të këtyre instrumenteve dhe që ta bëjnë këtë detyrë me korrektësi;
 - c. të sigurohen që të dhënat e mbledhura mbi gjuhën e urrejtjes të mos kufizohen vetëm te rastet që janë në sferën e veprimit të drejtësisë penale;
 - d. të sigurohen që të dhënat e mbledhura të jenë të kategorizuara siç duhet;

- e. të mbështesin monitorimin e gjuhës së urrejtjes nga shoqëria civile, organizmat e barazisë dhe institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe të promovojnë bashkëpunimit mes këtyre organeve dhe autoriteteve publike për kryerjen e kësaj detyre;
 - f. të mbështesin kërkimin shkencor që synon të analizojë shkaqet që favorizojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe formave të saj;
 - g. të përhapin rregullisht, pranë autoriteteve përgjegjëse dhe publikut të dhëna mbi shpeshhtësinë e gjuhës së urrejtjes, mbi format dhe shkaqet e saj; dhe
 - h. të bazohen në rezultatet e monitorimit dhe kërkimit shkencor për të hartuar strategji për luftimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes;
- 4. të miratojnë një përjasje të fuqishme jo vetëm për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë mbi rëndësinë e respektimit të pluralizmit dhe rreziqet që paraqet gjuha e urrejtje, por edhe për të demonstruar falsitetin e themeleve të saj dhe natyrën e saj të papranueshme, me qëllim që të parandalohet dhe të dekurajohet përdorimi i gjuhës së urrejtjes, përmes veprimeve të mëposhtme:**
- a. të promovojnë të kuptuarit më mirë të nevojës për diversitet dhe dialog në kontekstin e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës;
 - b. të promovojnë dhe të ilustrojnë respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin brenda shoqërisë;
 - c. të lehtësojnë dhe të ilustrojnë dialogun ndërkulturor; dhe
 - d. të luftojnë dezinformimin, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin;
 - e. të hartojnë programe edukative specifike për fëmijët, të rinjtë, zyrtarët publikë dhe publikun e gjerë dhe të përforcojnë kompetencat e mësuesve dhe edukatorëve që japin këtë mësimdhënie;
 - f. të mbështesin organizatat joqeveritare, organizmat e barazisë dhe institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që luftojnë kundër gjuhës së urrejtjes;
 - g. të inkurajojnë reagimin e shpejtë të figurave publike dhe veçanërisht të udhëheqësve politikë, fetarë dhe komunitarë përballë gjuhës së urrejtjes, ku jo vetëm e dënojnë, por që të orientohen drejt forcimit të vlerave që ajo kërcënon;
 - h. të inkurajojnë personat e dënuar për gjuhën e urrejtjes që të heqin dorë dhe ta dënojnë, si edhe t'i ndihmojnë këta persona që të braktisin grupet që përdorin gjuhën e urrejtjes;
 - i. të koordinojnë të gjitha përpjekjet, sipas rastit, me ato që ndërmarrin Shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

5. të ofrojnë mbështetje individuale dhe kolektive për personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të impenjohen që t'i ndihmojnë me konsulencë dhe orientime, që të kapërcejnë traumën emotive dhe ndjesinë e turpfit;
- b. të sigurojnë që të njohin të drejtat e tyre dhe të kërkojnë rivendosjen e tyre përmes procedimeve administrative, civile dhe penale, si dhe që frika, padituria, pengesat fizike dhe emotive apo mungesa e mjeteve financiare të mos i pengojë të ushtrojnë këto të drejta;
- c. të inkurajojnë dhe të lehtësojnë denoncimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga personat e shënjestruar, si edhe nga ana e dëshmitarëve;
- d. të sanksionojnë trajtimin dëmtues apo ngacmimin e çdo personi që ankohet apo denoncon përdorimin e gjuhës së urrejtjes; dhe
- e. të tregojnë solidaritet ndaj personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes dhe t'u ofrojnë mbështetje në periudhë afatgjatë.

6. të mbështetin vetërregullimin të institucioneve publike dhe private (përfshirë organet e zgjedhura, partitë politike, institucionet arsimore dhe organizatat kulturore e sportive) si mjet për luftimin e gjuhës së urrejtjes, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të inkurajojnë miratimin e kodeve të sjelljes të përshtatshme që parashikojnë pezullimin dhe sanksione të tjera për shkelje të dispozitave të tyre, si edhe kanale raportimi efektive;
- b. të inkurajojnë partitë politike që të nënshkruajnë Kartën e Partive Politike Evropiane për një shoqëri joraciste;
- c. të promovojnë monitorimin e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit;
- d. të inkurajojnë dënimin e qartë dhe të në rast shkeljeje të këtyre kodeve;
- e. të mbështetin trajnimin e përshtatshëm mbi domethënien dhe efektet negative të gjuhës së urrejtjes dhe si mund të dekurajohet përdorimi i saj; dhe
- f. të promovojnë dhe të lehtësojnë krijimin e mekanizmave të ankimit.

7. të përdorin fuqitë rregullatorë në drejtim të medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit *online* dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të sigurojnë përdorim efektiv të kompetencave ekzistuese të përshtatshme për këtë qëllim, pa anashkaluar mekanizmat vetërregullatorë;

- b. të nxisin miratimin dhe përdorimin e kodeve të sjelljes të përshtatshëm dhe/ose të kushteve të përdorimit për sa i përket gjuhës së urrejtjes, si edhe të kanaleve efektive të raportimit;
- c. të inkurajojnë monitorimin dhe dënimin e përdorimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtjes;
- d. të inkurajojnë, kur është e nevojshme, vendosjen e kufizimeve ndaj përmbajtjes, programeve të filtrimit të fjalëve dhe teknikave të tjera të këtij lloji;
- e. të stimulojnë trajnimin e përshtatshëm për redaktorët, gazetarët dhe personave të tjerë që punojnë në sektorin e medias mbi natyrën e gjuhës së urrejtjes dhe si mund të dekurajohet përdorimi i saj;
- f. të promovojnë dhe të lehtësojnë krijimin e mekanizmave të ankimit; dhe
- g. të inkurajojnë profesionistët e medias që të përforcojnë gazetarinë etike.

8. të specifikojnë fushën e veprimit dhe zbatueshmërinë e përgjegjësisë sipas të drejtës civile dhe administrative në rastin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes që synon apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të përcaktojnë përgjegjësitë e veçanta të autorëve të gjuhës së urrejtjes, të ofruesve të shërbimit të internetit, të forumeve *online* dhe shërbimeve të hostimit, të ndërmjetësve *online*, të platformave të mediave sociale, të moderatorëve të blogjeve dhe të subjekteve të tjera që zhvillojnë role të ngjashme;
- b. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohet fshirja e gjuhës së urrejtjes nga përmbajtja në internet dhe të bllokohen faqet e internetit që përdorin gjuhën e urrejtjes;
- c. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohen publikuesit e medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit *online* dhe platformat e medias sociale) që të publikojnë një lajmërim ku pranojnë se një material i publikuar prej tyre përbënte gjuhë të urrejtjes;
- d. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të ndalojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe të detyrojnë zbulimin e identitetit të autorëve;
- e. t'u garantojnë personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, organizmave të barazisë, institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe organizatave joqeveritare të interesuara në këtë çështje që të ngrenë padi që synojnë fshirjen e gjuhës së urrejtjes, që të kërkojnë publikimin e një lajmërimi ku pranohet se janë publikuar ose të ndalohet përhapja dhe të urdhërohet zbulimi i identitetit të autorëve;
- f. të ofrojnë trajnim të përshtatshëm për gjyqtarët, avokatët dhe funksionarët që merren me rastet e gjuhës së urrejtjes si dhe të lehtësojnë shkëmbimin e praktikave të mira mes tyre.

9. të pezullojnë çdo mbështetje financiare dhe çdo formë ndihme nga organet publike për partitë politike dhe organizatat që përdorin gjuhën e urrejtjes apo që nuk ndëshkojnë anëtarët e tyre që e përdorin dhe të parashikojnë, në respektim të së drejtës së organizimit, mundësinë që të ndalojnë apo të shpërbëjnë organizata të tilla, pavarësisht faktit nëse përfitojnë apo jo mbështetje nga organet publike, në rastet kur përdorimi prej tyre i gjuhës së urrejtjes ka për synim ose pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar;

10. të marrin masa të përshtatshme dhe efektive në të drejtën penale për luftimin e përdorimit, në sferën publike, të gjuhës së urrejtjes që ka për synim ose pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, kur masat e tjera më pak kufizuese nuk rezultojnë efektive dhe e drejta e shprehjes dhe e fjalës të respektohet, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të sigurojnë që këto shkelje të përcaktohen qartë dhe të mbajnë parasysht nevojën për zbatimin e një sanksioni penal;
- b. të sigurojnë që fusha e veprimit e shkeljeve të tilla të përcaktohet në mënyrë që mundëson përshtatje me zhvillimet teknologjike;
- c. të sigurojnë që procedimet për këto shkelje të ngrihen mbi baza jodiskriminuese dhe të mos përdorën për të shtypur çdo kritikë ndaj politikave zyrtare, opozitën politike apo besimet fetare;
- d. të garantojnë pjesëmarrjen efektive në procedimet përkatëse të personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes;
- e. të vendosin sanksione për shkelje të tilla, që mbajnë parasysht si pasojat e rënda të gjuhës së urrejtjes ashtu dhe nevojën për një përgjigje proporcionale;
- f. të monitorojnë efektivitetin e hetimeve që kryhen në vijim të denoncimeve dhe procedimin e autorëve, në mënyrë që të përforcohen të dy këto aspekte;
- g. të garantojnë bashkëpunim/koordinim efektiv ndërmjet policisë dhe organeve të procedimit;
- h. të ofrojnë trajnim të përshtatshëm për efektivët e agjencive ligjzbatuese, prokurorët dhe gjyqtarët që merren me rastet e gjuhës së urrejtjes si dhe të lehtësojnë shkëmbimin e praktikave të mira mes tyre;
- i. të bashkëpunojnë me Shtetet e tjera për të përballuar fenomenin e përhapjes ndërkufitare të gjuhës së urrejtjes, qoftë në format fizik apo elektronik;

RELACION SHPJEGUES

Pasqyra e lëndës

A.	Hyrje	13
B.	Përkufizime	14
	<i>Terminologjia</i>	14
	<i>Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes.....</i>	16
C.	Konteksti	19
	<i>Të dhënat.....</i>	20
	<i>Gjetjet e monitorimit kombëtar të ECRI-t</i>	20
	<i>Mësimet e të shkuarës.....</i>	21
	<i>Traktatet e Kombeve të Bashkuara.....</i>	22
	<i>Konventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.....</i>	24
	<i>Traktate të tjera Evropiane</i>	25
	<i>Standarde të tjera Evropiane dhe ndërkombëtare</i>	26
	<i>Standardet e ECRIT-t.....</i>	30
	<i>Shqetësime për zbatimin.....</i>	31
	<i>Përfundim.....</i>	32
D.	Ratifikimet, rezervat dhe rekursët.....	32
	<i>Rekomandimi 1</i>	32
	<i>Rekomandimi 2</i>	33
E.	Shkaqet dhe shtrirja	33
	<i>Rekomandimi 3</i>	33
F.	Rritja e ndërgjegjësimit dhe kundërnarrativa.....	36
	<i>Rekomandimi 4</i>	36
G.	Mbështetja për personat e shënjestruar	40
	<i>Rekomandimi 5</i>	40
H.	Vetërregullimi.....	43
	<i>Rekomandimi 6</i>	43
I.	Media dhe Interneti	46
	<i>Rekomandimi 7</i>	46
J.	Përgjegjësia administrative dhe civile.....	51
	<i>Rekomandimi 8</i>	51
	<i>Nevoja për trajnim.....</i>	54
K.	Sanksione administrative dhe të tjera kundër organizatave.....	54
	<i>Rekomandimi 9</i>	54
L.	Përgjegjësia penale dhe sanksionet.....	58
	<i>Rekomandimi 10</i>	58
	Shtojca	67

A. Hyrje

1. Ky rekomandim i politikës së përgjithshme (këtej e tutje: Rekomandimi) fokusohet në fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të saj për individët, grupe të caktuara personash dhe shoqërinë në tërësi. Këto pasoja janë vënë në dukje veçanërisht gjatë monitorimeve kombëtare të ECRI-t, por vlerësohen në plan më të gjerë. Kështu, Rekomandimi paraqet konceptin e ECRI-t se çfarë përbën gjuhë të urrejtjes dhe evidenton masat që mund dhe nevojitet të merren për të luftuar përdorimin e saj. Me këtë përjasje, Rekomandimi bazohet dhe forcon më tej aspekte të caktuara të Rekomandimeve të Politikës së Përgjithshme (RPP) nr. 5, 6, 9, 10 dhe 13, por veçanërisht të Rekomandimit nr. 7
2. Pikënisja e Rekomandimit është njohja e rëndësisë thelbësore që ka liria e shprehjes, tolerancës dhe respektimit të dinjitetit të barabartë, të cilat janë të garantuara në shumë instrumente ndërkombëtare të pranuar prej Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. ECRI është i vetëdijshëm që çdo përpjekje në trajtimin e gjuhës së urrejtjes duhet të qëndrojë brenda kufijve të cilave u nënshtrohet legjitimisht liria e shprehjes si një e drejtë e cilësuar. Gjithashtu, është i vetëdijshëm se gjuha e urrejtjes mund të marrë përgjigje efektive në disa raste pa qenë nevoja për kufizimin e lirisë së shprehjes. Për këtë arsye, Rekomandimi sugjeron që masat duhet të ndërmerren në mënyrë graduale. Në veçanti, pikëpamja se sanksionet penale nuk duhet të jenë mjeti kryesor i përpjekjeve kundër gjuhës së urrejtjes, pasqyron jo vetëm rëndësinë e respektimit të lirisë së shprehjes dhe të drejtës së organizimit, por edhe bindjen se eliminimi i kushteve që favorizojnë gjuhën e urrejtjes dhe lufta e fuqishme ndaj përdorimit të saj kanë më shumë gjasa të rezultojnë efektive në çrënjosjen përfundimtare të saj.
3. Për qëllime të Rekomandimit, përkufizimi i gjuhës së urrejtjes jepet te recitalet. Në pjesën operative, Rekomandimi fillimisht trajton nevojën për ratifikimin e traktateve të caktuara, në ato shtete ku nuk ka ndodhur, si edhe për tërheqjen e disa rezervave në dy traktate të tjera. Në të dy rastet, kjo përjasje shërben për të përforcuar përkushtimin drejt marrjes së masave të përshtatshme kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, si edhe për t'u siguruar që të mos ketë pengesa ligjore për ndërmarrjen e këtyre masave. Rekomandimi thekson se disa hapa janë të nevojshëm për të rritur të kuptuarit se kushtet që favorizojnë gjuhën e urrejtjes dhe format e ndryshme në të cilat shfaqet, sepse ky është njohur si parakusht që masat kundër përdorimit të saj të jenë efektive.
4. Masat specifike kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes që ECRI i konsideron të domosdoshme konsistojnë në: rritjen e ndërgjegjësimit publik; luftimin e çfarëdo përdorimi të gjuhës së urrejtjes; mbështetjen e atyre që vihen në shënjestër nga përdorimi i tillë; nxitjen e vetërregullimit; marrjen e masave rregullatore; vendosjen e përgjegjësisë administrative dhe civile; tërheqjen e mbështetjes ndaj organizatave të caktuara dhe ndalimin e të tjerave; dhe vendosjen e sanksioneve penale në disa rrethana shumë specifike dhe të kufizuara.
5. Rekomandimi u drejtohet qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Sidoqoftë, zbatimi efektiv i tij kërkon përfshirjen dhe angazhimin e një game të gjerë aktorësh privatë dhe joqeveritarë, përveç atyre publike. Prandaj, marrja e masave të duhura është thelbësore për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e zbatimit.

6. Megjithëse Rekomandimi merret posaçërisht me përdorimin e gjuhës së urrejtjes që është objekt i punës së ECRIT-t, dispozitat e tij shihen si të zbatueshme për të gjitha format e gjuhës së urrejtjes, si mbi shkaqet e "racës", ngjyrës, gjuhës, fesë, kombësisë, përkatësisë kombëtare apo etnike, identitetit gjinor apo orientimit seksual.

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
- a. "**avokim**" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;
 - b. "**veçim [tjetërsim]**" nënkupton tërheqjen e personit nga shoqëria ku jeton dhe e përkushtimit ndaj vlerave të saj;
 - c. "**anticiganizëm**"² nënkupton racizmin që shënjestron romët/ciganët;
 - d. "**antisemitizëm**" nënkupton paragjykimin, urrejtjen apo diskriminimin e hebrenjve si grup etnik apo fetar;
 - e. "**legjitimim**" nënkupton tolerimin, faljen apo anashkalimin e sjelljeve të caktuara;
 - f. "**krime kundër njerëzimit**" nënkupton çdo akt të renditur në nenin 7 të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare që kryhen në kuadrin e një sulmi të gjerë apo sistematik ndaj popullatës civile, duke pasur njohuri për sulmin;
 - g. "**denigrim**" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
 - h. "**diskriminim**" nënkupton çdo trajtim të diferencuar mbi bazën e shkaqeve si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombëtare ose përkatësia kombëtare apo etnike, si edhe prejardhja prindërore, besimi, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual apo karakteristika të tjera apo statusi, që nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm³;
 - i. "**gjini**" nënkupton rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që shoqëria krijon dhe i cilëson të përshtatshme për femrat dhe meshkujt⁴;
 - j. "**identiteti gjinor**" nënkupton e përvojën e brendshme dhe individuale të gjinisë që çdo person ndjen së brendshmi, që mund të mos korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, përfshirë ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes apo funksionit trupor me mënyra mjekësore, kirurgjikale, apo të tjera) si dhe forma të tjera të shprehjes së gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe manierizmat⁵;

² RPP nr. 13 e përkufizon anticiganizmin si formë specifike të racizmit, ideologji e themeluar në superioritetin racor, një formë dehumanizimi dhe racizmi institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, i cili shprehet ndërmjet të tjerash, nëpërmjet dhunës, gjuhës së urrejtjes, shfrytëzimit, stigmatizimit dhe formave më flagrante të diskriminimit;

³ RPP nr. 7 nuk mbulon shprehimisht diskriminimin mbi shkaqet e prejardhjes prindërore, besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor dhe orientimit seksual, por shkaqet e renditura nuk janë shteruese dhe dispozitat e RPP-së mund të zbatohen *mutatis mutandis* për diskriminimin bazuar në status apo karakteristika të tjera personale.

⁴ Neni 3 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

⁵ Parimet e Jogiakartës për Zbatimin e Të Drejtës Ndërkombëtare të Të Drejtave të Njeriut në lidhje me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor.

- k. "**gjenocid**" nënkupton cilindo nga aktet e renditura në nenin 6 të Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale e kryera me qëllimin për të shkatërruar plotësisht apo pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racial apo fetar;
- l. "**lartësim**" nënkupton përkujtimin apo lavdërimin e dikujt që ka bërë diçka;
- m. "**urrejtje**" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllëfi, armiqësie dhe përcmimi ndaj grupit të shënjestruar⁶;
- n. "**mohimi i Holokaustit**" nënkupton mohimin, vënien në pikëpyetje apo pranimin e dyshimeve, pjesërisht apo plotësisht, lidhur me faktin historik të gjenocidit ndaj hebrenjve gjatë Luftës II Botërore;
- o. "**homofobi**" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga homoseksualiteti apo nga njerëzit që identifikohen apo perceptohen si biseksualë, homoseksualë, lesbikë apo transgjjinorë;
- p. "**armiqësi**" nënkupton manifestimin e urrejtjes përtej thjesht një gjendjeje mendore⁷;
- q. "**nxitje**" nënkupton deklarata për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;
- r. "**islamofobi**" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga feja e Islamit apo nga myslimanët;
- s. "**marxhinalizim**" nënkupton të bësh një grup personash të ndihet apo të jetë i izoluar apo i parëndësishëm duke kufizuar rrjedhimisht pjesëmarrjen e tyre në shoqëri;
- t. "**edukimi mediatik**" nënkupton njohuritë, aftësitë dhe qëndrimin e duhur për t'u marrë me të gjitha format e medias, sidomos të kuptuarit i rolit dhe funksioneve të saj në shoqëritë demokratike si dhe aftësinë jo vetëm për të pasur vlerësim kritik për përmbajtjen mediatike, por edhe për t'u angazhuar me median për qëllime të shprehjes personale dhe pjesëmarrjes demokratike;
- u. "**stereotipizim negativ**" nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;
- v. "**radikalizim**" nënkupton procesin gjatë të cilit dikush brendëson vlera ekstreme politike, fetare apo sociale të cilat bien në kundërshtim me vlerat e një shoqërie demokratike;
- w. "**racizëm**" nënkupton besimin se shkaqet si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombësia apo prejardhja kombëtare ose etnike justifikojnë përbuzjen për një person apo grup personash, ose konceptin e superioritetit të një personi apo grupi personash⁸;
- x. "**romë**" nënkupton jo vetëm romët, por edhe sintit, kalitë, ashkalitë, "egjiptianët", manushët dhe popullata të ngjashme në Evropë, bashkë me nomadët⁹;
- y. "**seks**" nënkupton statusin biologjik të personit;
- z. "**orientim seksual**" nënkupton kapacitetin e kujtudo për tërheqje të thellë emocionale, simpatie dhe seksuale ndaj të tjerëve si dhe marrëdhëniet intime

⁶ Parimi 12.1 i Parimeve të Kamdenit për Lirinë e Shprehjes dhe Barazinë.

⁷ Raporti i Relatorit të Posaçëm për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes, A/67/357, 7 shtator 2012, pika 44.

⁸ RPP nr. 7. Edhe pse feja nuk është e përfshirë në përkufizimin e diskriminimit racial në nenin 1 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial pranon se, në dritën e parimit të ndërseksionalitetit, gjuha e urrejtjes raciste shtrihet edhe te gjuha që "shënjestron personat që u përkasin grupeve etnike të caktuara që predikojnë apo praktikojnë një fe të ndryshme nga ajo e shumicës, përfshirë shprehjet e Islamofobisë, antisemitizmit dhe manifestimeve të tjera të ngjashme të urrejtjes kundër grupeve etno-fetare, si edhe manifestimet ekstreme të urrejtjes si p.sh. nxitja e gjenocidit dhe terrorizmit". *Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes Raciste*, CERD/C/GC/35, 26 shtator 2013, pika 6.

⁹ RPP nr. 13.

- dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër apo të së njëjtës gjini apo të më shumë se një gjinie¹⁰;
- aa. "**status**" nënkupton situatën ligjore apo faktike të një personi, që përfshin jo vetëm statusin martesor, migrant apo profesional, por edhe faktorë si lindja jashtë martese, aftësia e kufizuar, pozita financiare, shëndeti, burgosja, anëtarësimi në sindikata apo organe të tjera dhe vendbanimi;
- bb. "**stigmatizim**" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;
- cc. "**transfobi**" nënkupton paragjykimet, urrejtjes apo frikën nga transeksualiteti apo personat transeksualë apo transgjinatorë, bazuar në shprehjen e identitetit të brendshëm gjinor të tyre;
- dd. "**banalizim**" nënkupton të bësh diçka të duket e parëndësishme apo e papërfillshme;
- ee. "**përgojim**" nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash;
- ff. "**dhunë**" nënkupton përdorimin e forcës fizike apo pushtetit ndaj një personi, grupi personash apo komuniteti, që rezulton apo ka shumë gjasa të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim apo privim¹¹;
- gg. "**grupe vulnerabël**" nënkupton ato grupe që janë veçanërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë sipas rrethanave kombëtare por që zakonisht janë azilkërkuesit dhe refugjatët, emigrantët dhe migrantët e tjerë, komuniteti i personave me ngjyrë dhe hebrenjve, myslimanët, romët / ciganët, pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore, si edhe personat LGBT; në veçanti, përfshin fëmijët dhe të rinjtë që u përkasin grupeve të tilla;
- hh. "**krimet e luftës**" nënkuptojnë cilindo akt të renditur në nenin 8 të Statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale; dhe
- ii. "**ksenofobi**" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga personat e vendeve apo kulturave të tjera.

Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes

8. Siç u përmend më lart, të kuptuarit e gjuhës së urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit është paraqitur në recitalet e tij. Pasqyron kontekstet, qëllimet dhe efektet e ndryshme të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe përputhet me **përgjigjet e ndryshme** që janë marrë ndaj gjuhës së urrejtjes. Kjo mbështet gjykimin që **Shtetet anëtare mund të përballen me të përmes një kombinimi të masave ekzistuese dhe të reja.**
9. Gjuha e urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes - përkatësisht, avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshterruese të karakteristikave personale apo statusit që përfshin "racën", ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose prejardhjen kombëtare apo etnike, si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

¹⁰ Parimet e Jogiakartës.

¹¹ Raporti i Relatorit të Posaçëm për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes, A/67/357, 7 shtator 2012, pika 44.

10. Në këtë Rekomandim, elementët domethënës të konceptit se çfarë është gjuha e urrejtjes, të cilat janë të ndryshëm nga ato që gjenden në shumë dokumente të tjera, lidhen me zbatimin në:
- avokimin, promovimin apo nxitjen e çfarëdo forme denigrimi, urrejtjeje apo përgojimi, si edhe ngacmimin, fyerjen, stereotipizimin negativ, stigmatizimin apo kërcënimin;
 - përdorimin që synon jo thjesht të nxitë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte; dhe
 - shkaqet që shkojnë përtej "racës", ngjyrës, gjuhës, fesë apo besimit, kombësisë, prejardhjes kombëtare apo etnike apo prejardhjes prindërore.
11. "**Shprehja**" në këtë Rekomandim përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Gjithashtu, përfshon përdorimin e një sjelljeje të caktuar - siç janë gjestet - për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.
12. Gjithashtu, format e shprehjes që janë në fushën e veprimit të Rekomandimit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, banalizimin, justifikimin apo legjitimimin për krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës, të cilat janë konstatuar nga gjykatat, si edhe lartësimin e personave për kryerjen e krimeve të tilla. Kushti që krimet në fjalë duhet të jenë konstatuar nga gjykatat synon të garantojë që të mos ngrihen pretendime mbi akuza të pabazuara se një sjellje e caktuar përbën gjuhë të urrejtjes. Për më tepër, lartësimi i personave që kanë kryer krime të tilla përbën gjuhë të urrejtjes vetëm kur i lavdërojnë pikërisht për faktin e kryerjes së këtyre krimeve dhe nuk përfshin vlerësime pozitive për çfarëdo veprimi apo aktiviteti që mund të kenë kryer personat në fjalë.
13. Njëkohësisht, Rekomandimi shprehimisht përjashton nga përkufizimi i gjuhës së urrejtjes çfarëdo forme të shprehjes si **satirën apo raportimin dhe analizën e lajmeve me bazë objektive** që thjesht fyejnë, lëndojnë apo shqetësojnë. Me këtë, Rekomandimi pasqyron mbrojtjen për këtë shprehje që Gjykata Evropiane e Të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar se mbrohet prej nenit 10 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut¹². Sidoqoftë, sillet në vëmendje fakti që Gjykata Evropiane ka pranuar edhe se nxitja e urrejtjes mund të rezultojë në fyerje, tallje apo shpifje ndaj grupeve të caktuara të popullsisë kur këto forma të shprehjes ushtrohen në mënyrë të papërgjegjshme – që nënkupton se është fyese në mënyrë të panevojshme, avokon diskriminimin apo përdor gjuhë cenuese apo poshtëruese ose i imponohet publikut në mënyrë të pashmangshme¹³ - dhe këto forma janë brenda fushës së veprimit të përkufizimit të Rekomandimit.

¹² Shih p.sh. *Jersild . Danimarkës (DhM)*, nr. 15890/89, 23 shtator 1994, *Sürek dhe Özdemir k. Turqisë [DhM]*, nr. 23927/94, 8 korrik 1999, *Ginieëski k. Francës*, nr. 64016/00, 31 janar 2006, *Alves da Silva k. Portugalisë*, nr. 41665/07, 20 tetor 2009 dhe *Fáber k. Hungarisë*, nr. 40721/06, 24 korrik 2012.

¹³ Shih p.sh. *Féret k. Belgjikës*, nr. 15615/07, 16 korrik 2007 dhe *Vejdeland dhe Të Tjerë k. Suedisë*, nr. 1813/07, 9 shkurt 2012.

14. Rekomandimi e pranon edhe që në disa raste, një veçori e veçantë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes është se mund të synojë apo ka pritshtërinë e arsyeshme që të ketë efektin e nxitjes së të tjerëve që të kryejnë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi ndaj personave të shënjestruar prej saj. Siç është e qartë nga përkufizimi më lart, **elementi i nxitjes** nënkupton ose qëllimin për të shkaktuar kryerjen e akteve të dhunës, armiqësisë apo diskriminimit, ose rrezikun imediat që këto akte të ndodhin si pasojë e gjuhës së urrejtjes të përdorur.
15. Qëllimi për të nxitur mund të konstatohet kur ekziston një thirrje e qartë nga personi që përdor gjuhën e urrejtjes drejtuar të tjerëve që të kryejnë akte të tilla, ose që nënkuptohet nga forca e gjuhës së përdorur dhe rrethanat e tjera, siç është sjellja e mëparshme e folësit. Sidoqoftë, jo gjithmonë ekzistenca e qëllimit demonstron lehtë, veçanërisht kur komentet/mesazhet duket se iu referohen fakteve të supozuara apo përcillen me gjuhë të koduar.
16. Nga ana tjetër, vlerësimi nëse ekziston rreziku i akteve përkatëse që të ndodhin duhet të merret duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes. Parasysh duhet të mbahet veçanërisht: (a) kontekstin në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes); (b) aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose komunitar); (c) natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi); (d) kontekstin e komenteve specifike (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati); (e) mediumin (formatin) e përdorur (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt"); dhe (f) natyrën e publikut (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi).
17. Rrethanat e ndryshme që lidhen me këtë vlerësim rreziku pasqyrojnë mjaft aspekte të tekstit të Planit të Veprimit të Rabatit për shprehjet që konsiderohen vepra penale¹⁴. Sidoqoftë, shkojnë më tej sesa objekti i Rekomandimit në pikën 18 të RPP nr. 7 lidhur me të drejtën penale¹⁵, në kuptimin që pranon se qëllimi për të nxitur kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë ose diskriminimit nuk është thelbësor për këtë formë veçanërisht të rëndë të gjuhës së urrejtjes. Përkundrazi, konsiderohet gjuhë e urrejtjes kur efekti që prodhon krijon pritshtërinë e arsyeshme se mund të shtyjë drejt kryerjes së akteve të tilla. Kur ky efekt është i pritshtëm nga përdoruesi i gjuhës së urrejtjes, atëherë përdorimi i saj konsiderohet i pajustificuar.

¹⁴ Për përmbajtjen e Planit të Veprimit të Rabatit, shih pikën 59 më poshtë.

¹⁵ Ligji duhet të penalizojë aktet në vazhdim kur bëhen me qëllim: a) nxitjen publike të dhunës, urrejtjes ose diskriminimit, b) fyerjen publike dhe shpifjen ose c) kërcënimin kundër një personi ose një grupi personash për shkak të racës, ngjyrës, gjuhës, besimit fetar, kombësisë ose prejardhjes kombëtare ose etnike;

18. Kjo përjasje është në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që kanë mbështetur pajtueshmërinë me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për vendosjen e sanksioneve penale për komentet aty ku duhej të ishte vlerësuar se kanë potencialin një situatë tashmë shpërthyes¹⁶.
19. Sidoqoftë, vendosja e sanksioneve me natyrë jopenale mund të jetë përgjigje më proporcionale në rrethana specifike ndaj nevojës urgjente sociale që krijon kjo gjuhë, në rastet kur gjuha e urrejtjes krijon pritsmërinë e arsyeshme se po krijon efektin e nxitjes së të tjerëve që të kryejnë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi ndaj personave të shënjestruar prej kësaj gjuhe.
20. Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes nuk kufizohet vetëm me shprehjet që **përdoren në publik**. Megjithatë, konteksti merr një rëndësi të veçantë në forma të caktuar të shprehjes, siç është mohimi, banalizimi, justifikimi apo legjitimimi i krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit apo krimeve të luftës. Për më tepër, konteksti mund të jetë faktor kyç për të përcaktuar nëse gjuha e urrejtjes krijon pritsmërinë e arsyeshme që të nxitë të tjerët të kryejnë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi ndaj personave të shënjestruar. Gjithashtu, ekzistenca e kontekstit publik është kriter thelbësor në rastet kur rekomandohet dënimi me sanksione penale i disa formave të gjuhës së urrejtjes, sepse kjo e kufizon shkallën e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes. Shprehja konsiderohet e përdorur në publik kur ndodh në një vend fizik apo përmes mjeteve elektronike të komunitetit në të cilat publiku i gjerë ka akses.
21. Gjuha e urrejtjes, siç është vënë re, lidhet me forma të ndryshme të shprehjes që u drejtohen një personi apo grup personash mbi bazën e statusit apo karakteristikave personale të personit apo grupit të personave, ndërkohë që masat ndaj saj jo detyrimisht kërkojnë vendosjen e sanksioneve penale. Sidoqoftë, gjuha e urrejtjes që merr formën e një sjelljeje që përbën vepër penale – siç është sjellja në mënyrë abuzive, ngacmuese apo fyese, atëherë mund të referohet si krim i urrejtjes¹⁷.

C. Konteksti

22. Rekomandimi është miratuar në një kohë shqetësimi në rritje brenda Shteteve anëtare, Këshillit të Evropës dhe organizatave të tjera mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes në shoqërinë e larmishme të Evropës, si edhe mbi rolin e saj në cenimin e respektit vetjak të pjesëtarëve të grupeve vulnerabël, duke dëmtuar kohezionin dhe duke nxitur të tjerët të kryejnë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi. Ky shqetësim është përforcuar nga shumë incidente ku individët, institucionet, përkujtimoret dhe pronat kanë qenë objekt sulmesh të dhunshme me një armiqësi që bazohet në një nga shkaqet e renditura më lart. Për këtë arsye, duhet të ketë një përgjigje të menjëhershme ndaj gjuhës së urrejtjes – duke përdorur spektrin e gjerë të masave që sugjeron Rekomandimi, me qëllim që të shmanget zhvillimi i qëndrimeve negative kundrejt sidomos grupeve të pakicave, sepse shkakton humbje të respektit vetjak dhe vë në rrezik integritetin e tyre në shoqërinë tradicionale.

¹⁶ Shih p.sh. *Zana k. Turqisë* [DhM], nr. 18954/91, 25 nëntor 1997 dhe *Sürek k. Turqisë (nr. 1)* [DhM], nr. 26682/95, 8 korrik 1999

¹⁷ Krimi i urrejtjes është akt kriminal motivohet nga njëanshmëria apo paragjykimi ndaj një grupi të caktuar personash; <http://hatecrime.osce.org/what-hate-crime>.

Të dhënat

23. Ende është e paqartë deri në çfarë shkalle po përdoret gjuha e urrejtjes, por përshtypja është se, siç vëren Rekomandimi, po bëhet gjithnjë e më e përhapur. Kjo paqartësi i atribuohet **mungesës së të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme** për ankesat në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, për arsye se ose ankesat nuk regjistrohen, ose nga kriteret e ndryshme që aplikojnë Shtetet anëtarë për të konstatuar përdorimin e saj. Për më tepër, është e qartë se personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes jo gjithmonë e raportojnë atë, shpesh për mungesë besimi në sistemin e drejtësisë ose nga frika e hakmarrjes ndaj tyre. Gjithashtu, duket se jo të gjitha ankesat për përdorimin e saj hetohen. Po kështu, nuk ka ndonjë monitorim sistematik të të gjitha forumeve në të cilat mund të përdoret kjo gjuhë. Sidoqoftë, nuk ka dyshim se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është më i dukshëm dhe më i përhapur si rezultat i disponueshmërisë së gjerë të formave elektronike të komunikimit. Për më tepër, përdorimi i gjuhës së urrejtjes ka qenë një tipar i dukshëm i situatës së konstatuar në shumë Shtete anëtare gjatë cikleve monitoruese të katërt dhe të pestë të ECRI-t.

Gjetjet e monitorimit kombëtar të ECRI-t

24. Kështu, ndër gjetjet e monitorimeve kombëtare të ECRI-t në këto dy cikle ka qenë publikimi në media të caktuara i përmbajtjes qartësisht raciste, lavdërimi i nazizmit dhe mohimi i Holokaustit, përdorimi i gjuhës fyese dhe stereotipet në lidhje me pakica të veçanta dhe komentet poshtëruese për personat e këtyre pakicave në rrugë, shkolla dhe dyqane, si edhe thirrje për përdorimin e dhunës ndaj tyre dhe fushata të caktuara kundër përdorimit të gjuhës së pakicave. Edhe pse patjetër që janë vërejtur raste të partive politike dhe grupeve dhe organizatave që kultivojnë dhe shpërndajnë ide raciste, ksenofobe dhe neonaziste, përdorimi i gjuhës së urrejtjes nuk ka qenë i kufizuar vetëm te ato që janë ekstremiste dhe jashtë rrymës kryesore. Kështu, **përdorimi i tonit të vrazhdë në shumë parlamente dhe nga funksionarë shtetërorë** po kontribuon në një ligjërim politik që po bëhet gjithnjë e më fyes dhe jotolerant. Disa politikanë të nivelit të lartë e kanë përshkallëzuar këtë ligjërim, duke mos u penguar që të përdorin gjuhë të urrejtjes në daljet e tyre publike. Për më tepër, janë vënë re edhe përpjekje nga figura publike për të justifikuar ekzistencën e paragjyqimeve dhe intolerancës ndaj grupeve të caktuara, gjë që vetëm rrinjës dhe rrit armiqësinë ndaj tyre.
25. Jo çdo gjuhë e urrejtjes është qartësisht e dallueshme, pasi disa publikime bazohen te **gjuha "e koduar"** për të shpërndarë paragjyqime dhe urrejtje. Për shembull, shënjestrohen minoriteti duke thënë se pjesëtarët e tyre nuk punojnë dhe që jetojnë me ndihmë ekonomike, ndërsa protestat kundër tyre raportohet se mbështeten nga "njerëzit e mirë" të vendit kur në fakt këta janë një grup neonazist. Gjithashtu, është vërejtur se shfaqja e bujshme apo e pjesshme e një aktiviteti mund të shpërndajë dezinformim dhe të provokojë frikë, duke krijuar paragjykim për personat e pakicës që shënjestrohen.
26. Është vënë re se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është një veçori e veçantë e disa formave elektronike të komunikimit, ku faqet e internetit, forumet dhe mediat sociale e kanë si qëllim parësor, ndërkohë që disa përdorin një gjuhë të tillë edhe pse hostohen nga organe shtetërore vendore¹⁸.

¹⁸ Shih, p.sh. C. Bakalis, *Urrejtja kibernetike: Çështje vazhdimisht shqetësuese për Komisionin kundër Racizmit të Këshillit të Evropës (Këshilli i Evropës, 2015).*

27. Janë vërejtur shumë raste kur nuk është marrë asnjë masë kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, ndonjëherë për shkak të objektit të kufizuar të legjislationit të brendshëm, por edhe për shkak të interpretimit të ngushtë të tij, ngurrimit për të vepruar në mungesë të një ankese specifike, mungesës së një hetimi të plotë dhe gatishmëria për të mos ngritur akuza ndaj autorëve të dyshuar. Kur janë paraqitur padi të tilla, dënimet e dhëna nuk kanë pasur tendencën për të shërbyer si parandalues domethënës në përsëritjen apo emulimin e saj. Edhe mekanizmat vetërregullatorë kanë dëshmuar se jo gjithmonë janë efektivë.
28. Për më tepër, përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe mostrajtimi i saj ka **pasoja të dëmshme** si për personat të cilëve u drejtohet, ashtu edhe për shoqërinë në tërësi.
29. Siç është parë në monitorimin kombëtar të ECRI-t, gjuha e urrejtjes jo vetëm u shkakton personave të shënjestruar shqetësim, lëndim dhe cenim të dinjitetit dhe ndjesisë së identitetit, por kontribuon që ata t'i nënshtrohen diskriminimit, ngacmimit, kërcënimeve dhe dhunës si rezultat i amplifikimit të antipatisë, armiqësisë dhe mllëfit. Qëndrime dhe sjellje mund t'i bëjë personat e shënjestruar të ndihen të frikësuar, të pasigurt dhe të kërcënuar. Në fund të fundit, përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund t'i shtyjë personat e shënjestruar që të tërhiqen nga shoqëria ku jetojnë, madje edhe të shkëputen nga vlerat e saj. Shqetësim të veçantë ngjall përdorimi i gjuhës së urrejtjes që shkakton braktisje të parakohshme të shkollës nga nxënësit të cilët më pas përballen me probleme në hyrjen në tregun e punës dhe kjo thëllon hendekun e tyre nga shoqëria.
30. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes është gjithashtu i dëmshëm për shoqërinë në tërësi. Jo vetëm që ka ndikim negativ në karakterin e ligjërimit publik, por më shumë peshë ka klima e armiqësisë dhe intolerancës që prodhon, shoqëruar me gatishmërinë për të pranuar apo për të shfajësuar diskriminimin dhe dhunën, gjë që është përçarëse, minon respektin e ndërsjellë dhe kërcënon bashkëjetesën paqësore. Pra, vihet në rrezik pluralizmi që është veçoria thelbësore për çdo shoqëri demokratike.
31. Sipas monitorimeve kombëtare të ECRI-t, personat më të prekur nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kanë qenë emigrantët, hebrenjtë, myslimanët dhe romët, por jo vetëm ata. Për më tepër, ECRI ka konstatuar gjuhë të urrejtjes të drejtuar personave për shkak të seksit, identitetit gjinor apo orientimit seksual. Edhe gratë mund të jenë objekt i formave të rënduara të gjuhës së urrejtjes, sepse bazohen jo thjesht te "raca", feja, statusi apo karakteristika të tjera personale të tyre, por edhe te seksi dhe/ose identiteti gjinor i tyre.

Mësimet e të shkuarës

32. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nuk është aspak problem aktual. Ka qenë një element domethënës në kryerjen e krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Krime të tilla kanë qenë një veçori e historisë moderne evropiane. Ngjarjet e të kaluarës mbetet një paralajmërim i rreptë për rreziqet që paraqet lejimi i fanatizmit, urrejtjes dhe paragjyqimeve që të lulëzojnë të pasfiduar. Për më tepër, ka nxitur caktimin e përkujtimeve të ndryshme si **Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Holokaustit** e shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 60/7 të 1 nëntorit 2005. Përkujtime të tilla synojnë të shkojnë përtej përkujtimit dhe të garantojnë që mësimet e së kaluarës zbatohen në të tashmen. Ashtu si Rezoluta 60/7, Rekomandimi pranon që rreziku nuk qëndron në një formë të

veçantë të intolerancës, por në çfarëdo forme që vë në dyshim gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga të gjithë pa dallime.

Traktatet e Kombeve të Bashkuara

33. Teksa kjo detyrë përkujtimi është shtysë për të ndërmarrë veprime kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, kërkesa më specifike për ta bërë këtë parashikohen në nenin 20, pika 2 të **Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike** ("Çdo avokim i urrejtjes kombëtare, raciale apo fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës ndalohej me ligj") dhe nenin 4 të **Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial** ("Shtetet palë ... (a) shpallin si vepër penale të dënueshme me ligj shpërndarjen e ideve të bazuara në superioritetin apo urrejtjen raciale, nxitjen e diskriminimit racial, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitjen e tyre kundër çdo race ose grupi personash me një tjetër ngjyrë lëkure apo prejardhje etnike, përfshirë ofrimin e ndonjë ndihme për aktivitetet raciste, përfshirë financimin e tyre; (b) shpallin të paligjshme dhe ndalojnë organizatat si dhe të gjitha aktivitetet e tyre propagandistike që promovojnë dhe nxisin diskriminim racial, si dhe njohin pjesëmarrjen në organizata ose aktivitete të tilla si një vepër penale të dënueshme me ligj; (c) nuk lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike kombëtare apo vendore që të promovojnë ose të nxisin diskriminim racial").
34. Mosarritja për t'i bërë këto kërkesa efektive apo për t'i zbatuar në mënyrë efektive ka qenë objekt i komentit negativ nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor në vëzhgimet e tyre përfundimtare lidhur me raportet periodike të paraqitura nga disa Shtete palë në përputhje me traktatet në fjalë.
35. Sidoqoftë, megjithëse kërkohen ndalime ligjore për format specifike të shprehjes të përcaktuara në nenin 20 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka nënvizuar që këto akoma duhet të jenë në përputhje me kufizimet e lirisë së shprehjes që autorizon nga neni 19, pika 3 (*Komenti i Përgjithshëm nr. 34 Neni 19: Liria e mendimit dhe e shprehjes*, CCPR / C / GC / 34, 12 shtator 2011, pikat 50-52).
36. Në të njëjtën kohë, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, duke konsideruar se "si kërkesë minimale dhe pa paragjykuar masat e mëtijshme, legjislativi gjithëpërfshirës kundër diskriminimit racial, përfshirë të drejtën civile dhe administrative, ashtu edhe të drejtën penale, është i domosdoshëm për të luftuar në mënyrë efektive gjuhën e urrejtjes raciste ", ka theksuar se "marrëdhënia midis ndalimit të gjuhës raciste të urrejtjes dhe lulëzimit të lirisë së shprehjes duhet të shihet si plotësuese dhe jo si ekuacion me rezultat zero ku prioriteti që i jepet njëres kërkon turrjen e tjetrës. Të drejtat e barazisë dhe lirisë nga diskriminimi, si dhe e drejta e lirisë së shprehjes, duhet të pasqyrohen plotësisht në ligj, politika dhe praktikë si të drejta të njeriut që mbështesin njëra-tjetrën" (*Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 Luftimi i gjuhës së urrejtjes raciste*, CERD / C / GC / 35, 26 shtator 2013, pikat 9 dhe 45). Kjo i bën jehonë deklaratës së mëparshme të Komitetit se "ndalimi i përhapjes së të gjitha ideve bazuar në epërsinë racore ose urrejtje është në përputhje me të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes" dhe se kjo e fundit "mbart detyrime dhe përgjegjësi të veçanta, të specifikuar në nenin 29, pika 2 e Deklaratës Universale, midis të cilave detyrimi për të mos shpërndarë ide raciste është i një rëndësie të veçantë" (*Rekomandimi i Përgjithshëm XV për nenin 4 të Konventës*, pika 4).

37. Në praktikën e vet gjyqësore, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka mbështetur si konsistente me lirinë e shprehjes dënimin për kundërshtimin e përfundimeve dhe vendimit të Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare të Nurenbergut në rrethanat ku deklaratat në fjalë, të lexuara në kontekst të plotë, janë të një natyre që nxisin ose forcojnë antisemite¹⁹. Në të njëjtën mënyrë ka vlerësuar se pushimi nga puna i një mësuesi për deklarata që denigrojnë fenë dhe besimin e hebrenjve dhe për thirrjen që u bënte të krishterëve që të përbuzin personat me besim dhe prejardhje hebreje si një kufizim të pranueshëm të lirisë së shprehjes për qëllimin, ndër të tjera, të mbrojtjes së të drejtës për arsimim në sistemin shkollor publik pa paragjykime, njëanshmëri dhe intolerancë²⁰. Sidoqoftë, një ankesë që pretendonte se nuk janë marrë masa efektive ndaj një incidenti të raportuar të gjuhës së urrejtjes ndaj myslimanëve u konsiderua e papranueshme, pasi ankuesi nuk vërtetoi se deklaratat patën pasoja specifike apo që pasojat ishin kërcënuese për të, kështu që nuk mund të konsiderohej viktimë e shkeljes së nenit 20, pika 2 e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike²¹.
38. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit racor ka gjetur shkelje të nenit 4 të Paktit Ndërkombëtar për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, ku ka pasur dështim për të garantuar që deklarata publike që përmbajnë ide bazuar në superioritetin racor ose urrejtje që kanë nxitur më së paku diskriminim racor, nuk mbroheshin nga e drejta e lirisë së shprehjes²². Komiteti gjeti shkelje të kësaj dispozite edhe për moshetim nëse përbënin diskriminim racor²³ disa deklarata të bëra në një transmetim radiofonik, që përgjithësonin negativisht një grup të tërë njerëzish vetëm mbi bazën e përkatësisë së tyre etnike apo kombëtare dhe shpërfillnin pikëpamjet, mendimet ose veprimet e tyre lidhur me temën e gjymtimit të organeve gjentiale femërore. Për më tepër, Komiteti konstatoi shkelje të nenit 4 për moshetim efektiv në lidhje me deklaratat mbi karakteristika negative të përgjithësuara të popullatës turke në Gjermani, përmes të cilave bëhej thirrje që t'u mohohej aksesit në shërbimet e mirëqenies sociale dhe të vendos ndalim i përgjithshëm i fluksit të emigrantëve, për shkak se gjykata konstatoi se argumenti i parë përmbante ide të superioritetit racial dhe i dyti nxiste diskriminimin racial²⁴.

¹⁹ *Faurisson k. Francës*, Komunikata nr. 550/1993, Pikëpamjet e 8 nëntorit 1996. Për këtë çështje, Komiteti për të Drejtat e Njeriut është shprehur se: "Ligjet që kriminalizojnë shprehjen e mendimeve mbi fakte historike nuk janë në përputhje me detyrimet që Pakti përcakton për Shtetet palë lidhur me respektimin e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Pakti nuk lejon ndalimin e përgjithshëm të shprehjes së një mendimi të gabuar apo interpretimi të pasaktë të ngjarjeve të kaluara. Kufizimet mbi lirinë e mendimit nuk duhet të vendosen asnjëherë dhe, për sa i përket lirisë së shprehjes, ato duhet të shkojnë përtej masës së lejuar në nenin 3 apo masës së kërkuar nga neni 20"; me kufizimet mbi lirinë e shprehjes që autorizohen nga neni 19, pika 3 (Komenti i Përgjithshëm nr. 34, neni 19: Liria e mendimit dhe e shprehjes, pika 49).

²⁰ *Ross k. Kanadasë*, Komunikata nr. 736/1997, Pikëpamjet e 18 tetorit 2000.

²¹ *A W P k. Danimarkës*, Komunikata nr. 1879/2009, Vendimi i 1 nëntorit 2013. Gjithashtu, u konstatua se nuk u arrit të vërtetohet shkelja e pretenduar e nenit 20, pika 2 në çështjen *Vassilari k. Greqisë*, Komunikata nr. 1570/2007, Pikëpamjet e 19 marsit 2009, por pati mendime të kundërta për çështjen nga Abdelfattah Amor, Ahmad Amin Fathalla dhe Bouzid Lazhari.

²² *Komuniteti Hebre i Oslos dhe Të Tjerë k. Norvegjisë*, Komunikata nr. 30/2003, Opinioni i 15 gushtit 2005.

²³ *Adan k. Danimarkës*, Komunikata nr. 43/2008, Mendimi i 13 gushtit 2010. Opinioni i 13 Gushtit 2010. Mosngridja e hetimit u konstatua edhe në çështjen *Gelle k. Danimarkës*, Komunikata nr. 34/2004, Mendimi i 6 marsit 2006 që gjen shkelje të nenit 4.

²⁴ *TBB Sindikata Turke në Berlin/Brandenburg k. Gjermanisë*, Komunikata nr. 48/2010, Mendimi i 26 shkurtit 2005.

Konventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut

39. **Konventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut** garanton lirinë e shprehjes sipas nenit 10 dhe ndalon diskriminimin lidhur me të drejta dhe liri të tjera sipas nenit 14 dhe më konkretisht të nenit 1 të Protokollit nr. 12, por nuk përmban asnjë dispozitë posaçërisht për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (dhe ish-Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut) i është dashur ta adresojë një përdorim të tillë kur ka shqyrtuar ankesa për vendosjen e sanksioneve penale dhe kufizimeve të tjera për deklarata të caktuara. Në këto raste, Gjykata ose i ka gjetur këto deklarata si tejkalim i qartë i mbrojtjes që ofron e liria e shprehjes në nenin 10 - mbështetur në nenin 17 për ndalimin e akteve dhe aktiviteteve që synojnë minimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventën Evropiane - ose ka vlerësuar nëse masat në fjalë kufizojnë ushtrimin e asaj lirie saqë të mund të konsiderohet se i shërben një qëllimi legjitim - siç është mbrojtja e të drejtave të të tjerëve - dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.
40. Përjasja e parë mund të shihet në kontekstin e sulmeve të flakta ndaj një grupi etnik apo grupi fetar²⁵ të caktuar, deklaratave antisemite²⁶, shpërndarjes së deklaratave diskriminuese racore²⁷ dhe mohimit të Holokaustit²⁸. Përjasja e dytë është ndjekur në çështjet që kanë të bëjnë me deklarata që supozohet se nxisin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen apo intolerancën. Në çështje të tilla, fokus i veçantë i është kushtuar faktorëve si situata e tensionuar politike apo sociale, thirrjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta për dhunë ose për justifikim të dhunës, urrejtjes apo intolerancës (veçanërisht në rastet e deklaratave përgjithësuese që sulmojnë ose paraqesin nën një prizëm negativ grupe të tëra etnike, fetare ose të tjerë), mënyra si janë bërë këto deklarata dhe cilësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e tyre për të rezultuar në pasoja të dëmshme. Për të gjitha rastet, Gjykata Evropiane ka qenë gjithmonë e interesuar të ndërvëprimi i të gjithë këtyre faktorëve së bashku, sesa të analizimi i izoluar i vetëm një faktori. Gjithashtu, konsiderata materiale për Gjykatën në gjykimin e çështjeve është nëse masat e marra ndaj këtyre deklaratave kanë qenë apo jo proporcionale dhe nëse janë përdorur mjete juridike civile apo të tjera për trajtimin e tyre²⁹.

²⁵ Shih *Pavel Ivanov k. Ruisisë*, nr. 35222/04, 20 shkurt 2007 dhe *Norwood k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23131/03, 16 nëntor 2004.

²⁶ Shih, p.sh., (vendimin) *Ë P k. Polonisë*, nr. 42264/98, 2 shtator 2004 dhe (vendimin) *M'Bala k. Francës*, nr. 25239/13, 20 tetor 2015

²⁷ Shih *Glimmerveen dhe Hagenbeek k. Vendeve të Ulëta*, nr. 8438/78, 11 tetor 1979. Shih edhe *Jersild k. Danimarkës* [DhM], nr. 15890/89, 23 shtator 1994, pika 35.

²⁸ Shih *Honsik k. Austrisë*, nr. 25062/94, 18 tetor 1995, *Marais k. Francës*, nr. 31159/96, 24 qershor 1996, *Lehideux dhe Isorni k. Francës* [DhM], nr. 24662/94, 23 shtator 1998, pika 47, *Garaudy k. Francës*, nr. 65831/01, 24 qershor 2003, *Éitzsch k. Gjermanisë*, nr. 7485/03, 13 dhjetor 2005 dhe *M'Bala k. Francës*, nr. 25239/13, 20 tetor 2015. Cf. *Perinçek k. Zvicrës* [DhM], nr. 27510/08, 15 tetor 2015, në të cilën Gjykata Evropiane e të Drejtave Njeriut konstatoi se nuk ka asnjë detyrim ndërkombëtar që ndalon mohimin e genocidit si i tillë dhe se dënimi penal për një mohim të tillë është i pajustificuar në mungesë të një thirrjeje për urrejtje ose intolerancë, të një konteksti me tensione të theksuara ose tone të larta historike apo ndikimit domethënës në dinjitetin e komunitetit në fjalë (pika 280).

²⁹ Shih çështjet e cituara në fundshënimet 11-13 si dhe *Hennicke k. Gjermanisë*, nr. 34889/97, 21 maj 1997, *Incal k. Turqisë* [DhM], nr. 22678/93, 9 qershor 1998, *Lehideux dhe Isorni k. Francës* [DhM], nr. 24662/94, 23 shtator 1998, *Éitzsch k. Gjermanisë*, nr. 41448/98, 20 prill 1999, *Karataş k. Turqisë* [DhM], nr. 23168/94, 8 korrik 1999, *Erdoğdu dhe İnce k. Turqisë* [DhM], nr. 25067/94, 8 korrik 1999, *Özgür Gündem k. Turqisë*, nr. 23144/93, 16 mars 2000, *Şener k. Turqisë*, nr. 26680/95, 18 korrik 2000, *Le Pen k. Francës*, nr. 55173/00, 10 maj 2001, *Osmani k. "ish-Republikës Jugosllave së Maqedonisë"*, nr. 50841/99, 11 tetor 2001, *Gunduz k. Turqisë*, nr. 59745/97, 13 nëntor 2003, *Gunduz k. Turqisë*, nr. 35071/97, 4 dhjetor 2003, *Seurot k. Francës*, nr. 57383/00, 18 maj 2004, *Maraşlı k. Turqisë*, nr. 40077/98, 9 nëntor 2004, *Dicle k. Turqisë*, nr. 34685/97, 10 nëntor 2004, *Gumus dhe të Tjerë k. Turqisë*, nr. 40303/98, 15 mars 2005, *Alinak k. Turqisë*, nr. 40287/98, 29 mars 2005, *I A k. Turqisë*, nr. 42571/98, 13 shtator 2005, *Han k. Turqisë*, nr. 50997/99, 13 shtator 2005, *Koç dhe Tambaş k. Turqisë*, nr. 50934/99, 21 mars 2006, *Aydin Tatlav k.*

41. Gjithashtu, Gjykata Evropiane ka pranuar se ekziston detyrimi pozitiv për Shtetet palë që të mbrojnë personat e shënjestruar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj çdo dhune apo cenimi të të drejtave të tyre që mund të nxiten te të tjerët³⁰. Për më tepër, sjellja diskriminuese ka aftësinë të arrijë në shkelje të ndalimit të trajtimit çnjerëzor dhe degradues sipas nenit 3 dhe një sjellje e tillë mund të konsiderohet si rrjedhojë e pasivitetit, duke përfshirë moszbatimin efektiv të dispozitave penale, përballë cenimit të të drejta dhe liri të përcaktuara në Konventën Evropiane³¹. Ndër të tjera, Gjykata Evropiane ka pranuar se mospërgjigjja për shprehjet fyese, veçanërisht në formën e stereotipizimit negativ ndaj një grupi të caktuar personash mund të përbëjë shkelje të detyrimit pozitiv sipas nenit 8 për të siguruar respektimin efektiv të së drejtës së jetës private të pjesëtari të këtij grupi për arsye se kjo shprehje përbën sulm mbi identitetin e pjesëtarit.³²

Traktate të tjera Evropiane

42. Tre **traktate të tjera të Këshillit të Evropës** trajtojnë posaçërisht përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
43. Kështu, **Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik**, për kriminalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike, u kërkon Shteteve Palë të miratojnë masa legjislative si dhe masa të tjera të nevojshme për të njohur si vepra penale shpërndarjen e materialeve raciste dhe ksenofobe nëpërmjet sistemeve kompjuterike dhe përdorimin e sistemeve kompjuterike për kërcënime dhe fyerje me motive raciste dhe ksenofobie si edhe për mohimin, minimizimin e konsiderueshëm, miratimin apo justifikimin e genocidit ose krimeve kundër njerëzimit.
44. Gjithashtu, **Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar** kërkon që shërbimet programatike të mos kenë asnjë mundësi që të nxitin urrejtjen racore. Përveç saj, **Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje** i referohet formave të dhunës ndaj grave që mund të shfaqen edhe si gjuhë e urrejtjes seksiste *online/offline*: ngacmimi seksual (neni 40) dhe përndjekja (neni 34), si dhe u kërkon Palëve të ndërmarrin masat e nevojshme legjislative apo masa të tjera.

Turqisë, nr. 50692/99, 2 maj 2006, *Erbakan k. Turqisë*, nr. 59405/00, 6 korrik 2006, *Güzel k. Turqisë* (nr. 2), nr. 65849/01, 27 korrik 2006, *Düzgören k. Turqisë*, nr. 56827/00, 9 nëntor 2006, *Yarar k. Turqisë*, nr. 57258/00, 19 dhjetor 2006, *Üstün k. Turqisë*, nr. 37685/02, 10 maj 2007, *Birdal k. Turqisë*, nr. 53047/99, 2 tetor 2007, *Nur Radyo Ve Televizyon Yayıncılığı A Ş k. Turqisë*, nr. 6587/03, 27 nëntor 2007, *Demirel dhe Ateş k. Turqisë*, nr. 10037/03, 29 nëntor 2007, *Özgür Radyo-Ses Radyo Televizyon Yayın Yapım Ve Tanıtım A.Ş. k. Turqisë*, nr. 11369/03, 14 dhjetor 2007, *Soulas dhe të Tjerë k. Francës*, nr. 15958/03, 10 korrik 2008, *Balsytw-Lideikienw k. Lituaniës*, nr. 72596/01, 4 nëntor 2008, *Leroy k. Francës*, nr. 36109/03, 2 tetor 2008, *Özer k. Turqisë*, nr. 871/08, 26 janar 2010, *Éillem k. Francës*, nr. 10883/05, 16 korrik 2009, *Dink k. Turqisë*, nr. 2668/07, 14 shtator 2010 dhe *Perinçek k. Zvicrës* [DhM], nr. 27510/08, 15 tetor 2015.

³⁰ Shih *Ouranio Toxo dhe Të tjerë k. Greqisë*, nr. 74989/01, 20 tetor 2005, *Begheluri dhe Të tjerë k. Gjeorgjisë*, nr. 28490/02, 7 tetor 2014, *Karahmed k. Bullgarisë*, nr. 30587/13, 24 shkurt 2015 dhe *Identoba dhe Të tjerë k. Gjeorgjisë*, nr. 73235/12, 12 maj 2015.

³¹ Shih *Opuz k. Turqisë*, nr. 33401/02, 9 qershor 2009.

³² *Aksu k. Turqisë* [DhM], nr. 4149/04, 15 mars 2012. Shih edhe *Kisha e Shkencologjisë k. Suedisë*, nr. 8282/78, 14 korrik 1980.

Standarde të tjera Evropiane dhe ndërkombëtare

45. Përpos detyrimeve të këtyre traktateve të posaçme që kërkojnë ose autorizojnë marrjen e masave kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes me natyrë të veçantë ose në kontekste të caktuara, ka **standarde të tjera të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare**, relevante për ndërmarrjen e masave të tillë. Këtu përfshihen Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Rekomandimet dhe Rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, raporti i Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), dy masat e Bashkimit Evropian, Deklarata e Durbanit dhe Programi i Veprimit, shtator 2001, dhe dokumenti përfundimtar i Konferencës së Rishqyrtimit të Durbanit, prill 2009, dhe Plan Veprimi i Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes për arsye kombëtare, raciale ose fetare që nxit diskriminimin, armiqësinë ose dhunën, 5 tetor 2012, si dhe raportet drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të të Drejtave të Njeriut nga Relatorët e Posaçëm të Kombeve të Bashkuara mbi format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerancës lidhur me të, mbi çështjet e pakicave dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes, si dhe nga Komisioneri i Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.
46. Shumë nga **Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Rekomandimet dhe Rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës** janë të përqendruara në format e veçanta të gjuhës së urrejtjes, siç janë nacionalizmi agresiv, ekstremizmi, neo-nazizmi, etnocentrizmi dhe urrejtja raciale. Rekomandime të tjera fokusohen në problematika që kanë si objekt grupe të veçanta personash, siç janë anticiganizmi, antisemitizmi, ksenofobia, islamofobia, homo/ transfobia, statusi i migrantëve dhe përkatësia fetare. Disa të tjerë e adresojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në kontekste të veçanta, kryesisht në kibernetikë, median *online*, diskurin politik dhe video-lojërat.
47. Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave mbi “Gjuhën e Urrejtjes” drejtuar shteteve anëtare e përkufizon këtë term se mbulon “të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen raciale, ksenofobinë, antisemitizmin ose format e tjera të urrejtjes me bazë intolerance, përfshirë intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësia ndaj pakicave, migrantëve dhe personave me origjinë emigrante”. Legjislacioni dhe praktika e shteteve anëtare rekomandohet të udhëhiqet nga një numër parimesh për luftimin e gjuhës së urrejtjes. Në mënyrë të ngjashme, Rekomandime dhe Rezoluta të tjera kanë kërkuar miratimin e masave të ndryshme administrative, civile dhe penale për të trajtuar përdorimin e një gjuhe të tillë, duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes. Gjithashtu, ata kanë synuar promovimin e një kulturë tolerance, duke theksuar rolin e formave të ndryshme të mediave në këtë drejtim³³.
48. **Raporti i Komisionit të Venecias** përqendrohej veçanërisht në nxitjen e urrejtjes fetare³⁴. Pas shqyrtimit të legjislacionit Evropian për blasfemi, fyerje fetare dhe nxitje të urrejtjes fetare, raporti arrin në përfundimin se nxitja e urrejtjes, përfshirë urrejtjen fetare, duhet të jetë objekt i sanksioneve penale dhe se do të ishte e përshtatshme të vendosej një kriter i shprehur qartë për qëllimin dhe parregullsinë. Raporti konkludon gjithashtu se nuk ishte as e

³³ Shih Shtojcën për listën e rekomandimeve dhe rezolutave.

³⁴ Raporti mbi Marrëdhënien ndërmjet Lirisë së Shprehjes dhe Lirisë së Fesë: Çështja e rregullimit dhe ndjekjes penale së blasfemisë, fyerjes fetare dhe nxitjes së urrejtjes fetare, CDL-AD(2008)026, 23 tetor 2008.

nevojshme as e dëshirueshme të krijohej një vepër penale e fyerjes fetare, d.m.th. thjesht fyerje ndaj ndjenjave fetare pa elementin e nxitjes së urrejtjes si një komponent thelbësor. Përpos të tjerash, raporti konkludon se vepra penale e blasfemisë duhet të shfuqizohet dhe të mos ri-prezantohet.

49. **Dy masat e Bashkimit Evropian** lidhur me gjuhën e urrejtjes janë Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/913/DPB i datës 28 nëntor 2008 për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal (Vendimi Kuadër) dhe Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 10 mars 2010 për koordinimin e dispozitave të caktuara të parashikuara me ligj, rregullore ose masë administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive (Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizive).
50. **Vendimi Kuadër** përcakton se “racizmi dhe ksenofobia janë shkelje të drejtpërdrejta të parimit të lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe shtetit të së drejtës, parime mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian dhe të cilat janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare". Megjithëse është e pranueshme se luftimi i racizmit dhe ksenofobisë kërkon lloje të ndryshme masash në një kuadër gjithëpërfshirës dhe nuk mund të kufizohet në çështje penale, masat që Vendimi Kuadër iu kërkon Shteteve Anëtare të marrin kufizohen në luftimin kryesisht të formave të rënda të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal. Kështu, Vendimi kërkon që nxitja e publikut për të dhunuar ose urreyer një grup personash ose një anëtar të një grupi të tillë të përcaktuar në bazë race, ngjyre, feje, prejardhje ose origjine kombëtare apo etnike të jetë e dënueshme kur kjo sjellje është e qëllimshme. Në të njëjtën mënyrë, ligji duhet të ndëshkojë çdo legjitimit të qëllimshëm publik, mohim, ose banalizim të konsiderueshëm të krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës drejtuara kundër një grupi të tillë personash ose anëtarë të një grupi të tillë kur sjellja kryhet në një mënyrë që mund të nxisë dhunë ose urrejtje ndaj tij ose atyre. Vendimi Kuadër sqaron njëkohësisht se nuk kërkon marrjen e masave në kundërshtim me parimet themelore që lidhen me lirinë e organizimit dhe lirinë e shprehjes.
51. **Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizive** iu kërkon Shteteve Anëtare të sigurojnë që shërbime të tilla të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike të mos përmbajnë nxitje të urrejtjes me bazë race, seksi, feje ose kombësie. Gjithashtu, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve mediatike të përmbushin kërkesën që komunikimet audiovizive me natyrë tregtare të mos paragjykojnë respektimin e dinjitetit njerëzor apo përfshijnë ose promovojnë diskriminimin në bazë seksi, race ose origjine etnike, kombësie, feje ose besimi, paaftësie, moshe ose orientimi seksual.
52. Në Konferencën Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racial, Ksenofobisë dhe Intolerancës së Shprehur, e mbajtur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara³⁵, në vitin 2001 u miratua **Deklarata e Durban dhe Programi i Veprimit**. Kjo pohoi se racizmi, diskriminimi racial, ksenofobia dhe intoleranca e shprehur përbënin mohim të qëllimeve dhe parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe pranoi që mosluftimi dhe mosdenoncimi i të gjitha këtyre formave të intolerancës nga të gjithë, veçanërisht nga autoritetet publike dhe politikanët në të gjitha nivelet, ishin faktor inkurajues i lartësimit të tyre. U nxit miratimi i një sërë masash, legjislative, gjyqësore, rregullore dhe administrative por edhe vetërregulluese, për të parandaluar dhe mbrojtur nga racizmi, diskriminimi racial, ksenofobia dhe intoleranca e shprehur dhe për të promovuar respektin dhe tolerancën. Në veçanti, Shtetet u nxitën “të zbatojnë sanksione ligjore, sipas ligjit përkatës ndërkombëtar të të drejtave të njeriut,

³⁵ Në përputhje me rezolutën 52/111, 18 shkurt 1998.

në lidhje me nxitjen e urrejtjes raciale përmes teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë internetin³⁶ si dhe inkurajoi denoncimin dhe mosaprovimin aktiv të transmetimit të mesazheve me natyrë raciste dhe ksenofobe nëpërmjet të gjitha mjeteve komunikative³⁷.

53. **Konferenca e Rishqyrtimit e Durbanit** u mbajt nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara³⁸ për të rishqyrtuar progresin ndaj qëllimeve të përcaktuara nga Konferenca Botërore. **Dokumenti përfundimtar i Durbanit** shpreh shqetësimin për rritjen e akteve të nxitjes së urrejtjes, të cilët kanë shënjestruar dhe prekur rëndë komunitetet raciale dhe fetare dhe personat që i përkasin pakicave raciale dhe fetare, pavarësisht nëse përfshijnë përdorimin e shtypit, medias audiovizive apo elektronike, ose ndonjë mjet tjetër, dhe e kanë zanafillën nga një larmi burimesh. Ai përcakton, "siç parashikohet në nenin 20 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ndalohet plotësisht dhe në mënyrë efektive çdo avokim i urrejtjes kombëtare, raciale ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë dhe kjo të zbatohet përmes të gjitha masave të nevojshme legjislative, politike dhe gjyqësore³⁹". Gjithashtu, nxit Shtetet të marrin masa për të luftuar qëndresën e sjelljeve ksenofobe këmbënguljen e qëndrimeve ksenofobe, stereotipizimin negativ të jo-qytetarëve, përfshirë edhe nga politikanë, zyrtarë të institucioneve për zbatimin e ligjit dhe imigracionin si dhe në media⁴⁰. Ndër të tjera, i kërkon Shteteve të ndëshkojnë veprimtari të dhunshme, raciste dhe ksenofobe të organizuara nga grupe që bazohen në ideologji neo-naziste, neo-fashiste dhe ideologji të tjera të dhunshme kombëtare dhe u bën thirrje që të deklarojnë të paligjshme dhe të ndalojnë të gjitha organizatat që e kanë bazën në ide ose teori të superioritetit të një race ose grupi personash me ngjyrë ose origjinë etnike, ose të cilët përpiqen të justifikojnë ose promovojnë urrejtjen dhe diskriminimin kombëtar, racial dhe fetar të çfarëdo forme, dhe të miratojnë masa të menjëhershme dhe pozitive, të hartuara për eliminimin e çdo nxitjeje ose akti të një diskriminimi të tillë⁴¹.
54. **Relatori i Posaçëm për format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racial, ksenofobisë dhe intolerancës së shprehur** ka theksuar centralitetin e masave legjislative në çdo strategji për luftimin dhe parandalimin e racizmit, urrejtjes etnike dhe ksenofobe në Internet dhe median sociale dhe ka inkurajuar kështu Shtetet pa një legjislacion të tillë të miratuar që ta marrin këtë në konsideratë për veprim. Relatori i Posaçëm ka theksuar, njëkohësisht, rolin e rëndësishëm të sektorit privat dhe arsimit në adresimin e sfidave të racizmit dhe nxitjes së urrejtjes raciale. Gjithashtu, Relatori i Posaçëm ka nënvizuar nevojën për të kundërshtuar partitë, lëvizjet dhe grupet ekstremiste politike si dhe për të forcuar masat për parandalimin e incidenteve për arsye raciste dhe ksenofobe në ngjarjet sportive⁴².
55. Në të njëjtën mënyrë, Relatori i Posaçëm për çështjet e pakicave ka publikuar një raport me fokus gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e urrejtjes ndaj pakicave në media. Ky raport pranon se shkaqet kryesore të urrejtjes duhet të kuptohen më mirë, por nënvizon rëndësinë e angazhimit të komuniteteve së shumicës për t'u bashkuar me pakicat e marginalizuara dhe të pafavorshme në kërkimin

³⁶ Pika 145.

³⁷ Pika 147(d)

³⁸ Në përputhje me rezolutën 61/149, 19 dhjetor 2006.

³⁹ 24 prill 2009, pika 69.

⁴⁰ Po aty, pika 75.

⁴¹ Po aty, pikat 60 dhe 99.

⁴² Shih, p.sh., raportet si vijon: A/HRC/26/50, 10 prill 2014, A/HRC/26/49, 6 maj 2014 dhe A/HRC /29/47, 13 prill 2015.

e të drejtave të njeriut, barazisë dhe dinjitetit njerëzor për të gjithë. Relatori i Posaçëm bën thirrje për legjislacionin që ndalon avokimin e urrejtjes kombëtare, raciale ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, ndërkohë që respekton plotësisht të drejtën e lirisë së shprehjes. Përveç kësaj, Relatori i Posaçëm bën thirrje për miratimin e Planit të Veprimit të Rabatit⁴³ gjatë zbatimit ose rishikimit të kuadrit ligjor vendas për gjuhën e urrejtjes. Raporti thekson nevojën e partive politike demokratike për të gjetur mjete efektive dhe strategji komunikimi për të baraspeshuar mesazhet e urrejtjes të përhapura nga forcat dhe partitë ekstremiste.

56. Relatori i Posaçëm nënvizoi se është e rëndësishme që operatorët mediatikë të mbajnë standarde të larta të gazetarisë etike, duke shmangur stereotipizimin e individëve dhe grupeve si dhe të raportojnë bazuar në fakte dhe pa anshmëri. Raporti inkurajonte ngritjen e organeve rregullatore kombëtare të pavarura, me përfaqësues edhe të pakicave, me kompetencat që të monitorojë gjuhën e urrejtjes në media, të pranojë ankesa e publikut lidhur me gjuhën e urrejtjes, të marrë dhe të mbështetë ankesat si dhe të japë rekomandime. Raporti theksonte edhe se ofruesit e shërbimeve të internetit duhet të hartojnë kushte të hollësishme të shërbimeve, udhëzime dhe procedura parajmërimi dhe fshirjeje lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e saj, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe standardet ndërkombëtare, si edhe të garantojnë zbatim transparent të këtyre politikave. Për më tepër, raporti theksonte nevojën për edukimin dhe trajnimin, ku funksionet kryesore të edukimit mediatik të përfshihen në programet shkollore të të gjitha niveleve, me fokus të veçantë mbi mjedisin *online*. Kjo masë shihej si thelbësore për t'i pajisur të rinjtë dhe të rriturit me mjete dhe burime adekuate që të zhvillojnë të menduarit kritik me qëllim që të vënë në dyshim saktësinë, paanshmërinë dhe ndikimin e informacionit që u serviret nga media⁴⁴.
57. Çështja e gjuhës së urrejtjes ka qenë fokusi i një raporti specifik të **Relatorit të Posaçëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për lirinë e mendimit dhe shprehjes**⁴⁵. Ky raport pranon se e drejta për lirinë e shprehjes mund dhe duhet të kufizohet për raste ekstreme, si në nxitjen e gjenocidit dhe nxitjen e urrejtjes, në përputhje me normat dhe parimet ndërkombëtare, por thekson gjithashtu se kjo e drejtë kontribuon në ekspozimin e dëmeve të shkaktuara nga paragjykimet, luftimi i stereotipeve negative, ofrimi i pikëpamjeve dhe kundërgjykimet alternative dhe krijimi i një atmosfere respekti dhe mirëkuptimi ndërmjet popujve dhe komuniteteve në mbarë botën. Relatori i Posaçëm thekson kështu se ligjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes duhet të interpretohen me kujdes dhe të zbatohen nga gjyqësori për të mos e kufizuar në mënyrë të tepruar lirinë e shprehjes⁴⁶. Gjithashtu, Relatori i Posaçëm nënvizon nevojën që këta ligje të plotësohen nga një grup i gjerë masash të politikave për të sjellë ndryshime të vërteta në mentalitet, perceptim dhe ligjërim. Për parandalimin e përdorimit abuziv të ligjeve për gjuhën e urrejtjes, Relatori i Posaçëm rekomandon që vetëm rastet e rënda dhe ekstreme të nxitjes së urrejtjes - që përfshijnë ashpërsi, qëllim, përmbajtje, shtrirje, gjasa ose probabilitet të dëmit që ndodh, kërcënim dhe kontekst- të ndalohen si veprat penale⁴⁷.
58. Në një raport mbi diskriminimin dhe dhunën ndaj individëve bazuar në orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor, **Zyra e Komisionerit të Lartë**

⁴³ Shih pikën 59 më poshtë.

⁴⁴ Shih A/HRC/28/64, 5 janar 2015.

⁴⁵ A/67/357, 7 shtator 2012

⁴⁶ Po aty, pika 76.

⁴⁷ Po aty.

të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar masa të ndryshme të cilat rekomandoi që të zbatohen nga Shtetet për të adresuar një dhunë të tillë. Një nga rekomandimet është ndalimi i nxitjes së urrejtjes dhe dhunës për shkaqe të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si edhe llogaridhënia e personave përgjegjës për gjuhën e urrejtjes⁴⁸.

59. Miratimi i **Planit të Veprimit të Rabatit** ishte pika kulmore e një ushtrimi të iniciuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut "për të kryer një vlerësim gjithëpërfshirës të zbatimit të legjislacionit, praktikës gjyqësore dhe politikave në lidhje me avokimin e urrejtjes kombëtare, raciale apo fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësi ose dhunë në nivel kombëtar dhe rajonal, ndërsa inkurajon respektimin e plotë të lirisë së shprehjes, siç mbrohet nga e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut⁴⁹. Plani i veprimit rekomandon që të bëhet një dallim i qartë midis (a) shprehjes që përbën vepër penale; (b) shprehjes që nuk është e dënueshme penalisht, por mund të justifikojë një padi civile ose sanksione administrative; dhe (c) shprehje që nuk shkakton ndonjë nga këto sanksione, por gjithsesi ngre shqetësime për sa i përket tolerancës, qytetërimit dhe respektimit të të drejtave të të tjerëve⁵⁰. Në lidhje me këtë, tërhoqi vëmendjen te një test me tetë kriteret përmbushja e të cilave e bën gjuhën e urrejtjes vepër penale, që ka të bëjë konkretisht me kontekstin e caktuar, folësin, qëllimi, përmbajtjen dhe formën, shtrirjen e aktit të të folurit dhe probabilitetin (përfshirë kërcënimin imediat)⁵¹. Gjithashtu, rekomandimet e tjera përfshijnë përpjekje për të luftuar stereotipizimin dhe diskriminimin negativ, për të promovuar mirëkuptimin ndërkulturor, për të trajtuar ankesat për nxitje të urrejtjes, si dhe për të garantuar mbledhje sistematike të të dhënave⁵².

Standardet e ECRIT-t

60. RPP-të e mëparshme të ECRI-t lidhur me gjuhën e urrejtjes kanë të bëjnë me:
- inkurajimin e debatit mediatik dhe promovimin e profesioneve mbi imazhin që përcjellin nga komunitetet islame dhe myslimane, si edhe mbi përgjegjësitë në këtë drejtim për të shmangur paragjykimet insistuese dhe informacionin e njëanshëm⁵³;
 - marrjen e masave për të vepruar kundër përdorimit të internetit për qëllime raciste, ksenofobe dhe antisemite⁵⁴;
 - marrjen e masave të nevojshëm për luftimin e antisemitizmit në të gjitha format e tij, përfshirë garantimin që e drejta penale në fushën e luftimit të racizmit të mbulojë edhe antisemitizmin⁵⁵;
 - marrjen e masave për luftimin e racizmit dhe diskriminimit racial në shkollë⁵⁶;
 - marrjen e masave për luftimin e anticiganizmit dhe diskriminimit të romëve⁵⁷; dhe

⁴⁸ A/HRC/29/23, 4 maj 2015, pika 78.

⁴⁹ Raporti i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut mbi seminarin e ekspertëve për ndalimin e nxitjes së urrejtjes kombëtare, raciale apo fetare, A/HRC/22/17/Add.4, 11 janar 2013, pika 6.

⁵⁰ Po aty, pika 12.

⁵¹ Po aty, Shtojca, pika 29.

⁵² Po aty, Shtojca, pikat 42-47.

⁵³ RPP nr. 5, *Luftimi i intolerancës dhe diskriminimit të myslimanëve*.

⁵⁴ RPP nr. 6, *Luftimi i përhapjes së materialeve raciste, ksenofobe dhe antisemite përmes internetit*.

⁵⁵ RPP nr. 9, *Lufta kundër antisemitizmit*.

⁵⁶ RPP nr. 10, *Luftimi i racizmit dhe diskriminimit racial në dhe përmes edukimit shkollor*.

⁵⁷ RPP nr. 13, *Luftimi i anticiganizmit dhe diskriminimit të romëve*.

- kriminalizimin e formave të caktuara të gjuhës së urrejtjes⁵⁸.
61. RPP nr. 7 rekomandon që sjelljet e mëposhtme duhet të njihen si vepra penale:
- nxitja publike e qëllimshme për dhunë, urrejtje apo diskriminim ndaj një personi apo grup personash mbi shkaqet e "racës", ngjyrës, prejardhjes kombëtare/etnike, shtetësisë, fesë apo gjuhës;
 - fyerje publike dhe shpifke e qëllimshme ndaj një personi apo grup personash; kërcënime të qëllimshme ndaj të njëjtit objektivi; shprehjet publike me qëllime raciste të një ideologjie që deklamon superioritetin apo që përçmon ose denigron një grupim personash mbi bazën, ndër të tjera, të "racës", ngjyrës, prejardhjes kombëtare/etnike, shtetësisë, fesë apo gjuhës; dhe
 - mohimi publik, banalizimi, justifikimi apo legjitimimi me qëllim racist i krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzisë dhe krimeve të luftës⁵⁹.

Shqetësime për zbatimin

62. Siç vihet re, ekziston një bazë konsoliduar në të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën rajonale për të drejtat e njeriut për të vendosur kufizime mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Sidoqoftë, ekziston edhe shqetësimi nga ana e organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve të Shteteve në lidhje me këtë çështje, që kufizime të tilla mund të jenë të pajustificueshme sepse priren **t'u mbyllin gojën pakicave dhe të shtypin opozitën politike, kritikën apo besimet fetare.**
63. Kështu, për shembull, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial, kur shqyrton raportet e Shteteve Palë në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e Të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, rekomandon që të ndryshohen përkufizimet në legjislacion kundër "ekstremizmit" në mënyrë që të enë formulim të qartë dhe të saktë, duke përfshirë vetëm akte dhune, nxitjen e akteve të tilla dhe pjesëmarrjen në organizata që promovojnë dhe nxisin diskriminim racial, sipas nenit 4 të kësaj Konvente. Po kështu, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Njeriut ka shprehur shqetësimin se një legjislacion i tillë mund të interpretohet dhe të zbatohet në një mënyrë jashtëzakonisht të gjerë, pra duke shënjestruar apo dëmtuar mbrojtësit e të drejtave të njeriut që promovojnë eliminimin e diskriminimit racial apo mbrojtjen, apo mbrojtjen e individëve dhe shoqatave ndaj zbatimit arbitrar të tij. Përveç kësaj, shqetësime në lidhje me përdorimin e kufizimeve ndaj gjuhës së urrejtjes për të shtypur kritikën dhe për të legjitimuar kritikën politike janë ngritur edhe nga ECRI dhe të tjerë siç është Relatori i Posaçëm për promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes dhe Komiteti Këshillimor të Konventës Kuadër për Pakicat Kombëtare.
64. Mes tyre ekziston edhe një shqetësim tjetër që **ndalimet e gjuhës së urrejtjes mund të jenë përdorur në mënyrë disproporcionale ose të pajustificueshme** ndaj atyre që vetë këto ndalime duhet të mbrojnë, si edhe theksohet rëndësia e shmangies së çdo keqpërdorimi të saj. Baza e këtij shqetësimi mund të duket sa për të bërë përshtypje më tepër sesa si një

⁵⁸ RPP nr. 7, *Legjislacioni i brendshëm për luftimin e racizmit dhe diskriminimit racial*.

⁵⁹ Ky formulim është ndjekur sidomos në RPP nr. 9, vetëm se i referohet "identitetit apo prejardhjes hebreje" sesa "racës", "ngjyrës", etj. dhe përfshin mohimin publik, banalizimin, justifikimin apo legjitimimin e Shoah-së dhe blasfeminë dhe përdhosjen e pronave dhe monumenteve hebreje, me qëllim antisemit. Gjithashtu, të dy këto RPP rekomandojnë që të ketë vepra penale për përhapjen apo shpërndarjen publike, riprodhimin apo ruajtjen me qëllim përhapjen apo shpërndarjen publike të materialeve të shkuara, me imazhe apo forma të tjera, të cilat përmbajnë shprehje të veprave penale që përcaktohen në testin më lart, si edhe për krijimin apo udhëheqjen e një grupi që promovon racizmin apo antisemitizmin, apo mbështetjen e këtij grupi dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e tij me qëllim që të kontribuojë në veprat penale të përcaktuara në tekstin më lart.

shqetësim që të mund të vërtetohet, për shkak se raportimi fokusohet vetëm në disa procedurave të caktuara dhe mungojnë të dhënat gjithëpërfshirëse. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme që të gjitha veprimet kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes të jenë të bazuara dhe të mos ndërmerren kurrë mbi baza selektive ose arbitrare, prandaj, Rekomandimi është i qartë se çdo ndalim penal i gjuhës së urrejtjes duhet të ketë zbatueshmëri të përgjithshme dhe të mos synojë vetëm disa kategori autorësh.

Përfundim

65. Masat e ndryshme të parashikuara në këtë Rekomandim janë të tilla që ose kërkohen në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, ose lejohet të merren që të garantohet natyra universale e të drejtave të njeriut.

D. Ratifikimet, rezervat dhe rekursat

Rekomandimi 1

Ratifikimi i traktateve

66. Tre traktatet që propozohen në Rekomandimin 1 duhet të ratifikohen nga ato Shtete anëtare që ende nuk e kanë bërë këtë gjë, siç rekomandohet edhe në RPP nr. 13 dhe 14, që nënkupton marrjen e angazhimeve për të miratuar masa të ndryshme që janë thelbësore për përmbushjen e synimeve të Rekomandimit.
67. Masat e kërkuara nga **Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik** kanë të bëjnë me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe të kryera përmes sistemeve kompjuterike. Ata tashmë janë trajtuar më lart⁶⁰ dhe janë të rëndësishme për shkak se fokusohen posaçërisht te gjuha e urrejtjes. Megjithatë, po aq të rëndësishme janë edhe masat që kërkohen nga dy traktatet e tjera - **Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** (Konventa Kuadër) dhe **Protokolli nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (Protokolli nr. 12).
68. Kështu, Konventa Kuadër jo vetëm që kërkon garantimin e të drejtës së barazisë para ligjit dhe mbrojtjes së barabartë të ligjit për personat që u përkasin pakicave kombëtare, por kërkon edhe (a) inkurajimin e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor; (b) promovimin e respektit të ndërsjellë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit; dhe (c) mbrojtjen e personave që mund të jenë objekt i kërcënimeve ose akteve të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës si rezultat i identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Për më tepër, Protokolli nr. 12 forcon ndalimin e diskriminimit në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke kërkuar që të garantohet pa dallim gëzimi i çdo të drejte të përcaktuar me ligj dhe jo vetëm të drejtat dhe liritë e posaçme të garantuara tashmë nga ky instrument.
69. Sidoqoftë, Rekomandimi 1 nuk ka përfshirë Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar në listën e traktateve që duhet të ratifikohen, pasi kërkon përditësim të Protokollit që të mbajë parasysh zhvillimet në fushën e medias që nga miratimi i tij. Prandaj, ratifikimi i traktatit të pandryshuar do të ishte i kotë.

⁶⁰ Shih pikën 43 më lart.

Rekomandimi 2

Tërheqja e rezervave

70. Pika e parë në këtë rekomandim që ka të bëjë me tërheqjen e rezervave ndaj të drejtave për lirinë e tubimit, organizimit dhe shprehjes në nenin 4 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Të gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe të Nenit 20 të Paktit Ndërkombëtar për Të drejtat Civile dhe Politike, bëhet për shkak të shqetësimit se këto rezerva mund të pengojnë veprimet efektive për të ndaluar organizatat që promovojnë ose nxisin racizmin dhe diskriminim racial, propagandën e luftës dhe avokimin e urrejtjes kombëtare, raciale apo fetare.

Parashikimi i të drejtës së rekursit

71. Pika e dytë në rekomandimin 2 - pranimi i **kompetencës së Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racial** për të marrë dhe shqyrtuar njoftime nga individë ose grupe individësh që pretendojnë se janë viktimat të shkeljes së të drejtave të parashikuara në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e Të gjitha Formave të Diskriminimit Racial – vjen si garanci ndaj mosadresimit të gjuhës së urrejtjes në nivel kombëtar, pasi një pranim i tillë u lejon pastaj të kontestohen në nivel ndërkombëtar.

E. Shkaqet dhe shtrirja

Rekomandimi 3

72. Objekti i veçantë i kësaj rekomandimi është se duhet të merren hapa të duhur për të vendosur gamën e rrethanave që mund të shkaktojnë përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe shfaqjen e formave të ndryshme të saj, si edhe të matet shtrirja dhe ndikimi i kësaj gjuhe. Konsiderohet thelbësore nevoja për të dresuar këtë fenomen, për shkak se ka një kuptueshmëri të cinguar të tij dhe mungon qartësia se deri ku shtrihet dhe çfarë efektesh prodhon. Pa kuptuar mirë këtë, nuk mund të ndërmerren veprimeve efektive për dekurajimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe për zvogëlimin dhe ndreqjen e dëmeve që shkakton përdorimi i saj. Përmirësimi i kuptueshmërisë dhe qartësimi mbi këto dy elementë, kërkon krijimin dhe përdorimin e instrumenteve të ndryshme.
73. Mund dhe të ndodhë që disa kushte të jenë veçanërisht të favorshme për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe formave të veçanta të saj. Kushte të tilla zakonisht lidhen me faktorë ekonomikë, politikë dhe sociale, si edhe me përcjelljen pa reflektim të stereotipizimit negativ dhe paragjyqimeve nga njëri brez në tjetrin. Sidoqoftë, nuk duket se ekzistenca e këtyre kushteve, qoftë bashkërisht apo të kombinuar, rezulton gjithmonë në përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Zhvillimi i hulumtimit

74. Për të kuptuar shumë më mirë si kushtet që kërkon gjuha e urrejtjes dhe mënyrat specifike në të cilat shprehet, ekziston nevoja që **projektet e duhura hulumtuese** të fokusohen te rrethanat aktuale dhe konsideratat pse kushte individuale të njëjta rezultojnë në nivele të ndryshme reagimi. Hulumtime të tilla mund të zhvillohen në formën e sondazheve dhe studimeve në terren si dhe duhet të kenë natyrë krahasuese aty ku është e mundur.
75. Nuk është e nevojshme që hulumtimi mbi kushtet e favorshme për përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe format e ndryshme të saj, të kryhet nga vetë autoritetet publike. Sidoqoftë, është e rëndësishme që ato jo vetëm të japin

mbështetjen e nevojshme që kjo të ndodhë, por edhe të sigurohen që të bëhet një hulumtim i tillë. Për më tepër, hulumtimi krahasues mund të realizohet më së miri përmes bashkëpunimit të disa subjekteve të ndryshme hulumtuese në Shtete anëtare të ndryshme. Bashkëpunimi i tyre në këtë drejtim duhet të inkurajohet dhe të lehtësohet në mënyrë të veçantë.

Mangësitë në mbledhjen e të dhënave

76. Megjithëse monitorimi i ECRI-t dhe studime të tjera kanë konstatuar raste të veçanta të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, ndonjëherë përfundimi apo nënkuptimi impresionist se ky fenomen po pëson rritje, bën që panorama aktuale lidhur me shtrirjen e kësaj gjuhe të mbetet e paqartë. Kjo është një rrjedhojë e konsideratave të ndryshme të vërejtura në monitorim, veçanërisht: mënyrat e ndryshme në të cilat përkufizohet gjuha e urrejtjes (ku të përbashkët kanë vetëm shkaqet e karakteristikave personale dhe statusit); përjasjet e ndryshme që autoritetet përdorin për klasifikimin e saj; kufizimi i mbledhjes së të dhënave vetëm në ato raste përdorimi i gjuhës së urrejtjes potencialisht përbën vepër penale; mosevidentimi apo mosraportimi pranë autoriteteve publike përgjegjëse i rasteve të veçanta ku është përdorur gjuha e urrejtjes; dhe herë pas here, ka një mungesë të plotë mbledhje të dhënash në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, ose mospublikimin e plotë apo të pjesshëm të të dhënave të mbledhura.
77. Në disa raste, mosmbledhja e të dhënave pasqyron shqetësimin se kjo mund të mos jetë në pajtim me detyrimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Për më tepër, jo të gjitha të dhënat e mbledhura mbahen parasysht siç duhet. Kjo vlen sidomos me rezultatet e monitorimit nga shoqëria civile. Për më tepër, jo gjithmonë të dhënat e mbledhura analizohen me qëllime që të nxirren përfundime lidhur me përgjigjen që kërkon përdorimi i gjuhës së urrejtjes. Përfundimisht, duhet të garantohet që të dhënat e mbledhura të shkojnë përtej thjesht konstatimit të shkallës në të cilën përdoret gjuha e urrejtjes, duke vlerësuar edhe ndikimet te personat që janë objekt i saj.

Kërkesat për mbledhjen e të dhënave

78. **Mbledhja e të dhënave dhe analiza** në lidhje me përdorimin aktual të gjuhës së urrejtjes duhet të bëhen mbi një bazë shumë më të qëndrueshme, sistematike dhe gjithëpërfshirëse.
79. Kjo do të thotë se, së pari, të dhënat duhet të mblidhen në të gjitha rastet, duke iu referuar të kuptuarit se çfarë përbën gjuhë të urrejtjes për qëllimet e Rekomandimit.
80. Së dyti, garancitë për mbrojtjen e të dhënave nuk duhet të evokohen për të kufizuar ose përjashtuar mbledhjen e të dhënave mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Sigurisht, këto garanci nuk ndalojnë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për personat e identifikueshëm, kur: kjo është për një qëllim të ligjshëm; të dhënat janë të përshtatshme, relevante dhe jo të tepërta për atë qëllim; janë të sakta dhe azhurnohen; dhe nuk mbahen më gjatë sesa duhet. Për më tepër, garancitë për mbrojtjen e të dhënave nuk gjejnë asnjë zbatim të të dhënave që anonimizohen për të pamundësuar identifikimin e ndonjë individi të prekur nga gjuha e urrejtjes; kjo duhet të vlejë për të gjitha analizat statistikore mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
81. Së treti, të dhënat që mblidhen nuk duhet të kufizohen vetëm në rastet kur kjo gjuhë pretendohet ose është konstatuar se përbën vepër penale, sepse me këtë përjasje përjashtohet shumica e situatave ku gjuha e urrejtjes përdoret dhe duhet trajtuar.

82. Së katërti, autoritetet publike përkatëse duhet të kenë shprehimisht përgjegjësinë për të raportuar në format statistikor të gjitha ankesat e rasteve në të cilat pretendohet përdorimi i gjuhës së urrejtjes ka shkelur ligjin administrativ, civil ose penal, si dhe rezultatin e çdo veprimi të ndërmarrë në lidhje me ankesa të tilla.
83. Së pesti, mbledhja e të dhënave nuk duhet të kufizohet në regjistrimin e ankesave për përdorimin e gjuhës së urrejtjes, por duhet të përfshijë të konstatohet edhe përvojën e atyre që preken nga kjo gjuhë dhe mund të ngurrojnë të denoncojnë një fakt të tillë. Monitorimi, qoftë i kryer në kohë reale ose në mënyrë retrospektive përmes analizës së materialit të arkivuar ose duke analizuar ligjërimit dhe përmbajtjen⁶¹, mund të bëhet më së miri nga shoqëria civile dhe organet e barazisë/ institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, me këtë të fundit që autorizohet të veprojë brenda detyrave funksionale dhe prioriteteve specifike, nëse nuk ka ndodhur tashmë.
84. Sidoqoftë, monitorimi i tillë ka nevojë për mbështetje të duhur, që mund të kërkojë financim qoftë për analistët apo harduerin dhe softuerin e nevojshëm për të kryer teknika të automatizuara të analizës. Organet e barazisë/ institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e tjera përgjegjëse duhet të jenë në gjendje të realizojnë apo të porositin anketime të personave që mund të jenë shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, me qëllim që të përcaktohet shpeshësia e saj, sidomos në rrethanat kur ky fenomen mund të mos jetë menjëherë i evidentueshëm apo lehtësisht i raportueshëm. Shembuj të mirë janë Anketa Evropiane për Krimin dhe Sigurinë⁶² dhe anketa e realizuar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore posaçërisht në lidhje me personat lesbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinjorë⁶³. Anketa të tilla mund të realizohen edhe për të përcaktuar pasojat e kësaj gjuhe te personat e këtyre grupeve, sidomos mbi mundësinë që ata të ndiejnë frikë, izolim dhe turp, të tërhiqen nga shoqëria apo të ngurrojnë apo të frenohen për ta denoncuar rastin⁶⁴.
85. Së gjashti, është e rëndësishme që të dhënat që mbledhen me këto teknika të ndryshme të sistemohen dhe analizohen siç duhet, duke përdorur për këtë qëllim teknologji përpunimi moderne, në mënyrë që të kuptohet shkalla e përgjithshme e fenomenit. Në veçanti, sa herë që të dhënat mbledhen nga dy apo më shumë burime dhe bashkohen apo "agregohen" në një format statistikor të anonimizuar për të ilustruar incidencën e përdorimeve të veçanta të gjuhës së urrejtjes - siç janë ato në kundërshtim me ligjin administrativ, civil ose penal - duhet prapë të mund të zërthehen në njësi informacioni më të vogla në mënyrë që të identifikohen si problematikat lidhur me grupe të veçanta (si aftësia e kufizuar, gjinia, feja apo besimi), ashtu edhe faktorët (si lloji i përdoruesit apo vendndodhja e përdorimit). Kjo do ta bënte më të dukshme shfaqjen e prirjeve të reja të gjuhës së urrejtjes, si dhe brishtësinë e personave të caktuar që shënjestrohen prej saj. Këto konsiderata mund të faktorizohen më pas me përgjigje/masa që miratohen për të trajtuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

⁶¹ Shih B. Lucas, *Metodat për monitorimin dhe hartëzimin online të gjuhës së urrejtjes*, GSDRC Helpdesk Research Report 1121, 2014.

⁶² Shih J. van Dijk, J. van Kesteren dhe P. Smit, *Viktimizimi Penal në Perspektivën Ndërkombëtare: Gjetjet kryesore nga vërtetimet 2004-2005 dhe BE ICS*, 2007.

⁶³ Si p.sh. ngacmimi i zbuluar përmes Agjencisë së Bashkimit Evropian për Të Drejtat Themelore – anketa BE LGBT – Bashkimi Evropian, anketa për personat lesbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinjorë – Rezultatet kryesore, 2014.

⁶⁴ "Raportet për përjetimin subjektiv të diskriminimit janë të vjera si një tregues, sidomos kur vlerësohen mbi bazën e informacioneve të tjera, si statistikave të punësimit, të dhënat policore, ankesat e depozituara, etj.", RPP nr. 4, pika 9.

86. Së shtati, të dhënat që mblidhen dhe analiza e tyre duhet të shpërndahen gjerësisht. Pra, duhet t'u vihen në dispozicion jo vetëm të gjitha organeve dhe individë që kanë përgjegjësi zyrtare për trajtimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, por edhe udhëheqësve politikë, fetarë dhe komunitarë si edhe personave të tjerëve të cilat kanë pozitë në jetën publike që ta bëjnë të qartë se përdorimi e gjuhës së urrejtjes është i papranueshëm në një shoqëri demokratike. Për më tepër, është e rëndësishme që të dhënat dhe analiza të paraqiten në një format që mundëson shpërndarje të mëtijshme përmes operatorëve mediatikë. Kjo i jep mundësinë publikut të vlerësojë situatën dhe dëmet që shkakton gjuha e urrejtjes.
87. Në fund, një autoritet specifik publik duhet të ngarkohet me përgjegjësinë për të garantuar që këto kërkesa për mbledhje dhe analizë të të dhënave në mënyrë më të qëndrueshme, sistematike dhe gjithëpërfshirëse të përmbushen realisht nga organet dhe institucionet e interesuara.

F. Rritja e ndërgjegjësimit dhe kundërnarrativa

Rekomandimi 4

88. Ky rekomandim synon të dekurajojë dhe të parandalojë gjuhën e urrejtjes duke demonstruar rrezikun që paraqet si edhe përmes kundërnarrativës, pra, duke ritheksuar vlerat që ajo kërcënon dhe duke sfiduar argumentet mbi të cilat bazohet. Rekomandimi e pranon që kjo kërkon angazhimin e një game të gjerë aktorësh, sidomos personazhe publike, funksionarë, edukatorë dhe mësues, organizata joqeveritare, organe të barazisë dhe institucione kombëtare të të drejtave të njeriut. Gjithsesi, theksimi i angazhimit aktiv me publikun në përgjithësi për këtë çështje, pasqyron faktin se respektimi dhe garantimi i dinjitetit të qenësishëm dhe të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është përgjegjësi e secilit në një shoqëri demokratike.
89. Në të njëjtën kohë, rekomandimi 4 kërkon që persona të caktuar të jenë në pararojë të përpjekjeve për të theksuar jo vetëm papranueshmërinë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, por edhe kërcënimin që u kanoset vlerave. Përpjekje të tilla duhet t'u drejtohen jo vetëm atyre që mund të ndikohen më lehtë nga dezinformimi, stereotipizimi negativ dhe stigmatizmi, por edhe atyre që tashmë kanë rënë pre e këtij ndikimi ose kërkojnë ta ushtrojnë. Përvoja ka treguar se demokracia dhe pluralizmi mund të minohen dhe të kalojnë në plan të dytë, nëse thirrjet për t'u mohuar disa personave të drejtën e barazisë dhe dinjitetit dëgjohen dhe kalohen pa asnjë veprim.
90. Kështu, ruajtja e pluralizmit dhe demokracisë kuptohet si nevojë për lëshime nga individë dhe grupe individësh, kufizim për disa prej lirive të tyre për të garantuar më shumë stabilitet të shoqërisë në tërësi.

Rritja e ndërgjegjësimit

91. Megjithatë, këto ideale nuk garantohen dhe nuk vlerësohen vetëm përmes vendosjes së kufizimeve mbi atë çka njerëzit mund të thonë apo mund të bëjnë. Është gjithashtu thelbësore që të vlerësohet rëndësia e respektimit të diversitetit në shoqëri dhe angazhimi i përbashkët për sigurimin e saj. Në të njëjtën kohë, nevojitet gjithashtu të ndërmerren hapa për eliminimin e pengesave mes grupeve të ndryshme në shoqëri që mund të pengojnë zhvillimin e respektit dhe mirëkuptimit reciprok dhe që mund të shfrytëzohet për promovimin e armiqësisë dhe mungesës së harmonisë.
92. Në radhë të parë të mbahen gjallë njohuritë për atë çka ka ndodhur në të kaluarën. Kjo mund të arrihet përmes përkujtimit të Holokaustit dhe sulmeve

të tjera, pluralizmit dhe të drejtave të njeriut në Evropë dhe gjetkë në rrugën e historisë sonë të përbashkët. Ky përkujtim mund të ndërmerret përmes shënimit të këtyre aktiviteteve në ditë apo përvjetorë të veçantë, si dhe përmes ngritjes së monumenteve për të shënuar faktin që ato kanë ndodhur dhe përmes programeve të vazhdueshme që rrisin ndërgjegjësimin dhe njohjen e asaj çka ka ndodhur dhe pse reflektimi për këtë ngjarje mbetet i rëndësishëm edhe sot. Do të ishte veçanërisht e dobishme t'u kushtohet vëmendje ngjashmërive mes qëllimeve dhe aktiviteteve të organizatave që promovojnë aktualisht urrejtjen dhe intolerancën dhe atyre që e kanë bërë këtë më parë me pasoja shkatërruese.

93. Së dyti, duhet të bëhen përpjekje për të garantuar një vlerësim shumë më të gjerë të asaj çka kërkojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe se pse respektimi i tyre është themelor për një shoqëri demokratike. Këto çështje duhet të përfshijnë në veçanti – duke u fokusuar veçanërisht te natyra dhe pasojat e praktikave diskriminuese, edukimin e përgjithshëm që merr kushdo. Mësuesit dhe profesorët duhet të marrin trajnimin e përshtatshëm dhe materialet e nevojshme të mësimdhënies, në mënyrë që të jenë në gjendje ta ofrojnë këtë lloj edukimi. Në kontekstin e shkollës është e rëndësishme që ky edukim të aplikohet në mënyrën se si nxënësit e trajtojnë njëri-tjetrin⁶⁵. Në këtë kontekst, ECRI ka rekomanduar në monitorimin që u ka bërë vendeve të ndryshme marrjen e masave për promovimin e tolerancës dhe respektit reciprok në shkolla, pavarësisht orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Megjithatë, është theksuar se përgjegjësia që u jepet institucioneve të caktuara për hartimin e kurrikulave të përshtatshme në këtë fushë nuk është përmbushur gjithmonë, dhe se në disa raste, kurset ose lëndët nuk janë zhvilluar, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme për këtë. Për këtë arsye, është e nevojshme të garantohet mbështetja e duhur për zhvillimin dhe realizimin e këtyre kurseve dhe për monitorimin e masave të marra për të dyja këto aspekte. Përveç kësaj, informimi dhe rritja e ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut nuk duhet të jetë thjesht çështje e programeve formale të edukimit. Ajo duhet të jetë gjithashtu në fokus të diskutimeve aktuale për programet mediatike dhe informuese për publikun në përgjithësi.
94. Së treti, duhet të ndërmerren ose të mbështeten nisma për forcimin e respektimit të diversitetit përmes promovimit të një ndërgjegjësimi më të madh “të tjetrit” ose “të të tjerëve” në shoqëri. Këto nisma mund të marrin formën e artit dhe festivaleve të filmave, koncerteve, aktiviteteve kulinare, dramave dhe lojërave me role, ekspozitave, leksioneve dhe seminareve, si dhe projekteve të posaçme me shkollat, si dhe transmetimet dhe publikimet. Në të njëjtën kohë, mund të ishte gjithashtu e dobishme që personat që kanë një origjinë emigrimi – ku përfshihen ata që shquhen në fusha si kultura, ekonomia dhe sporti, por jo vetëm – të marrin pjesë në këto programe, duke demonstruar integritimin e tyre të suksesshëm dhe ruajtjen në të njëjtën kohë të identitetit të tyre. Megjithatë, është e pamundur që të gjitha këto aktivitete promovuese të jenë të suksesshme nëse nuk jepet shembulli i respektimit dhe mirëkuptimit reciprok nga të gjitha autoritetet publike në mënyrën se si ato i ushtrojnë funksionet e ndryshme.

Eliminimi i pengesave ndaj kuptueshmërisë

95. Së katërti, duhet të lehtësohet dialogu ndërkulturor – që përfshin shkëmbimet e hapura dhe të respektueshme të pikëpamjeve mes individëve dhe grupeve që u përkasin kulturave të ndryshme – në mënyrë që të përftohet një njohje më e thellë e këndvështrimit të njëri-tjetrit. Ky dialog duhet të marrë parasysh udhëzimet e dokumentit të Këshillit të Evropës për Dialogun

⁶⁵ Shih masat e propozuara në GPR nr.10, pjesën II dhe III

Ndërkulturore “Të jetojmë së bashku si të barabartë me dinjitet”⁶⁶. Në veçanti, kjo mund të funksionojë përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe projekteve studimore, ofrimit të kurseve të gjuhëve, krijimit të bursave të studimit dhe programeve të shkëmbimeve mes studentëve, si dhe përmes organizimit të seminareve për eksplorimin e çështjeve me interes të veçantë. Në rastin e komuniteteve, marrëdhëniet e të cilave janë karakterizuar nga konfliktet në të kaluarën, mbështetja e dialogut mes tyre mund të duhet të lidhet me masat për promovimin e parandalimit të konflikteve, ndërmjetësimin dhe pajtimin. Edhe këtu, do të jetë e rëndësishme që të gjitha autoritetet publike të luajnë një rol aktiv në këtë dialog, në mënyrë që shembulli i tyre të jetë inkurajim për t’u ndjekur nga të tjerët.

96. Së pesti, lidhjet mes komuniteteve të ndryshme mund të forcohen edhe përmes mbështetjes së “krijimit të rrjeteve bashkëpunuese për ndërtimin e mirëkuptimit reciprok, promovimit të dialogut dhe frymëzimit të masave konstruktive drejt qëllimeve të përbashkëta të politikave dhe arritjes së rezultateve konkrete, si përmes projekteve të shërbimeve në fushën e arsimit, shëndetësisë, parandalimit të konflikteve, punësimit, integritit dhe edukimit mediatik⁶⁷. Ngritja e **mekanizmave për identifikimin dhe adresimin e fushave potenciale të tensioneve mes anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, si dhe ofrimi i asistencës për parandalimin e konflikteve dhe ndërmjetësimin mund të jenë gjithashtu të dobishme**⁶⁸.
97. Së gjashti, duhet të ketë përpjekje të veçanta për të luftuar **keqinformimin, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin**, pasi këto mund të shtrojnë themelet ku bazohet përdorimi i gjuhës së urrejtjes. Për shembull, policia dhe gjyqësori duhet ta bëjnë të ditur origjinën etnike të autorëve të dyshuar të veprave penale vetëm kur kjo është rreptësisht e nevojshme dhe kur i shërben një qëllimi legjitim, pasi nxjerrja e këtij informacioni mund të përforcojë në mënyrë të pajustificueshme paragjykimet, ndërkohë që shpallja e tyre më pas të pafajshëm mund të anashkalohet ose të mos raportohet. Megjithatë, nuk mjafton që të korrigojnë “faktet” dhe të kundërshtohen karakteristikat e supozuara që mund t’i jenë atribuar gabimisht një personi apo një grupi të caktuar personash, pasi kjo mund të mos ketë asnjëherë të njëjtin qarkullim apo të njëjtën vëmendje siç mund të kenë deklaratat e korrigjuara apo të kundërshtuara. Duhet bërë përpjekje edhe për të shpërndarë sa më gjerë narrativa alternative sa të plotë aq edhe të kuptueshme për personat objekt i keqinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit; këto narrativa i portretizojnë nga një këndvështrim pozitiv i mirëbazuara, i cili kundërshton bindshëm portretizimin negativ të personit apo grupeve të personave në fjalë. Këtu mund të përfshihet marrja e hapave për promovimin e pjesëmarrjes dhe pranimit të personave nga pakicat në ekipe të përziera sportive. **Përveç kësaj, duhet të ndalohet qartë përdorimi i profilizimit** – domethënë përdorimi i prezumimeve stereotipike të bazuar tek anëtarësimi në një grup të caktuar⁶⁹ – si bazë për masat e marra sa i përket antiterrorizmit, zbatimit të ligjit dhe emigracionit, doganave dhe kontrollit kufitar⁷⁰. Ndonëse jo të gjitha këto

⁶⁶ Shpallur nga Ministri i Jashtëm të Këshillit të Evropës në Sesionin e 118-të të Ministrave, 7 maj 2008

⁶⁷ Siç rekomandohet nga rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 16/18 lufta ndaj intolerancës, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit, si dhe diskriminimit, nxitjes së dhunës, dhunës ndaj personave për shkak të besimit fetar (24 mars 2011) pika 5(a)

⁶⁸ Po aty, pika 5(b).

⁶⁹ Profilizimi racialet është, sipas GPR nr.11 (pika 1), “Përdorimi nga policia, pa asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të motiveve si raca, gjuha, ngjyra, besimi fetar, kombësia dhe origjina kombëtare ose etnike në aktivitetet e kontrollit, mbikëqyrjes ose hetimit”.

⁷⁰ Mbi nevojën e përjashtimit të profilizimit, shih për shembull, raportin e raportuesit të posaçëm për format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racialet, ksenofobisë dhe intolerancës së lidhur me to, A/HRC/29/46, 20 prill 2015.

përpyqje mund të ndikojnë në imazhin e atyre që përdorin keqinformimin, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ato mund të kontribuojnë për mosinflucimin e të tjerëve nga këto praktika.

Rëndësia e kundër-narrativave

98. Përfundimisht, këto përpyqje duhet të lidhen me dënime specifike të menjëhershme dhe absolute të përdorimit real të gjuhës së urrejtjes. Dënimi i qartë i përdorimit të gjuhës së urrejtjes është i nevojshëm jo vetëm për shkak të përdorimit të saj është tërësisht i papranueshëm në një shoqëri demokratike, por edhe sepse kjo i shërben përforsimit të vlerave ku mbështetet një shoqëri e tillë. Këto **kundër-narrativë** nuk duhet vetëm të thonë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është gabim, por të theksojnë se pse kjo është antidemokratike. Është e rëndësishme që askush të mos qëndrojë pa bërë asgjë dhe të lejojë që gjuha e urrejtjes e çfarëdo lloji të përdoret pa u kundërshtuar. Këto kundërshtime janë veçanërisht të praktikueshme në mediat *online*, të cilat ofrojnë mjete të ndryshme reagimi ndaj materialeve që shpërndahen. Që të gjithë përdoruesit e mediave të çfarëdolloj forme duhet të nxiten në këtë mënyrë që të sjellin në vëmendje rastet ku përdoret gjuha e urrejtjes dhe t'i bëjnë të qarta kundërshtimet e tyre ndaj këtyre rasteve. Megjithatë, ndonëse kundërshtimi i përdorimit të gjuhës së urrejtjes është përgjegjësi e të gjithëve, figurat publike mund të japin një kontribut posaçërisht të rëndësishëm në këtë aspekt, sepse për shkak të pozicionit që ata kanë, kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi personat e tjerë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të gjitha figurat publike, sidomos politikanët dhe drejtuesit fetarë dhe të komuniteteve, por edhe personalitetet në fushën e arteve, biznesit dhe sportit të shprehen kur dëgjojnë apo shohin të përdoret gjuha e urrejtjes, pasi heshtja e tyre mund të kontribuojnë në legjitimimin e përdorimit të saj. Në ciklet e monitorimit është vënë re se organet e barazisë, avokatët e popullit dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut janë shprehur veçanërisht publikisht duke dënuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Kjo është padyshim e dobishme por këto dënime duhet të integrohen, në mënyrë që ky të jetë një reagim shumë më i përgjithshëm i figurave publike dhe jo vetëm i disa zërave të vetmuar. Këto kundërnarrativa mund të marrin edhe formën e tërheqjes nga aktivitete dhe organizata, ku përfshihet aktivisht përdorimi i gjuhës së urrejtjes.
99. Ndonëse shumë prej hapave të sugjeruar më sipër janë hapa me zbatim të përgjithshëm, rekomandimi 4 thekson se ka nevojë të posaçme për zbatimin e tyre në lidhje me fëmijët, të rinjtë dhe zyrtarët publikë. Në rastin e dy të parëve kjo vlen për shkak se moshën e tyre jo vetëm i bën ata veçanërisht të prekshëm nga ndikimi i gjuhës së urrejtjes, por edhe ngaqë kjo mund t'i japë mundësi arsimit që t'i çlirojë ata më lehtë nga paragjykimet që vazhdojnë të ushqejnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Në rastin e zyrtarëve publikë, hapat e propozuar nevojiten si për shkak të gamës së ndikimit pozitiv mbi të tjerët që vjen për shkak të pozicionit të tyre, ashtu edhe sepse ky pozicion e bën çdo lloj përdorimi të gjuhës së urrejtjes prej tyre veçanërisht të rëndë, ngaqë duket sikur përdorimi i kësaj gjuhe miratohet nga vetë shteti.
100. Rekomandimi 4 parashikon gjithashtu marrjen e hapave për të inkurajuar ata që e përdorin gjuhën e urrejtjes si për të hequr dorë prej saj, por edhe për t'i ndihmuar që t'i japin fund shoqërimit me grupet që e përdorin një gjuhë të tillë. Kuptohet që kjo nuk është një detyrë e lehtë, edhe për shkak të paragjykimeve të ngulitura që e bëjnë pothuaj të zakonshme përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Pavarësisht kësaj, modelet e sjelljes nuk mund të ndryshohen dhe në ciklet e monitorimit, janë vënë re disa projekte që kanë pasur si synim pikërisht këtë qëllim. Prandaj, do të ishte e përshtatshme, që këto të mbështeten dhe të përhapen më gjerësisht, duke u bazuar edhe tek përvoja e fituar nga programet që kërkohet të miratohen në kuadrin e neni 16 (1) të Konventës së

Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje për t'u mësuar autorëve të dhunës në familje që të përqafojnë sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale.

101. Hapat e parashikuar nga rekomandimi 4 janë hapa që duhet të ndërmerren jo vetëm nga individët, por edhe nga një gamë e gjerë aktorësh specifikë. Megjithatë, rekomandimi 4 vlerëson se një kontribut i veçantë mund të jepet dhe, realisht jepet shpesh, nga organizatat joqeveritare, organizmat e barazisë dhe institucionet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, qoftë nga secili prej tyre individualisht ose në bashkëpunim me njëri-tjetrin. Në disa raste, kjo mund të kërkojë që këtyre dy të fundit t'u jepet një lloj autorizimi specifik, për të punuar kundër gjuhës së urrejtjes, por që të tre këtyre subjekteve u duhen dhënë burimet e nevojshme për realizimin e një pune të tillë.
102. Përveç kësaj, rekomandimi 4 i kushton vëmendje të veçantë punës edukuese për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rreziqet që paraqet përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe për forcimin e angazhimeve për pluralizëm dhe demokraci. Kjo kërkon rritjen e kapacitetit të mësuesve dhe edukatorëve në mënyrë që ata të mund të realizojnë programet e nevojshme edukuese⁷¹. Kështu, duhet ofruar mbështetja e nevojshme për trajnimin, si dhe për krijimin e materialeve që do të përdoren në këto programe.
103. Ndonëse të gjitha këto përpjekje të ndryshme mund të ndërmerren të izoluar nga njëra-tjetra, ato mund të kenë një ndikim edhe më të rëndësishëm kur ndërmerren në kontekstin e një bashkëpunimi dhe koordinimi më të mirë nga ana e aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë proces. Siç është parë në ciklet e monitorimit, kjo mund të përfshijë miratimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për luftën kundër ekstremizmit, racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës që lidhet me të, homofobisë dhe transfobisë. Këto strategji dhe plane duhet të përmbajnë detyra konkrete për ministritë, pushtetin vendor dhe policinë dhe duhet të hartohen e të vlerësohen çdo vit. Do të ishte gjithashtu me vend, që të miratohen plane veprimi për integrimin e komuniteteve të pakicave, ku këto komunitete të marrin pjesë në të gjitha fazat e hartimit, monitorimit dhe vlerësimit të tyre. Sidoqoftë, është thelbësore që të gjitha këto përpjekje të bëhen përmes një procesi të vazhdueshëm dhe jo *ad hoc* dhe që të adresojnë të gjitha format e urrejtjes.

G. Mbështetja për personat e shënjestruar

Rekomandimi 5

104. Ky rekomandim trajton nevojën e mundësimin të mënyrave të ndryshme të dhënies së mbështetjes për viktimat e gjuhës së urrejtjes. Rekomandimi njeh faktin se përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të rezultojë në efekte negative emocionale dhe psikologjike mbi personat e ekspozuar ndaj saj. Për më tepër, viktimat e gjuhës së urrejtjes mund të mos jenë në dijeni të të drejtave të tyre për të marrë masa mbrojtëse ndaj saj. Gjithashtu, viktimat mund ta kenë të pamundur mbrojtjen ndaj saj për shkak të formave të ndryshme të presionit për të mos ushtruar të drejtën për tu mbrojtur nga gjuha e urrejtjes.
105. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund t'i shtyjë ata që vihen në shënjestrën e saj të ndjehen jo vetëm të frikësuar e të pasigurt, por gjithashtu - pa ndonjë shkak të arsyeshëm - fajtorë ose të turpëruar e të poshtëruar, çka rezulton në humbjen e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit. Këto ndjesi mund të shprehen në simptoma fizike, si për shembull në humbje të gjumit dhe dhimbje të kokës, si dhe në probleme

⁷¹ Në lidhje me paragrafin e mësipërm ju lutemi t'u referoheni rekomandimeve e hollësishme të përmbajtura në pjesën III të GPR Nr. 10.

shëndetësore mendore dhe fizike të shkallës serioze. Pasojat direkte të këtyre ndjesive reflektohen në çdo aspekt të jetës së personave të prekur, qoftë në punë, shkollë apo shtëpi. Ndikimi i tyre në marrëdhëniet familjare si dhe në aftësinë për të marrë pjesë në jetën shoqërore është veçanërisht serioz⁷².

Sigurimi i këshillimit dhe ndihmesës

106. Për arsyet e mësipërme del e nevojshme të sigurohet që **mbështetja e duhur** ndaj atyre që vuajnë pasojat e ekspozimit ndaj gjuhës së urrejtjes ose që rrezikohen prej saj. Në veçanti, ekziston nevoja që kjo mbështetje të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur, si pas ekspozimit ndaj gjuhës së urrejtjes, ashtu dhe në vijimësi të marrjes së përgjigjeve të ndryshme zyrtare lidhur me të, përfshirë këtu çdo procedurë penale. Ofrimi i asistencës për viktimat ka si parakusht ekzistencën e këshilltarëve të trajnuar në mënyrën dhe nivelin e duhur. Këta këshilltarë duhet të jenë në gjendje të interesohen për perceptimet dhe ndjesitë e frikës së viktimës, si saktësimi nëse viktima ka nevojë për kujdes specifik mjekësor. Konsulentët duhet kujdesen që viktima e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nuk është fajtor për shkaktimin e saj. Konsulentët duhet ta ndihmojnë viktimën të rifitojë një ndjesi vetëkontrolli dhe vetëbesimi. Duhet pasur veçanërisht parasysh fakti se procesi i rimëkëmbjes së viktimës mund të shtrihet në kohë dhe periudha e rimëkëmbjes mund të ndryshojë në bazë të përvojave specifike si dhe karakterit të individit të prekur. Dhënia e mbështetjes për viktimat e prekura nga gjuha e urrejtjes duhet të realizohet në mënyrë sistematike dhe të mundësohet pavarësisht nga forma e transmetimit të gjuhës së urrejtjes.

Ushtrimi i të drejtës për adresimin e gjuhës së urrejtjes

107. Viktimat e gjuhës së urrejtjes kanë të drejtë ta adresojnë atë përmes kundërnarrativës, **dënimin të saj**, si dhe nëpërmjet rekursit gjyqësor tek autoritetet kompetente. Pavarësisht rekursit gjyqësor, ushtrimi i kësaj të drejte nuk është i mjaftueshëm për shpagimin e viktimës. Ka shumë rëndësi që viktimat të jenë të vetëdijshme për mundësitë ligjore në dispozicion, në mënyrë që ato të mos hasin asnjë pengesë në ushtrimin e tyre.
108. Kuadri aktual i së drejtës përcakton masa të ndryshme për të siguruar që viktimat e gjuhës së urrejtjes të vihen **në dijeni të të drejtave të tyre**. Këtu përfshihen fushata ndërgjegjësuese, të cilat i bëjnë të qartë publikut se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është i papranueshëm, duke përcaktuar mënyrat në të cilat viktimat e saj mund të reagojnë ose të kërkojnë kompensim. Këto fushata duhet të theksojnë se trajtimi i situatës së veçantë të viktimave, si dhe parashtrimi i ankesave të tyre përbëjnë aspekte thelbësore të përpjekjeve më të gjera për të adresuar fenomenin e gjuhës së urrejtjes. Këto fushata mund të jenë shpesh të natyrës së përgjithshme. Sidoqoftë, në raste të veçanta mund të jetë veçanërisht e dobishme që ato të fokusohen mbi viktimat që u përkasin grupimeve të veçanta shoqërore, si për shembull minoritetet ose personave LGBT përmes OJQ-ve ose mediave që gjenden pranë shqetësimeve dhe kauzave të tyre.
109. Informacioni rreth mundësive të disponueshme për të reaguar kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes duhet të mund të shpërndahet nëpërmjet zyrave të qeverisjes qendrore dhe lokale, qendrat e këshillimit, avokatët dhe organizatat joqeveritare.

⁷² shih përmbledhjen e literaturës tek I. Dzelme, Efektet psikologjike të krimit të urrejtjes - Përvojat individuale dhe ndikimi i tyre në komunitet (Sulmi ndaj personit tim) Një studim cilësor, Qendra Letoneze për të Drejtat e Njeriut, 2008. Fenomeni trajtohet në dispozitat e Direktivës 2012 / 29 / BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të BE, dt. 25 tetor 2012 për krijimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit të BE 2001/220 / JHA.

Heqja e pengesave për shpagimin e viktimave

110. Edhe në rastin kur kemi vetëdijesim për të drejtat e viktimës, ekzistojnë faktorë të ndryshëm që mund t'i dekurajojnë ata që bien pre e gjuhës së urrejtjes, çka u pamundëson atyre ushtrimin e të drejtave që posedojnë. Në këto raste, viktimat mund të krijojnë idenë se realizimi i të drejtave të tyre mund të jetë diçka tejet e ndërlikuar, shumë e kushtueshme ose thjesht nuk ia vlen të futen në telashe, veçanërisht nëse ekziston perceptimi se ankesat e tyre nuk do të shqyrtohen, apo edhe në se do të shqyrtohen, ato nuk do merren seriozisht parasysh. Gjithashtu, viktimat e gjuhës së urrejtjes mund të heqin dorë nga ankesat për shkak të frikës nga reagimi i dhunuesve të tyre apo nga kërcënimet që kanë marrë më parë prej tyre. Këto fenomene janë vërejtur gjatë monitorimit të fenomenit.
111. Shqetësimet për **vështirësitë dhe shpenzimet që lidhen me parashtrimin e ankesave** - veçanërisht atyre ankesave të cilat implikojnë procedura juridike - në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, mund të adresohen më së miri duke i thjeshtësuar procedurat për përdoruesit dhe duke vënë në dispozicion të viktimave asistencën e duhur për paraqitjen dhe ndjekjen e tyre në vijimësi. Kjo asistencë mund të marrë trajtën e mbështetjes për organizatat - qofshin ato joqeveritare apo qeveritare, të cilat mbulojnë dimensionin e të drejtave të njeriut - për të ofruar këshilla dhe përfaqësim ligjor në procedurat formale dhe/ose shtrirjen e skemave të ndihmës juridike në paraqitjen e ankesave, veçanërisht kur ato implikojnë iniciimin e procedurave ligjore. Nuk shihet si e përshtatshme që autoritetet publike ose organizatat private të paguajnë një tarifë për trajtimin e ankesave të marra përsipër nga ana e tyre. Çdo tarifë që vilet në lidhje me procedurat ligjore të iniciuara për të adresuar gjuhën e urrejtjes duhet të jetë e arsyeshme, në mënyrë që kryerja e procedurave të mos të bëhet e pamundur për shkak të nivelit të pagesës. Për më tepër, të gjithë ata që kanë për detyrë të marrin në dorëzim ankesa, qoftë autoritetet publike, qoftë organizata private, duhet të posedojnë trajnimin e duhur për të garantuar që mënyra e marrjes në dorëzim të ankesës të mos jetë dekurajuese për atë që e parashtron.
112. Pavarësisht nga asistencë në dispozicion për parashtrimin e ankesave, ka shumë gjasë që ato të mos të paraqiten në rast se ekziston një ndjenjë e fortë se pavarësisht ankimit, ai nuk do të ketë asnjë efekt, qoftë për personin që e paraqet, qoftë për grupin e personave të cilët preken prej tij. Prandaj është jetike që ndikimi pozitiv i një ankese - d.m.th., realizimi i së drejtës për individin që inician procesin dhe / ose marrjen e masave për të parandaluar përsëritjen e aktit të dëmshëm të adresuar prej tij - të jetë qartësisht i demonstrueshëm. Kjo kërkon jo vetëm që ankesat të hetohen dhe shtjellohen siç duhet, por gjithashtu që rezultati i tyre të bëhet gjerësisht me dije. Bërja me dije e rezultatit të ankesës, është një element i rëndësishëm në hapat e ndërmarrë për të siguruar që viktimat e gjuhës së urrejtjes të bëhen të vetëdijshëm për të drejtat e tyre.
113. Viktimat në shënjestër të përdorimit të gjuhës së urrejtjes nuk duhet ndihën të intimiduara nga pasojat që mund të rrjedhin nga ankimi i tyre ose sigurimi i provave në lidhje me përdorimin e kësaj gjuhe. Për këtë arsye, duhet të ekzistojnë sanksione specifike penale për çdo **veprim hakmarrës** ndaj tyre - siç është për shembull pushimi nga puna për shkak të paraqitjes së ankesës. Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) rekomandon që emigrantët e jashtëligjshëm duhet të kenë mundësinë të ankohen për krimin e gjuhës së urrejtjes pa u rrezikuar nga dëbimi i menjëhershëm nga vendi pritës.

H. Vetërregullimi

Rekomandimi 6

114. Ky rekomandim trajton mënyrat e adresimit të gjuhës së urrejtjes përmes përpjekjeve të organizmave, institucioneve dhe organizatave të tjera, në të cilat mund të jenë aktivë apo me të cilat mund të kenë të bëjnë përdoruesit e gjuhës së urrejtjes. Edhe pse përdorimi i gjuhës së urrejtjes mbetet një çështje shqetësuese për publikun e gjerë dhe vërehet brenda një game të gjerë forumesh të ndryshme, ata që e përdorin në shumë raste kanë përkatësi specifike – mund të jenë punonjës në një ose më shumë organizma, institucione apo organizata. Këto të fundit mund të jenë ente publike apo private që përfshijnë parlamente apo organe të tjera të zgjedhura në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, ministri dhe organe të tjera publike, shërbimin civil ose publik, parti politike, shoqata profesionale, organizata të biznesit, si dhe shkolla, universitete dhe institucione të tjera arsimore, krahas një game shumë të gjerë organizatash kulturore dhe sportive.

Përgjegjshmëria

115. Edhe pse problemet e shkaktuara nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të mos jenë në fokusin e veçantë të aktiviteteve të organeve, institucioneve dhe organizatave të lartpërmendura, të gjitha këto entitete kanë përgjegjësinë e përbashkët për të respektuar dhe siguruar dinjitetin e qenësishëm dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore në një shoqëri demokratike. Për aq sa është e mundur brenda kompetencave të tyre, këto organe, institucione dhe organizata duhet të bëjnë të qartë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga personat që bashkëpunojnë me to është absolutisht i papranueshëm dhe ata duhet të ndërmarrin veprimet e duhura për ta parandaluar ose dënuar atë. Këto organizata duhet të garantojnë se çdo përdorim i gjuhës së urrejtjes nga personat që punojnë me ta vihet në vëmendjen e tyre. Ato duhet të ofrojnë trajnime në mënyrë që të gjithë bashkëpunëtorët e tyre të mund të vlerësojnë pse përdorimi i gjuhës së urrejtjes është i papranueshëm, në mënyrë që çdokush të mund të sinjalizojë dhe dënojë përdorimin e saj.

Tipare thelbësore

116. Theksimi mbi nevojën e vetërregullimit sipas përcaktimeve të këtij rekomandimi është një reflektim i nevojës për të garantuar që çdo kontroll mbi lirinë e shprehjes të jetë sa më i kufizuar që të jetë e mundur. Organizmat, institucionet dhe organizatat përkatëse shpesh janë në pozitën më të mirë për të identifikuar përdorime të caktuara të gjuhës së urrejtjes dhe për të parandaluar përdorimin e tyre, qoftë me anë të dekurajimit të përdoruesve të tyre nëpërmjet bindjes, qoftë nëpërmjet dënimit të tyre nëpërmjet sanksioneve në fuqi. Në shumë raste vetërregullimi mund të jetë mënyra më e përshtatshme dhe më efektive për të adresuar gjuhën e urrejtjes. Sidoqoftë, vetë **natyra e këtyre organeve, institucioneve dhe organizatave mund të ndryshojë ndjeshëm. Padyshim, kjo ndikon në mënyrën e ushtrimit të rolit të tyre të veçantë në trajtimin e gjuhës së urrejtjes.** Ky aspekt duhet të merret parasysh gjatë ofrimit të mbështetjes nga qeveritë për vetërregullimin e ndërmarrë nga këto organe, institucione dhe organizata. Në veçanti, çdo mbështetje qeveritare nuk duhet të kushtëzohet nga një model të vetëm të vetërregullimit që është në miratim e sipër; **për këtë arsye, vetërregullimi i medias adresohet më konkretisht në rekomandimin Nr. 7.**
117. Gjithsesi, rekomandimi Nr. 6 identifikon disa tipare të dobishme për tu përfshirë në të gjitha skemat e vetërregullimit, përkatësisht, miratimin e **kodeve të sjelljes** (ose etikës) të shoqëruara me sanksione të caktuara në rast mosrespektimi të dispozitave të tyre, rregullat për monitorimin e deklaratave dhe publikimeve për të

parandaluar përdorimin e stereotipave, informacionit negativ dhe mashtrues, ofrimin e trajnimit dhe krijimin e mekanizmave të ankesave.

Kodet e sjelljes

118. Ekzistenca e kodeve të sjelljes merr rëndësi të veçantë kur mbartësit e ofiqeve publike gëzojnë imunitet para ligjit - siç është rasti i gjyqtarëve dhe deputetëve - pasi ky privilegj mund të parandalojë çfarëdo forme veprimi kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga personi që e gëzon atë.
119. Monitorimi i ECRI e ka bërë tashmë të qartë se organe, institucione dhe organizata të ndryshme tashmë kanë miratuar kode sjelljeje (ose kode të etikës) si dhe standarde të ngjashme - përfshirë rregullore - që mund të përdoren për të adresuar gjuhën e urrejtjes nga personat me të cilat këto organizata kanë të bëjnë në një mënyrë apo në një tjetër. Dispozitat dhe kodet e përdorura në shtete të ndryshme anëtare përfshijnë rregulla dhe rregullore që zbatohen në lidhje me gjyqtarë, ministra, anëtarë të legjislaturës, anëtarë të organizatave të profesionistëve, sportive, si dhe stafin dhe studentët e universiteteve apo kolegjeve. Gjithashtu, ekzistojnë kodeve dhe statute ndërkombëtare ose rajonale të zbatueshëm nga organizma, institucione dhe organizata që veprojnë brenda shteteve anëtare, si për shembull Kodi Disiplinor i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatës së Futbollit (FIFA), udhëzimet e Unionit Evropian të Shoqatave të Futbollit (UEFA), si dhe Karta e Partive Politike Evropiane për një shoqëri jo raciste. Në disa raste, fushëveprimi i këtyre kodeve mund të jetë mjaft i gjerë, veçanërisht kur bëhet fjalë për aktivitetet sportive. Kësisoj, këto kode dhe rregulla mund të zbatohen jo vetëm mbi ata që janë të angazhuar në aktivitete sportive ose janë të përfshirë në organizimin dhe menaxhimin e tyre, por edhe për ata që marrin pjesë ose i mbështesin ato në vendin ku ato zhvillohen ashtu si edhe gjetkë (si p.sh. gjatë udhëtimit për në vendin në fjalë). Disa kode të sjelljes apo kode etike që disiplinojnë parlamentarët zbatohen kudo që zhvillohet aktiviteti i tyre, pa u kufizuar vetëm në procedurat që kryhen brenda legjislaturës.
120. Megjithatë, dispozitat që gjenden në këto kode nuk adresojnë gjithmonë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në terma specifikë. Në fakt, ato mund të merren më forma të ndryshme sjelljesh që mund të jenë pjesë e objektit të tyre, si përdorimi i fyerjes, gjuhës ofenduese ose kërcënuese, ose mund t'u referohen vetëm kërkesave për respektimin e dinjitetit dhe barazisë në terma shumë të përgjithshëm. Fatkeqësisht, jo të gjitha format e gjuhës së urrejtjes trajtohen në praktikë siç përqafohen nga këto formulime dhe, si rrjedhojë, nuk merret asnjë lloj mase ndaj disa përdoruesve të gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë edhe ndaj atyre që përdorin gjuhë raciste dhe homofobike dhe transfobike. Përdorimi i kodeve që trajtojnë gjuhën e urrejtjes mund të jetë më efikas nëse sjellja e ndaluar formulohet shprehimisht duke iu referuar kuptimit të gjuhës së urrejtjes në këtë Rekomandim. Ato duhet të trajtojnë veçanërisht të gjitha format e gjuhës së urrejtjes dhe jo vetëm ato që mund të jenë objekt i sanksioneve penale. Përveç kësaj, kodet duhet të bëjnë të qartë angazhimin e atyre që i miratojnë për barazi dhe dinjitet dhe për të mos lënë asnjë lloj dyshimi për pikëpamjen e tyre se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është i papranueshëm. Në të gjitha rastet, formulimet e përdorura në ato kode duhet të jenë të qarta dhe të aksesueshme, në mënyrë që të mos ketë asnjë pasiguri rreth sjelljeve që konsiderohen të papranueshme. Kjo është e rëndësishme si për ata që mund të jenë objekt sanksionesh, ashtu edhe për ata që gjenden në shënjestrën e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, kodet duhet jo vetëm të shpërndahen dhe të vihen në vëmendjen e atyre ndaj të cilëve ato zbatohen, por duhet gjithashtu të vihen në dispozicion publikisht, në mënyrë që kushdo që ka një interes për të garantuar përmbushjen e kërkesave të tyre të jetë në gjendje të veprojë si duhet.

121. Rekomandimi 6 kërkon posaçërisht inkurajimin e partive politike që të nënshkruajnë **Kartën e Partive Politike Evropiane për një shoqëri joraciste**, pasi pranimi i saj nga këto parti jo vetëm që do të përfshijë njohjen prej tyre të disa përgjegjësive të caktuara si aktorë në një proces politik demokratik, por do të ofrojë edhe leadership për të tjerët në demonstrimin e nevojës për miratimin e kodeve për adresimin e gjuhës së urrejtjes.⁷³

Zbatimi

122. Ndonëse miratimi i kodeve në vetvete pasqyron një angazhim ndaj vlerave të mishëruara në to, efektshmëria e tyre kërkon edhe marrjen e disa masave për garantimin e respektimit të dispozitave të tyre. Kjo mund të arrihet më mirë nëpërmjet një kombinimi të mekanizmave të **monitorimit dhe mekanizmave të ankesave**.
123. Teknikat monitoruese mund të variojnë. Në disa raste, ato nuk përfshijnë asgjë më shumë sesa thjesht të dëgjuarit e fjalimeve dhe të rishikimin e publikimeve të atyre që kanë lidhje me organin, institucionin apo organizatën në fjalë dhe marrjen më pas të qëndrimit të duhur ndaj tyre. Megjithatë, duhet gjithsesi të jetë një person i ngarkuar me përgjegjësi të qarta për ta bërë këtë lloj monitorimi, edhe nëse ka edhe persona të tjerë që janë në gjendje të sjellin në vëmendje përdorime të veçanta të gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, siç tregon rekomandimi 6, do të jetë veçanërisht e rëndësishme për ata që bëjnë monitorimin që të shohin për përdorim të stereotipizimit negativ dhe informacioneve çorientuese, pasi kjo e para mund të jetë një formë më pak e dukshme e gjuhës së urrejtjes, ndërsa e dyta mund të përforcojë paragjykimet që vazhdojnë ta mbështesin një përdorim të tillë. Në kontekstin e vendeve ku zhvillohen aktivitete sportive, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbikëqyrjes së atyre që i ndjekin këto aktivitete për të mos i lejuar që të shpërndajnë apo shesin në afërsi të tyre asnjë lloj material ku përdoret gjuha e urrejtjes, si dhe për të mos i lejuar që të kenë akses tek ata që mbajnë apo që demonstrojnë pankarta, broshura dhe simbole, ku përdoret gjuha e urrejtjes dhe për të pezulluar apo ndaluar ngjarjet ku përdoret gjuha e urrejtjes nga ata që i ndjekin ato.⁷⁴
124. Mekanizmat e ankesave mund të ofrojnë një mjet për të përcaktuar nëse janë shkelur apo jo dispozitat e kodeve edhe kur monitorimi apo raportimi i brendshëm nuk ka vënë në dukje se ka ndodhur diçka e tillë. Përveç kësaj, në rastet kur konstatohen shkelje të tilla, ata mund të përcaktojnë se çfarë sanksionesh duhet të vendosen. Këta mekanizma duhet të jenë të hapur jo vetëm ndaj atyre që lidhen me organet, institucionet apo organizatat relevante, por edhe ndaj atyre që kanë arsye për të menduar se janë qenë objekt i përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga një person i lidhur. Ato duhet të parashikojnë procedura të qarta, të rregullta dhe transparente dhe duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme, si nëpërmjet linjave telefonike në dispozicion apo përmes ndonjë mënyre tjetër komunikimi *online*. Organizmat, institucionet dhe organizatat që kanë mekanizma ankesash duhet të bëjnë përpjekje të veçanta për të inkurajuar personat e prekur nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes që të dalin e të paraqesin ankesa. Ato duhet gjithashtu të monitorojnë se si trajtohen këto ankesa, në mënyrë që të ofrojnë zgjidhje të qenësishme për personat e prekur nga përdorimi i kësaj gjuhe.
125. Shumica e kodeve ekzistuese parashikojnë edhe vendosjen e sanksioneve në rast të shkeljes së dispozitave të tyre. Këto variojnë për nga natyra, por mund të përfshijnë edhe vendosjen e gjobave, heqjen e një ministri nga qeveria apo një gjyqtari nga pozicioni ku është emëruar, pezullimin e një deputeti nga punimet e

⁷³ Shih edhe Deklaratën e ECRI-t për përdorimin e elementëve racistë, antisemitë dhe ksenofobë në ligjërimin politik (miratuar më 17 mars 2005).

⁷⁴ Shih GPR Nr. 12 *Lufta ndaj racizmit dhe diskriminimit racial në fushën e sportit*.

legjislaturës, përjashtimin apo moslejimin e pjesëmarrjes së personave në vende ku zhvillohen aktivitete sportive, heqjen e pikëve në gara sportive, dhe kërkesën për zhvillimin e aktiviteteve sportive me dyer të mbyllura. Është e rëndësishme që çdo sanksion i vendosur në mënyrë të qenësishme të pasqyrojë shkallën e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, përndryshe kjo mund të çojë në përshtypjen e mbështetjes së përdorimit të saj. Sigurisht që vendosja e sanksioneve të përshtatshme dhe të publikuara për përdorimin e gjuhës së urrejtjes mund të dërgojë një mesazh të qartë kundër gjuhës së urrejtjes dhe të demonstrojë se liria pa fre e shprehjes është e papranueshme. Kështu, në rastet kur vendoset një sanksion për përdorim të gjuhës së urrejtjes, është e rëndësishme për lidhshmërinë e organizmit, institucionit apo organizatës në fjalë që ta sjellë këtë fakt në vëmendjen si të atyre që lidhen me të, ashtu edhe të publikut në përgjithësi, së bashku me rikonfirmimin e qartë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes është tërësisht i papranueshëm.

126. Zbatimi efektiv i kodeve varet shumë nga ofrimi i **trajtimeve të përshtatshme** për përgjegjësitë në këtë aspekt. Ekziston në veçanti nevoja që këta persona të kuptojnë se çfarë përbën gjuhë urrejtjeje, duke përfshirë edhe përdorimin e saj në formate të koduara apo më pak të dukshme, si duhet reaguuar ndaj përdorimit të saj dhe si duhen trajtuar ata që e përdorin atë, si dhe si duhet të bëhet monitorimi dhe si duhet të funksionojnë mekanizmat e ankesave. Duke qenë se kjo nuk është diçka që mund të arrihet lehtësisht nga të gjithë organizmat, institucionet dhe organizatat për të cilat do të ishte me vend miratimi i kodeve që merren me gjuhën e urrejtjes, ka të ngjarë që ofrimi i mbështetjes nga qeveria të jetë veçanërisht i dobishëm. Kjo mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes lehtësimit të ofrimit të saj nga subjektet që kanë aftësi të veçanta në këtë fushë.
127. Përveç kësaj, zbatimi i kodeve do të jetë efikas vetëm nëse ofrohet **financim i mjaftueshëm** për mekanizmat e ndryshëm të monitorimit dhe të ankesave. Prandaj, ky duhet të jetë një faktor që duhet të merret parasysh si në kohën e miratimit të tyre, ashtu edhe në rishikimet e mëvonshme të funksionimit të tyre.
128. Përveç kësaj ,për të lehtësuar miratimin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes (ose etikës) për adresimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, do të ishte e dobishme që qeveritë të ofrojnë mbështetje edhe për **shkëmbimet e informacioneve** mes organizmave, institucioneve dhe organizatave përkatëse në lidhje me pikat e forta dhe të dobëta të atyre kodeve që kanë qenë në përdorim për një farë kohe.

Marrëdhëniet me format e tjera të zgjidhjeve

129. Në shumë raste, vetërregullimi në përgjithësi dhe mekanizmat e brendshme të ankesave në veçanti, mund të pritet që të adresojnë në mënyrë efektive përdorimin e gjuhës së urrejtjes duke përfshirë edhe ofrimin e kënaqësisë së nevojshme për personat që u drejtohen këtyre mekanizmave. Megjithatë, nuk ka për të ndodhur gjithmonë kështu, sidomos kur përgjigjja e duhur për përdorimin specifik të gjuhës së urrejtjes është e tillë që të kërkojë pagesën e një dëmshpërblimi ose vendosjen e një sanksioni penal. Kështu, ndonëse masat vetërregulluese do të përjashtojnë shpesh nevojën për t'iu drejtuar formave të tjera të zgjidhjeve parashikuar me ligj, ato nuk duhet të jenë dhe nuk duhet të bëhen asnjëherë pengesë për të kërkuar forma të tjera zgjidhjesh.

I. Media dhe Interneti

Rekomandimi 7

130. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në shumicën dërrmuese të rasteve ndodh përmes medias dhe internetit, ku mundësitë që ofron ky i dyti e rrisin shpesh mbulimin dhe rëndësinë e këtij përdorimi. Në të njëjtën kohë, media dhe interneti janë gjithashtu

ndër mjetet kryesore jo vetëm për komunikimin dhe për forcimin e vlerave që kërkon të cenohet përdorimi i gjuhës së urrejtjes, por edhe për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes që është themelore për një shoqëri demokratike. Kështu, fokusi specifik në këtë rekomandim si për rregullimin, ashtu edhe për vetërregullimin nga mediat edhe nga interneti, pasqyron njohjen e rëndësisë së veçantë që kanë ato për gjuhën e urrejtjes – si një mjet si për përdorimin ashtu edhe për kundërshtimin e saj – si dhe nevojën e marrjes së masave për të kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur çfarëdolloj kontrolli të ushtruar mbi lirinë e shprehjes. Ndonëse disa rregullime të medias dhe të internetit nuk janë konsistente me të drejtën e lirisë së shprehjes, mbështetja më shumë te vetërregullimi për adresimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes do të jetë në shumë raste jo vetëm efikase, por edhe rruga më e përshtatshme.

Pranimi i diversitetit

131. Termi **media dhe interneti** është një term që përfshin shumë forma komunikimi, të cilat kanë karakteristika dhe ndikime shumë të ndryshme. Kështu, ato mbulojnë si median e shkruar (si gazetatat, revistat dhe librat ashtu edhe pamfletet, fletëpalosjet, posterat), por edhe mediat audiovizuale dhe elektronike (si radion, televizionin, regjistrimet dixhitale të zërit dhe figurës, faqet e internetit, aplikacionet, emailt dhe një numër të madh mediash sociale dhe *videogames*) dhe, padyshim, forma të tjera të komunikimit që mund të zhvillohen tani e tutje. Përveç kësaj, disa gjëra të thëna, të publikuara apo të komunikuar në mënyra të tjera, kanë për të qenë vërtet nisma individuale, ndërsa të tjera do të jenë produkt i sipërmarrjeve të rëndësishme të biznesit. Disa prej këtyre komunikimeve do të jenë objekt i formave të ndryshme të kontrollit editorial, por disa të tjera do të shfaqen pa u rishikuar nga askush, përveç personit që i ka krijuar dhe, mund të duket edhe se publikohen pa dijeninë paraprake të personit që e ka ofruar mjetin specifik të komunikimit. Në shumë raste, autori i komunikimit do të jetë i identifikueshëm, por në raste të tjera ai ose ajo mund të mbetet anonim. Disa komunikime kanë për të arritur një audiencë pothuajse aty për aty, ndërkohë që të tjera do të varen nga vullneti për të dëgjuar, për të lexuar, apo për tu futur tek ajo çka komunikohet. Disa do të shpërndahen gjerësisht dhe/ose do të vazhdojnë të jenë në dispozicion, ndërkohë që disa të tjera zor se do të vihen re se ekzistojnë. Të gjitha këto dallime duhet të merren parasysh kur përcaktohet objekti i masave rregulluese apo vetërregulluese, si dhe për të kuptuar nëse pritshmëritë për çka ato mund të arrijnë janë realiste apo jo.
132. Përveç kërkesave të zbatueshme për deklaratat dhe publikimet (duke përfshirë edhe transmetimet) në kuadrin e së drejtës së përgjithshme (që diskutohet në pjesën vijuese), shkalla e rregullimeve specifike të zbatueshme për mediat dhe internetin variojnë nga një shtet anëtar në tjetrin. Në disa raste, ekziston detyrimi i marrjes së një licence franshizë për të operuar. Mund të ekzistojë edhe detyrimi për të respektuar standarde të caktuara dhe parashikimi i sanksioneve të caktuara – mund të përfshihet edhe heqja e përhershme apo e përkohshme e licencës apo e franshizës – në rastin e shkeljes së këtyre standardeve. Në raste të tjera, mund të ekzistojë edhe detyrimi për respektimin e standardeve të caktuara dhe kompetenca të caktuara për urdhërimin e mosvënies në qarkullim të materialeve të caktuara, si dhe mundësia e ushtrimit të një ndikimi të tërthortë përmes dhënies së subvencioneve në para (*cash*) ose në natyrë të cilat jepen me kusht përmbushjen e kushteve të caktuara. E megjithatë, në raste të tjera, nuk ka asnjë detyrim të veçantë për tu përmbushur, përveç atyre që parashikohen përgjithësisht në ligj.

Kërkesat bazë

133. Të gjitha **masat rregullatore**, sa i përket medias dhe internetit, dukë përfshirë edhe ato për përdorimin e gjuhës së urrejtjes duhet të jenë në përputhje me të

drejtën e lirisë së shprehjes dhe të ofrojë garanci kundër shpërdorimit të pushtetit që mund të aplikohet për të gjitha masat ligjore që prekin ushtrimin e kësaj të drejte (shqyrtuar në pjesën vijuese). Rekomandimi 7 nuk sugjeron miratimin e asnjë kompetence të re rregulluese, po thekson se duhet të shfrytëzohen të gjitha kompetencat ekzistuese – duke përfshirë edhe gamën e plotë të sanksioneve ekzistuese - që mund të jenë të përshtatshme për adresimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, për këtë qëllim, është e rëndësishme – siç është theksuar më sipër – se njohja mbi të cilën mbështetemi sa i përket gjuhës së urrejtjes duhet të jetë po aq e gjerë sa konstatohet edhe në këtë rekomandim. Përveç kësaj, këto kompetenca, ashtu siç ekzistojnë, do të jenë të dobishme vetëm nëse organet relevante bëjnë si monitorimin aktiv të subjekteve që presupozohet të rregullojnë – duke përfshirë edhe marrjen e iniciativave për të parë mënyrën e portretizimit të grupeve të caktuara të personave – ashtu edhe përgjigjen në mënyrë të menjëhershme në rastet që u vihen në vëmendje për përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

134. Për më tepër, organet rregullatore duhet të marrin masat që publiku të ndërgjegjësohet mjaftueshëm për rolin e tyre, në mënyrë që raste të tilla të vihen vërtet në vëmendje. Për fat të keq, vihet re se në ciklet e monitorimit është theksuar se organet relevante ndonjëherë ekzistojnë vetëm në letër, pasi ato nuk janë ngritur realisht siç duhet dhe kuptohet që në mënyrë që të realizohet vërtetë cilado mase rregullatore, kjo gjë duhet të zgjidhet. Megjithatë, në përputhje me nevojën e respektimit të së drejtës së lirisë së shprehjes, ato organe që kanë rol rregullator, duhet të vlerësojnë vullnetin për t'i dhënë prioritet përdorimit të kompetencave të tyre duke inkurajuar vetërregullimin efikas të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe jo të kërkojnë të ndërhyjnë vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë në funksionimin e medias dhe internetit.
135. Shtjellimi në rekomandimin 6 i **vetërregullimit**, sa i përket miratimit të kodeve të formuluar si duhet të sjelljeve (ose etikës), monitorimit, mekanizmave të ankesave dhe trajnimit vlen përgjithësisht për funksionimin e vetërregullimit nga mediat dhe për internetin. Prandaj, nuk përsëritet në këtë pjesë, por theksohen aspekte të caktuara me rëndësi të posaçme për median dhe internetin.

Kodet e sjelljes

136. Siç është theksuar në ciklet e monitorimit, janë miratuar tashmë kode të ndryshme sjelljeje (ose etike), të cilat përfshijnë dispozita për gjuhën e urrejtjes nga shumë profesionistë dhe organizata mediatike, duke përfshirë edhe industrinë e internetit⁷⁵. Disa prej tyre janë miratuar nga vetë profesionistët, ndërsa disa të tjera janë dokumente të brendshme të organizatave të veçanta, por shumë aplikohen në sektorë specifikë. Në disa raste ato janë tërësisht nisma e atyre që i kanë miratuar, po shpesh janë nxitur nga presioni rregullator. Megjithatë, ndonëse këto kode parashikojnë shpesh në mënyrë specifike se urrejtja nuk duhet të nxitet dhe se diskriminimi nuk duhet të përhapet, ato përgjithësisht nuk i mbulojnë të gjitha aspektet e gjuhës së urrejtjes, ashtu sikurse kjo gjuhë kuptohet në këtë rekomandim, duke përfshirë edhe format më të koduara të kësaj gjuhe. Përveç kësaj, në disa shtete anëtare, te vetmet kode që ekzistojnë janë të kufizuara – qoftë formalisht apo në praktike – duke u zbatuar vetëm për median e shkruar dhe nuk mund të zbatohen as edhe për faqet e internetit 'bijë' ku mund të postohet gjuha e urrejtjes.
137. Për këtë arsye, nevojitet të inkurajohet miratimi i kodeve që mbulojnë gamën më të gjerë të mundshme të përdorimit të medias dhe internetit. Përveç kësaj, këto kode – ose kushtet e përdorimit – duhet të rregullojnë këdo dhe jo vetëm

⁷⁵ Si Praktikë më të mira për përgjigjen ndaj krimeve të urrejtjes, të Ligës Kundër Shpifjes (ADL), nënshkruar nga Facebook, Google, Microsoft, Soundcloud, Twitter, Yahoo, YouTube dhe rrjete të tjera.

profesionistët dhe organizatat e medias, ndonëse mund të mos jetë e mundur që ato të mbulojnë të gjitha iniciativat individuale (si autopublikimi). Kjo nuk do të thotë se duhet të ketë vetëm një kod, pasi kjo mund ta bënte të vështirë, në mos të pamundur, marrjen parasysh të formave të ndryshme të komunikimit që përdoret. Megjithatë, sjelljet e parashikuara në këto kode duhet të përdorin shprehimisht kuptimin e gjuhës së urrejtjes që gjendet në këtë rekomandim.

138. Përveç kësaj, duke pasur parasysh ndikimin që duhet të ushtrohet nga media dhe interneti apo përmes tyre, do të ishte me vend që këto kode jo vetëm të ndalojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në të gjitha format e saj, por edhe të tregojnë mënyrat e paraqitjes së informacionit që nuk forcojnë domosdoshmërisht qëndrimet që ndalojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes, duke kërkuar që të merret parasysh si duhet këndvështrimi i personave të prekur nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në raportimin e ngjarjeve dhe inkurajimi i ngjarjeve që sfidojnë perceptimet negative për grupe të caktuar personash. Kështu, përfshirja në raportimet e lajmeve e origjinës etnike të autorit të dyshuar për një vepër penale është përgjithësisht jorelevante, por ky fakt mund të mbahet mend shpesh, pavarësisht se personi në fjalë mund të jetë shpallur më pas i pafajshëm. Është gjithashtu e nevojshme të tregohet kujdes në raportimin e ngjarjeve të caktuara, sidomos atyre që lidhen me ekstremistë apo terroristë, duke qenë se bërja e tyre sensacionale dhe fokusimi te dramat mund të forcojë negativisht paragjykimet dhe të ndezë pasionet.
139. Përveç kësaj, duhet marrë parasysh nëse ngjarje të caktuara që përfshijnë personat e stigmatizuar shpesh raportohen apo jo vetëm për shkak se ata që raportojnë ndajnë të njëjtat perceptime negative, si dhe nëse personat armiqësorë ndaj grupeve të tilla u jepet efektivisht akses i privilegjuar në organe të caktuara mediatike. Po kështu, kushtet e përdorimit të forumeve në internet apo në shërbime të ngjashme mund të përjashtojnë përdorimin e komenteve anonimë. Përveç kësaj, në to mund të përjashtohet edhe akses i natës ku kjo mundësi shihet se e lehtëson postimin e komenteve fyese. Për më tepër raportet në lidhje me ngjarje që përfshijnë apo që prekin persona të shënjestruar shpesh nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes – si ato që raportojnë përfshirjen e tyre në konflikte apo mosmarrëveshje të pretenduara – nuk pasqyrojnë shpesh pikëpamjen e tyre të rrethanave në fjalë, duke lejuar në këtë mënyrë përforcimin e keqinformimit dhe stereotipizimit negativ që kalon pa u kundërshtuar. Përveç kësaj, një stereotipizmi dhe stigmatizim i tillë mund të kundërshtohet edhe nga publikimi i raporteve që pasqyrojnë personat që u përkasin grupeve të caktuara personash që janë objekt i gjuhës së urrejtjes nga një këndvështrim pozitiv, si raportimet që trajtojnë integritetin e tyre të suksesshëm apo që shpjegojnë vlerat që qëndrojnë në themel të traditave të caktuara. Ky lloj raportimi mund të lehtësohet nga inkurajimi i krijimit të instrumenteve si fjalorët për gazetarët në lidhje me integritetin që shpjegon terma të caktuar kyçë, që janë vënë re në ciklin e monitorimit. Në këtë mënyrë, këto kode mund të inkurajojnë median që të zhvillojë narrativa të kundërta me ‘arsyetimin’ që mbështet përdorimin e gjuhës së urrejtjes⁷⁶.

Monitorimi

140. Një aspekt vendimtar i vetërregullimit është monitorimi i asaj çka komunikohet në media dhe përmes internetit. Kjo ka rëndësi të përgjithshme, por është veçanërisht e nevojshme në rastet kur ajo çka është komunikuar nuk ka qenë objekt i asnjë forme të kontrollit editorial. Edhe në rastet kur ka kode sjelljeje (apo etike), monitorimi nuk kryhet gjithmonë në mënyrë sistematike. Kjo është veçanërisht e vërtetë sa i përket përdorimit të gjuhës së urrejtjes në internet. Megjithatë, siç e kanë treguar disa shërbime në internet, ekzistojnë disa teknika automatike për

⁷⁶ Shih më tej, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, gazetarinë Etike dhe të drejtat e njeriut, CommDH (2011)40, 8 nëntor 2011).

kërkimin e gjuhës së urrejtjes dhe këto mund të plotësohen me mundësi specifike për raportimin e përdorimit të kësaj gjuhe dhe materialet në fjalë mund të hiqen më pas në përputhje me kushtet e përdorimit të shërbimit përkatës. Këto skema duhet të nxiten dhe, sa herë që është e mundur, të inkurajohen nga autoritetet rregullatore. Përveç kësaj, organet rregullatore duhet gjithashtu të inkurajojnë studimet për rritjen e efikasitetit të tyre. Për më tepër përdoruesit individualë, duhet të inkurajohen për të raportuar përdorimet e gjuhës së urrejtjes dhe organizatat joqeveritare duhet të mbështeten në marrjen përsipër të monitorimit ose funksionimit të pikave të kontaktit ose të linjave telefonikë në dispozicion, në mënyrë që të mund të identifikohen përdorimet e tilla të gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, monitorimi ka për të pasur vlerë vetëm nëse kjo çon në fshirjen në kohën e duhur të përdorimeve të gjuhës së urrejtjes që identifikohen dhe në angazhimin për ta bërë këtë nga disa platforma sociale që kanë filluar tashmë ti përdorin të dyja këto qasje. Në raste të veçanta, duhet marrë parasysh edhe nëse do të ishte apo jo me vend që përdorimet persistente të gjuhës së urrejtjes të përfshinin edhe bllokimin e aksesit në shërbime ku ndodh kjo.

Mekanizmat e ankesave

141. Ndikimi i mekanizmave të ankesave që ekzistojnë duket se varion. Ndonëse ka sigurisht raste, ku ankesat për përdorimin e gjuhës së urrejtjes shqyrtohen dhe pranohen, ka edhe shumë raste të tjera ku kjo gjë nuk ndodh. Përveç kësaj, siç theksohet më sipër, disa prej këtyre mekanizmave kufizohen te mediat e shkruara dhe sidomos te gazetat dhe revistat. Për më tepër, as këta mekanizma nuk zbatohen për të gjitha këto publikime, sepse ato bazohen tek anëtarësimi vullnetar dhe disa zgjedhin të mos bëhen pjesë e tyre. Gjithashtu, disa prej mekanizmave janë tërësisht organe të brendshme të mediave të caktuara apo subjekteve të caktuara të internetit. Për më tepër, disa prej tyre nuk përballen me shumë ankesa, pavarësisht shkallës së përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe kjo duket se mund ti atribuohet pjesërisht faktit që këta mekanizma nuk janë shumë të njohur dhe se, aty ku nuk është kështu, mungon besimi se ata do të ishin efikasë. Sigurisht që çfarëdolloj vendimi të merret – vendime që zakonisht përfshijnë publikimin e konstatimit specifik të mekanizmit – ai nuk është përgjithësisht i detyrueshëm dhe jo gjithmonë merren masat e kërkuara.
142. Prandaj, është e nevojshme që çfarëdolloj mekanizmi ankesash që zbatohet për sektorë të caktuar të medias dhe internetit – që nuk janë tërësisht organe të brendshme për të mbuluar edhe sektorë që aktualisht nuk mbulohen ose që te ngrihet organe të posaçme për këta sektorë. Për më tepër, besimi tek mekanizma të tillë mund të rritet duke marrë masat që ata të njihen më mirë, të gëzojnë pavarësi të qartë nga ndikimi i atyre që i vlerësojnë sjelljen dhe që roli dhe vendimet e tyre të pranohen më gjerësisht ku këto të fundit të bëhen mjaftueshëm të dukshme, në mënyrë që çfarëdolloj dënimi i gjuhës së urrejtjes të jetë i qartë për të gjitha palët e interesuara. Prandaj, inkurajohet marrja e hapave në këtë drejtim nga organet rregullatore.

Ruajtja e lirisë së shprehjes

143. Në të njëjtën kohë, masat vetërregulluese nuk duhet të çojnë në ndërhyrje të pajustificuara në të drejtën e lirisë së shprehjes. Kështu, bllokimi dhe fshirja e materialeve, për shembull, nga platformat sociale do të justifikohet vetëm në rastet ku përfshihet përdorimi real i gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, mundet sigurisht që zbatimi i kodeve të sjelljes dhe kushteve të përdorimit që çojnë në bllokim dhe fshirjen e materialeve të mund të përfshijnë në fakt edhe interpretime të gabuara apo më të gjëra se sa duhet sa i përket asaj çka përbën gjuhë urrejtjeje duke çuar në raste të veçanta të sforcimit në mënyrë të pajustificueshme të ushtrimit të lirisë së shprehjes. Prandaj, është e nevojshme që vendimet që kanë si pasojë bllokimin ose fshirjen e materialeve të jenë subjekt apelimi dhe, në fund, kundërshtimi në

gjykatë. Pa këto masa, nuk ka për të pasur mbrojtje të mjaftueshme të së drejtës së lirisë së shprehjes.

Ofrimi i trajnimit

144. Ashtu sikurse me format e tjera të vetërregullimit, është e nevojshme të merren masa që personave të përfshirë në këtë proces t'u ofrohet **trajnimi i duhur**. Profesionistët e medias në veçanti, duhet jo vetëm të kenë një njohje më të thellë të asaj çka përbën gjuhë urrejtjeje, por edhe të vlerësojnë se si, përmes asaj çka shkruajnë dhe botojnë, të mund të shmangin lehtësimin e përdorimit të saj dhe të kundërshtojnë kushtet që çojnë në rritjen e përdorimit të kësaj gjuhe përmes promovimit të tolerancës dhe mirëkuptimit më të madh mes kulturave.

J. Përgjegjësia administrative dhe civile

Rekomandimi 8

145. Ky rekomandim lidhet me vendosjen e përgjegjësive administrative dhe civile për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Ai trajton në mënyrë të veçantë qartësimin e përgjegjësive të ndryshme që mund të dalin në lidhje me përdorimin e kësaj gjuhe, dukë marrë parasysh mënyrat e ndryshme në të cilat ky përdorim mund të ndodhë dhe shkallën e përfshirjes që mund të kenë aktorë të ndryshëm me të. Përveç nevojës për adresimin e dëmeve të veçanta që duhet të rregullohet nga këndvështrimi i rekomandimeve në paragrafët 10 – 13 dhe 15 të RPP nr. 7, rekomandimi 8 , identifikon nevojën për kompetenca specifike për të kërkuar fshirjen e një gjuhe të caktuar urrejtjeje, bllokimin e faqeve të internetit që përdorin gjuhën e urrejtjes, si dhe publikimin e pranimit se është publikuar gjuha e urrejtjes, se distancohet dhe detyrimin e nxjerrjes së identiteteve të personave që e kanë përdorur një gjuhë të tillë. Këto kompetenca propozohen vetëm për rastet më të rënda ku ndodh përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe kërkojnë që përdorimi i kësaj gjuhe të jetë objekt i autorizimit ose miratimit gjyqësor me qëllim garantimin e respektimit të së drejtës së lirisë së shprehjes.
146. Me qëllim garantimin e marrjes së masave të duhura kundër këtyre rasteve më të rënda të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, rekomandohet gjithashtu që ligjitimiteti për të shkuar drejt procedimeve relevante të zgjerohet për të përfshirë jo vetëm ata që preken nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në fjalë, por edhe organet e barazisë, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e interesuara joqeveritare. Përveç kësaj, përdorimi efikas i këtyre kompetencave njihet se përfshin edhe trajnimin e gjyqtarëve, avokatëve dhe zyrtarëve të përfshirë në proces si dhe shkëmbimin e praktikave të mira mes atyre që përfshihen në ushtrimin e këtyre kompetencave.

Qartësimi i bazës së përgjegjësive

147. Në pjesën më të madhe të rasteve, dëmi që vjen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes është i natyrës morale. Megjithatë, mund të ketë edhe raste ku personat e prekur nga ky përdorim mund të tregojnë gjithashtu se kjo gjë u ka shkaktuar atyre vuajtjen e dëmeve materiale si në rastet kur kjo mund të lidhet me mohimin e një mundësie punësimi apo me humbjen e aftësisë për të punuar për shkak të shëndetit jo të mirë. Prandaj, duhet që ligji të qartësojë rastet e veçanta, ku **dëmshpërblimi mund të jetë i pagueshëm** dhe bazën sipas së drejtës administrative apo civile, mbi të cilën mund të kërkohej ky dëmshpërblim, qoftë si në disa shtete anëtare për mbrojtjen e personalitetit dhe reputacionit ose duke iu referuar shkeljeve të tjera administrative apo civile. Përveç kësaj, përdorimi i gjuhës së urrejtjes mund të dëmtojë edhe reputacionin e një komuniteti të tërë apo një grupi personash. Megjithatë, ndonëse dëmet specifike individuale mund të mos jenë domosdoshmërisht të rëndësishme në të gjitha këto raste, aftësia për të kërkuar

deklarimin se është dëmtuar dhe/ose dëmshpërblim civil mund të ishte masa e duhur dhe duhet të parashikohet me ligj.

148. Më tej, për tu siguruar që të mos ketë ndërhyrje të pajustificuara në të drejtën e lirisë së shprehjes, çdo përgjegjësi duhet të kufizohet tek përdorimet më të rënda të gjuhës së urrejtjes dhe, konkretisht, tek ato raste që kanë për qëllim apo prej të cilave mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të nxisin akte dhune, frikësimi, armiqësimi apo diskriminimi ndaj personave të cilëve u drejtohen. Kështu, për konstatimin e çfarëdolloj përgjegjësie nuk duhet të mjaftojë që të vërtetohet se ka pasur dëme apo humbje si rrjedhojë e përdorimit të caktuar së gjuhës së urrejtjes; ky përdorim i caktuar duhet gjithashtu të jetë i një shkalle të tillë – domethënë, kur ekziston qëllimi i nxitjes apo rreziku i atypëratyshëm që kjo të ndodhë – që të kërkohej konstatimi i këtyre përgjegjësive.

Njohja e përgjegjësive të ndryshme

149. Në të njëjtën kohë, ky qartësim është gjithashtu i nevojshëm sa u përket atyre që mund të vlerësohen përgjegjës në këtë mënyrë për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Kjo ka një rëndësi vendimtare duke qenë se, siç thekson rekomandimi 8, aty ku përdoret gjuha e urrejtjes mund të përfshihen shumë lloje të ndryshme subjektësh dhe mjetësh komunikimi. **Për rregullimin e përgjegjësive të tyre përkatëse**, nëse ka përgjegjësi të tilla, si rrjedhojë e përdorimit të mesazheve të gjuhës së urrejtjes, duhet të krijohet kuadri i duhur ligjor.
150. Ndonëse autori fillestar i përdorimit të caktuar të gjuhës së urrejtjes mund të ketë një lloj përgjegjësie për këtë përdorim, në përcaktimin e shkallës së ndarjes së kësaj përgjegjësie me persona të tjerë – nëse ka edhe persona të tjerë përgjegjës – do të duhet të merren parasysh faktorë si nëse ata persona kanë marrë apo jo pjesë aktive në shpërndarjen e mesazhit, nëse kanë qenë apo jo në dijeni se mjetet e tyre po përdoren për këtë qëllim, nëse kanë pasur dhe përdorur apo jo teknika të caktuara për ta identifikuar një përdorim të tillë dhe personat përgjegjës për të dhe nëse kanë vepruar apo jo menjëherë për të mos e lejuar vazhdimin e këtij përdorimi nga momenti që janë vënë në dijeni se po ndodh diçka e tillë. Në këtë kontekst duhet të theksohet se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar se e drejta e lirisë së shprehjes nuk është shkelur në rastet kur një kompani është shpallur përgjegjëse ndaj personave të prekur nga gjuha e urrejtjes e postuar në portalin e saj të lajmeve në internet⁷⁷. Ajo doli me këtë vlerësim duke pasur parasysh natyrën ekstreme të komenteve, mungesën e mjeteve të identifikimit të personit që i kishte postuar komentet në mënyrë që ta ndiqte, mosparandalimin dhe mosheqjen në mënyrë të menjëhershme të komenteve, si dhe faktin se pasojat ekonomike të kësaj përgjegjësie nuk ishin thelbësore për kompaninë duke qenë se dëmshpërblimi i vendosur ishte proporcional dhe nuk prekte operacionet e biznesit⁷⁸.
151. Përveç kësaj, në disa raste, mundësia për shfrytëzimin e mjeteve të caktuara për përdorimin e gjuhës së urrejtjes mund të pasqyrojë mospërmbushje të kërkesave rregullore. Në raste të tilla, kur vendosja rrjedhimisht e çfarëdolloj **sanksioni administrativ**, si gjobë apo humbje të licencës apo franshizës, do të duhet të merren parasysh rrethanat e veçanta të rastit, duke përfshirë faktin nëse ka pasur apo jo paralajmërime të mëparshme për mospërmbushjet në fjalë. Mosmarrja parasysh e këtyre rrethanave mund të çojë në masa joproporcionale, të cilat nuk do të ishin konsistente me të drejtën e lirisë së shprehjes.

⁷⁷Delfsi As kundër Estonisë (GC) nr. 64569/09, 16 qershor 2015.

⁷⁸ Cf. *Magyar Tartalomsgátlatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër Hungarisë*, nr. 22947/13, 2 shkurt 2016, ku fakti që nuk ishte përdorur gjuha e urrejtjes që një faktor në vlerësimin nga gjykata se vendosja e përgjegjësive mbi kompaninë për një postim në portalin e saj në internet kishte çuar në fakt në shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes

Masa të tjera korrigjuese përveç dëmshpërblimit

152. Përveç pagesës së dëmshpërblimit dhe vendosjes së sanksioneve administrative, rekomandimi 8 parashikon nevojën për ekzistencën e **masave të tjera korrigjuese** për trajtimin e rasteve kur përdoren gjuha e urrejtjes. Këto masa – fshirja, bllokimi i faqeve të internetit, publikimi i pranimit, distancimi nga përhapja dhe bërja publike e identiteteve/nxjerrja me detyrim – që të gjitha përfshijnë ndërhyrje të konsiderueshme në të drejtën e lirisë së shprehjes. Megjithatë, përdorimi i tyre nuk përfshin domosdoshmërisht shkeljen e Nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi kjo është konsideruar masë e përshtatshme në një sërë rrethanash nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁷⁹. Prandaj, duhet të tregohet kujdes që këto masa të merren vetëm në rastet kur përdorimi i gjuhës së urrejtjes në fjalë të jetë i asaj shkalle që kërkon rekomandimi 8 – domethënë që të ketë pasur si synim apo të pritët në mënyrë të arsyeshme të çojë në nxitjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisimit ose diskriminimit ndaj personave që prek – dhe që kjo të mos kërkohet realisht vetëm për zgjidhjen e situatës në fjalë, po edhe të mos jetë më e gjerë në efekte sesa ajo që kërkohet⁸⁰. Për shembull, nuk është nevoja që të kërkohet fshirja apo publikimi i një pranimi nëse kjo është bërë.

Rëndësia e kontrollit gjyqësor

153. Më tej, kërkesa që çdo ushtrim i këtyre kompetencave të jetë objekt i autorizimit apo miratimit gjyqësor është një reflektim i rëndësisë themelore që ka aftësia e gjykatave për të ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës dhe për të ofruar në këtë mënyrë një garanci ndaj mundësisë së çfarëdolloj ndërhyrjeje të pajustificuar në të drejtën e lirisë së shprehjes. Në shumicën e rasteve, ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të kërkojë miratimin paraprak nga gjykata, por pranohet gjithashtu se mund të ketë situata urgjente ku nuk është me vend të pritët një miratim i tillë para se të veprohet, kështu që kontrolli gjyqësor mund të ndodhë pasi është ushtruar një kompetence e caktuar.

Legjitimiteti për të ngritur padi

154. Mundësia për të kërkuar përdorimin e këtyre kompetencave duhet t'u jepet sigurisht atyre që janë prekur nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në fjalë. Në fakt, në disa shtete anëtare ekzistojnë tashmë mundësitë që një person, të cilit i është prekur personaliteti nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes të kërkojë ndalimin e vazhdimin të kësaj ndërhyrjeje të paligjshme dhe/ose heqjen e efekteve të saj. Përveç kësaj, duke qenë se procedimi gjyqësor ka për të qenë një pjesë thelbësore e procesit është e domosdoshme që këtyre personave t'u vihet në dispozicion edhe **ndihmë juridike**. Megjithatë, rekomandimi 8 parashikon gjithashtu **rolin e organeve të barazisë, institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatave të interesuara joqeveritare** në kërkimin e ushtrimit të kompetencave për të kërkuar fshirjen, bllokimin e faqeve të internetit dhe publikimin e pranimit, si dhe urdhërimin e ndalimit të shpërndarjes dhe bërjes së ditur të identiteteve. Kjo reflekton vlerësimin se këto subjekte mund të luajnë që të gjitha një rol në monitorimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Si rrjedhojë, këto subjekte mund të jenë veçanërisht në pozicion të mirë për të vërtetuar nevojën e ushtrimit të këtyre kompetencave dhe për të iniciuar procesin që çon pikërisht aty. Parashikimi i dispozitave specifike që funksionojnë në këtë mënyrë mund të

⁷⁹ *Shih Andreas Wabl k. Austrisë* nr. 24773/94, 21 mars 2000, *Nordisk Film & TV A/S k. Danimarkës*, nr. 40485/02, 8 dhjetor 2005, *Keller k. Hungarisë* (dec.), nr. 33352/02, 4 prill 2006 dhe *Peta Deutschland k. Gjermanisë*, nr. 43481/09, 8 nëntor 2012

⁸⁰ Cf. masat tejet të gjëra bllokuese të konstatuara në çështjen *Yildirim k. Turqisë*, nr.3111/10, 18 dhjetor 2012 dhe *Cengiz e të Tjerë k. Turqisë*, nr. 48226/10, 1 dhjetor 2015 në shkelje të nenit 10.

garantojë që këto kompetenca do të jenë jo vetëm zgjidhje teorike për përdorimin e gjuhës së urrejtjes, por do të jenë edhe kompetenca praktike dhe efikase.

Nevoja për trajnim

155. Përfundimisht, ashtu sikurse edhe në rastin e masave të tjera që duhet të merren për adresimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, është e nevojshme të merren masat që gjyqtarët, avokatët dhe zyrtarët e përfshirë në ofrimin e zgjidhjeve të ndryshme administrative dhe civile për këtë përdorim të marrin **trajnimin e duhur**. Kjo është e rëndësishme për t'i bërë ata të aftë të vlerësojnë nëse ka ndodhur apo jo përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe nëse ka ndodhur, nëse është i një shkalle të mjaftueshme që kërkon përdorimin e këtyre zgjidhjeve, si dhe nëse përdorimi apo jo specifik i një zgjidhjeje të caktuar është konsistent me të drejtën e lirisë së shprehjes. Përveç trajnimeve, këto qëllime mund të lehtësohen edhe nga shkëmbimi i praktikave të mira përmes atyre që janë marrë me këto çështje, ku mund të kërkojnë zgjidhje administrative dhe civile. Këto shkëmbime nuk duhet të kufizohen mes shkëmbimeve mes gjyqtarëve, avokatëve dhe zyrtarëve në shtetet anëtare të caktuara, po duhet të zgjerohen edhe në shtete të tjera anëtare për t'u siguruar që përfitimet nga përvojat e tyre të ndahen sa më gjerësisht. Të gjitha këto shkëmbime duhet të lehtësohen nga shtetet anëtare.

K. Sanksione administrative dhe të tjera kundër organizatave

Rekomandimi 9

156. Ky rekomandim lidhet në mënyrë të veçantë me përgjigjen e përshtatshme që duhet dhënë ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga partitë politike apo organizatat e tjera si dhe nga personat që u përkasin atyre. Parashikohet një përgjigje e dyfishtë ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga ana tyre. Së pari, do duhej një tërheqje e mbështetjes financiare dhe formave të tjera të mbështetjes nga ana e organeve publike nëse përdoren format e ndryshme të gjuhës së urrejtjes nga këto entitete, apo nëse është rasti kur anëtarë e tyre i përdorin ato dhe ky përdorim nuk dënohet. Së dyti, do duhej një dispozitë për ndalimin apo shpërndarjen e partive politike dhe organizatave të tjera - pavarësisht nëse këto të fundit janë përfituese të mbështetjes – nëse përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga ana tyre ka karakter më të rëndë, specifikisht, ka qëllime apo, në mënyrë të arsyeshme, mendohet së mund të nxisë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi.
157. Dy format e përgjigjes të rekomanduara ngrihen mbi bazat e paragrafëve 16 dhe 17 të Rekomandimit nr. 7 të Politikës së Përgjithshme. Në veçanti, rekomandimi 9 lidhet me përdorimin e gjuhës së urrejtjes në përgjithësi dhe jo vetëm në promovimin e racizmit i cili trajtohet në Rekomandimin nr. 7 të Politikës së Përgjithshme. Për më tepër, **kushti për tërheqjen e mbështetjes nga ana e organeve publike** gjen shtrirje në gjithë format e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Në këtë mënyrë mbulon jo vetëm dhënien e granteve, huave apo formave të tjerat të financimit për aktivitetet e partive politike dhe organizatave të tjera të interesuara por dhe vënien në dispozicion ndaj tyre të godinave apo hapësirave, mundësinë e përdorimit të personelit dhe çdo lloji tjetër asistence praktike. Megjithëse rekomandimi synon tërheqjen e cilësdo forme mbështetjeje, në mënyrë të tërthortë, shprehet në të se mbështetja nuk duhet dhënë ndaj partive politike dhe organizatave të tjera nëse vërehet se kushtet e specifikuara plotësohen në momentin kur shprehet kërkesa për plotësimin e kushtit. Masat e parashikuara në rekomandimin 9 duhet të ndërmerren si ndaj partive politike dhe organizatave të tjera të cilat kanë status zyrtar dhe ndaj atyre që kanë karakter më jo-zyrtar apo të cilat ekzistojnë *de facto*. Në çdo rast, rekomandimi 9 njihet se gjithë këto masa duhet gjithmonë të zbatohen në mënyrë koherente me kushtet e së drejtës së mbledhjes.

Arsyetimi

158. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga organizata të ndryshme, si dhe mungesa e sanksionimit të përdorimit të saj nga ana e anëtarëve të tyre, ka qenë një shqetësim i vërejtur në ciklet monitoruese. Në veçanti, kjo ka përfshirë kultivimin dhe shpërndarjen nga ana e tyre të Neo-nazizmit, racizmit dhe ksenofobisë. Në shumë raste, entitetet e përfshira kanë qenë parti politike – përfshirë ato të përfaqësuara në legjislaturë – dhe organizata të tjera në fushata. Megjithatë, përdorimi i gjuhës së urrejtjes është vënë re edhe nga organizata të tjera – përfshirë vëllazëritë studentore brenda universiteteve dhe shoqatat e mbështetësve të futbollit. Në disa raste, organizatat të cilat kanë përdorur gjuhë urrejtje kanë marrë në po të njëjtën kohë forma të ndryshme të mbështetjes publike, zakonisht mbështetje financiare në rastin e partive politike dhe vënie në dispozicion të ambienteve nëpër godina për entitetet e tjera të përfshira.

Praktika aktuale

159. Ciklet monitoruese kanë vënë re se disa elemente të masave të cilat po rekomandohen tani janë ekzistuese në disa Shtete anëtare. Ndaj, ekziston mundësia për të ndërprerë financimin publik për parti politike të cilat verifikohet se janë në pozita armiqësore përkundrejt të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Për më tepër, në shumë Shtete anëtare ekzistojnë kompetenca për të ndaluar apo shpërbërë organizata, kryesisht, ato organizata të cilat mbështesin urrejtjen racore apo nacionaliste, nxisin dhunën dhe kërcënojnë demokracinë. Megjithatë, është vënë re gjithashtu se manovrat për ndërprerjen e financimeve publike për partitë politike nuk kanë funksionuar gjithmonë, veçanërisht për arsye të vështirësive në përmbushjen e kushteve procedurale dhe interpretimin e ngushtë të dhënë ndaj kushteve materiale. Për më tepër, aty ku ka pasur kompetenca për ndalimin apo shpërbërjen e organizatave të cilat promovojnë racizmin, është vënë re se asnjë veprim nuk është ndërmarrë, në fakt. Kjo mundet të ketë ndodhur për shkak të moskryerjes nga ana e autoriteteve kompetente të veprimeve aktive në mënyrë të mjaftueshme për mbledhjen e provave të cilat kërkohen për procedime të tilla apo të cilat janë pjesë e kushteve të vetë përcaktuara për të konkretizuar dhënien e një dënimi ndaj një apo më shumë pjesëtarëve të entiteteve në fjalë. Më tej, në disa Shtete anëtare nuk ekzistojnë ende kompetencat për të ndaluar apo shpërbërë organizata të cilat promovojnë racizmin.

Justifikimi për masat

160. Tërheqja e mbështetjes ndaj partive politike apo organizatave të tjera ka patjetër potencial për të shkelur të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit të pjesëmarrësve të tyre apo pjesëmarrësve të financimit. Kjo vlen edhe më shumë në rast të masave të cilat rezultojnë në **ndalimin dhe shpërbërjen** e tyre. Megjithatë, e drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit është e garantuar në nenin 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 22 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Së bashku këto të fundit garantojnë të drejtën me kusht që të mund të jetë subjekte e kufizimeve në rast se këto kufizime janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e objektivave të ndryshme, dhe më kryesisht, të të drejtave dhe lirive të së tjerëve. Për më tepër, të dyja traktatet përcaktojnë në mënyrë specifike se asnjë nga dispozitat e tyre “nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara” në to ose kufizime më të gjera të këtyre të

drejtave ose lirive sesa është parashikuar në këto dispozita⁸¹. Për më tepër, Neni 20(2) i Paktit përcakton gjithashtu se “Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohej me ligj”.

161. Më tej, Neni 4 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial “dënon çdo propagandë dhe të gjitha organizatat të bazuara në idetë ose teoritë e epërsisë së një race apo të një grupi personash të një ngjyre apo origjine etnike të caktuar, ose të cilat përqipen të justifikojnë atë e të ndihmojnë çdo formë të urrejtjes e të diskriminimit racial; ato zotohen të marrin masa të menjëhershme dhe pozitive për të zhdukur çdo nxitje për një diskriminim të tillë ose akt diskriminues dhe për këtë qëllim, duke mbajtur parasysh, si duhet, parimet e shprehura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e shpallura posaçërisht në nenin 5 të kësaj Konvente, ato zotohen konkretisht: (a) Të shpallin vepra të dënueshme me ligj ... ndihmën e veprimtarive raciste, duke përfshirë këtu edhe financimin e tyre; (b) Të shpallin të paligjshme dhe të ndalojnë organizatat si dhe veprimtaritë propagandistike të organizuara e çdo aktivitet tjetër propagandistik që ndihmon dhe nxit diskriminimin racial dhe pjesëmarrjen në këto organizata dhe veprimtari të shpallin vepër të dënueshme me ligj; (c) Të mos lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike, qofshin ato kombëtare ose lokale, që ndihmojnë diskriminimin racial apo ta nxisin atë”.
162. Në disa prej rekomandimeve të përgjithshme, Komiteti mbi Eliminimin e Diskriminimit Racial ka nënvizuar nevojën për Shtetet Palë që ato të përmbushin detyrimet e tyre sikundër parashikuar në nenin 4(b) të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial për të deklaruar si të paligjshme dhe për të ndaluar organizatat që promovojnë apo nxisin diskriminimin racor. Ky nënvizim vjen gjithashtu së fundmi në *Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 Luftimi i fjalimit të urrejtjes raciale*), në të cilin qartëson edhe se ka konsideruar që “referenca ndaj Nenit 4 për “aktivitetet e propagandës së organizuar” përfshin format e organizimit apo rrjetet dhe që “gjithë aktivitetet e tjera të propagandës” mund të merren në konsideratë kur i referohemi promovimit dhe nxitjes të pa organizuar dhe spontane të diskriminimit racial” (CERD/C/GC/35, 26 Shtator 2013, pika 21). Kjo qasje është koherente me këndvështrimin sipas të cilit mbledhjet ndaj të cilave garantohej zbatimi i së drejtës së lirisë së tubimit dhe organizimit përfshijnë si ato organizata me dhe ato pa personalitet juridik të veçantë të anëtarëve të tyre⁸².
163. Për më tepër në vërejtjet përmbyllëse në raportet periodike të paraqitura sipas Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racial, Komiteti ka shprehur gjithashtu nevojën për disa Shtete Palë – përfshirë Shtetet anëtare – për të miratuar një legjislacion i cili kriminalizon organizatat raciste dhe pjesëmarrjen në to, si dhe penalizon organizatat të cilat përhapin stereotipa raciste dhe urrejtjen ndaj personave që u përkasin pakicave. Gjithashtu, ka komentuar mbi nevojën e forcimit dhe përdorimit të ndalimeve ekzistuese. Veçanërisht, Komiteti është shprehur i shqetësuar lidhur me disa raste të mosveprimit për ndalimin e organizatave të përfshira në përhapjen e ideve të epërsisë etnike apo urrejtjes etnike, apo për përdorimin e gjuhës denigruese apo avokimit të dhunës bazuar në këto ide pavarësisht rasteve të cilat janë sinjalizuar gjerësisht në shtetin e interesuar.
164. Për më tepër, nevoja për ndalimet të cilat duhen imponuar mbi shoqatat raciste ka qenë në subjekte e disa rekomandimeve në Rishikimin Periodik Universal.
165. Në kontekstin e kufizimeve të së drejtës së mbledhjes të diskutuara më lart, nuk befason fakti se si Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut si dhe

⁸¹ Neni 17 dhe 5 përkatësisht.

⁸² Shih Komisionin Evropian për Demokracinë nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Udhëzime mbi Lirinë e Mbledhjes* (2014), pika 48.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kanë dalë në përfundimin se këto masa sikundër dhe ato të rekomandimit 9 që janë për t'u ndërmarrë kundër partive politike dhe organizatave të tjera – përfshirë masat lidhur me ndalimin apo shpërbërjen e tyre – nuk janë domosdoshmërisht në mospërputhje me të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit. Dhe ky ka qenë rasti veçanërisht për entitetet të cilat kanë promovuar fashizmin⁸³, kanë avokuar politika me motivim racor së bashku me frikësim të bashkërenduar në shkallë të gjerë⁸⁴, kanë nxitur urrejtjen dhe diskriminimin⁸⁵ apo ndryshe kanë kërkuar të përmbushin qëllime të cilat janë jo koherente me parimin e pluralizmit dhe ndaj kane qenë cenuese të parimeve demokratike⁸⁶.

166. Gjithashtu, në vërejtjet përfundimtare të paraqitura në raportet periodike të Shteteve Palë në Konventë, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut ka bërë thirrje edhe për një legjislacion specifik i cili kriminalizon organizatat raciste dhe ka shprehur nevojën për të ndërmarrë hapa më efikase për luftimin e urrejtjes, dhunës dhe diskriminimit si dhe përcaktimin e detyrimit për çdo palë të përfshirë si dhe të partive politike për të pasur një kod sjelljeje dhe etike në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Në të njëjtën mënyrë, në vërejtjet përmbyllëse në raportet periodike të paraqitura sipas Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e gjithë Formave të Diskriminimit Racial, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial ka rekomanduar miratimin e masave juridike dhe politike me qëllim parandalimin e kryerjes dhe përhapjes së aktiviteteve, sipas nevojës, nga organizatat të cilat janë përfshirë në sulme të vazhdueshme kundër të huajve dhe anëtarëve të “pakicave të dukshme”.

Kushtet për t'u respektuar

167. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe dy Komitetet janë gjithashtu të vetëdijshëm për mundësinë potenciale që kanë masat e parashikuara në rekomandimin 9 për të shkelur të drejtë e lirisë së tubimit dhe organizimit. Për këtë arsye, të dyja Komitetet kanë shprehur shqetësimin e tyre në vërejtjet përmbyllëse të raporteve periodike rreth mundësisë së një legjislacioni të orientuar kundër “ekstremizmit” i cili mund të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë tepër të gjerë, duke shënjestruar apo vendosur në dizavantazh ruajtësit e të drejtave të njeriut të cilët promovojmë eliminimin e diskriminimit racial dhe duke mos mbrojtur individë apo organizata kundër arbitraritetit në zbatueshmëri. Gjithashtu, ka pasur shumë raste ku ndalimi i themelimit të partive politike dhe organizatave të tjera apo shpërndarja e tyre e kërkuar në zbatim të ligjit janë gjetur të pa justifikueshme nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁸⁷. Ndaj gjithë masat të cilat kanë prekur si ekzistencën e partive politike dhe organizatave të tjera dhe si aftësinë e tyre për të vepruar duhet të mbështeten mbi baza arsyetimi të sakta dhe të mjaftueshme dhe të jenë proporcionale me fushën e veprimtarisë së tyre.
168. Tërheqja nga organet publike nga forma të ndryshme të mbështetjes për parti politike dhe organizata të cilat përdorin gjuhën e urrejtjes apo të cilat nuk sanksionojnë anëtarët e tyre të cilët e kanë e përdorur atë përfaqëson në parim një kufizim i cili është në përputhje me të drejtat e lirisë së tubimit dhe organizimit. Megjithatë, kjo tërheqje, me shumë mundësi, do të konsiderohet si jo proporcionale

⁸³ Për shembull, *M. A. k. Italisë*, Komunikata nr. 117/1981, 10 prill 1984.

⁸⁴ Për shembull, *Vona k. Hungarisë*, nr. 35943/10, 9 korrik 2013.

⁸⁵ *Shoqata e re e djemve të Boulogne k. Francës* (vendimi), nr. 6468/09, 22 shkurt 2011.

⁸⁶ Për shembull, *Refah Partisi (Festa e Lamtumirës) dhe të Tjerë k. Turqisë* [Dhomë e Madhe], nr. 41340/98, 13 shkurt 2003 dhe *Kalifatstaat k. Gjermanisë* (vendimi), nr. 13828/04, 11 dhjetor 2006.

⁸⁷ Për shembull, *Sidiropoulos dhe të Tjerë kundër Greqisë*, nr. 26695/95, 10 korrik 1998, *Organizata e Bashkuar e Maqedonisë Ilinden dhe të Tjerë kundër Bullgarisë*, nr. 59491/00, 19 janar 2006, *Tourkiki Enosi Xanthis dhe të Tjerë kundër Greqisë*, nr. 26698/05, 27 mars 2008 dhe *Shoqata e Qytetarëve Radko & Paunkovski kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 74651/01, 15 janar 2009.

me situatën, përveç se kur ka një angazhim institucional të qartë për të përdorur gjuhën e urrejtjes. Ekzistenca e saj do të jetë e padyshimtë jo vetëm nëse verifikohet në dokumente politike apo në prononcime nga personalitete udhëheqëse në partitë politike apo në organizatat e përfshira por, gjithashtu kur përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga individë anëtarë të tyre pa asnjë kundërshtim ndaj këtij fakti. Nga ana tjetër, do të jetë më pak pa e qartë nëse përdorimi i saj sjell për pasojë jo më shumë se një akt të izoluar në vërejtje të shprehura nga një anëtar individual.

169. Kushtet për ndalimin apo shpërndarjen e një partie politike apo organizate tjetër janë edhe më të rrepta varësisht sa e rëndë është masa e dhënë⁸⁸. Kjo reflektohet në kufizimin e dhënë nga rekomandimi 9 mbi përdorimin e kësaj mase në situata në të cilat gjuha e urrejtjes përdoret me qëllim apo në të cilat mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që nga përdorimin e saj nxiten akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi. Ndaj në këtë rast do të lindë nevoja për të përcaktuar provat e dukshme që tregojnë se qëllimi ekzistonte apo që me shumë gjasa aktet në fjalë do të ndodhnin. Për më tepër, nëse përdorimi i gjuhës së urrejtjes në fjalime apo në sjelljen e individëve nuk duket në dokumentet politike zyrtare apo në prononcime, do të lindë nevoja gjithashtu për të provuar se ato i përkasin, në fakt, shprehjeve të partisë apo organizatës së përfshirë dhe se tregojnë qartazi qasjen që partia apo organizata mbështet dhe avokon⁸⁹. Në shumicën e rasteve të tilla, fjalimet apo sjelljet mbahen nga ana e personaliteteve udhëheqëse në një parti apo organizatë. Ndaj, është e udhës të theksohet më pak në këtë lloji konteksti fjala apo veprimi i një individi anëtar, përfshirë udhëheqës të mëparshëm, nëse nuk përsëritet nga partia apo organizata shprehimisht apo në mënyrë të tërthortë⁹⁰.
170. Tërheqja nga çdo lloji forme mbështetjeje ndaj një partie politike apo organizate duhet të jetë gjithnjë e hapur dhe të mund të kundërshtohet në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Për më tepër, ndalimi apo shpërndarja e një partie politike apo organizatë tjetër duhet të urdhërohet vetëm nga një gjykatë dhe urdhri në fjalë duhet të jetë subjekt i një ankimi të menjëhershëm. Respektimi i këtyre kushteve është themelor për ruajtjen e së drejtës së lirisë së tubimit dhe organizimit⁹¹.

L. Përgjegjësia penale dhe sanksionet

Rekomandimi 10

171. Ky rekomandim lidhet me rrethana në të cilat duhet të lëshohen sanksione penale për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Dhënia e tyre konsiderohet si e përshtatshme në rrethana të kufizuara për shkak të rrezikut potencial që ato përbëjnë në shkëlqen e të drejtës së lirisë së tubimit dhe organizimit. Megjithatë, edhe në këtë rast nuk duhet të ketë dhënie të sanksioneve penale në rast se përdorimi në një rast të posaçëm të gjuhës së urrejtjes mund të trajtohet me masë me natyrë më pak

⁸⁸ Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Udhëzime për Rregullimin e Partive Politike* (2011), pikat 89-96 dhe Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, *Udhëzime për Lirinë e Mbledhjes* (2014), paragrafë 247-256.

⁸⁹ Shih *Refah Partisi (Festa e Lamtumirës) dhe të Tjerë kundër Turqisë* [Dhomë e Madhe], nr. 41340/98, 13 shkurt 2003, në pikat 101 dhe 111-115.

⁹⁰ Shih për shembull përfundimet në *Partia Socialiste dhe të Tjerë kundër Turqisë* [Dhomë e Madhe], nr. 21237/93, 25 maj 1998 sipas të cilave fjalimet e një ish-kryetari nuk kanë sjellë prova të objektivave të pa pranueshme të partisë ndaj dhe të justifikimit të shpërbërjes së saj.

⁹¹ Shih për shembull pikat 10 dhe 74 të Rekomandimit CM/Rec(2007)14 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me statusin juridik të organizatave jo-qeveritare në Evropë.

kufizuese. Gjithashtu, rekomandimi adreson mënyrën se si përkufizohen veprat penale të ndryshme pasi kjo është e rëndësishme si për të shmangur rreziqe shkeljeje të lirisë së shprehjes, si dhe për të garantuar se objekti i veprës penale ecën paralelisht me zhvillimet teknologjike lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, rekomandimi 10 thekson rrezikun e veprave penale të cilat keqpërdoren nëpër procedime të cilat shënjestrojnë kritikën ndaj politikave zyrtare, opozitën politike apo besimet fetare në vend të përdorimit faktik të gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, rekomandimi njuh rëndësinë e mundësisë së pjesëmarrjes në procedimet përkatëse të personave të shënjestruar nga një përdorim i posaçëm i gjuhës së urrejtjes.

172. Rekomandimi 10 thekson nevojën për të pasur sanksione ndaj veprave penale të cilat tregojnë se do të shkaktohen pasoja të rënda pas përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Në të njëjtën kohë, thekson nevojën për të pasur në çdo penalitet ndaj një rasti të posaçëm reflektimin e parimit të proporcionalitetit pasi nëse kjo nuk realizohet atëherë mund të shkaktohet nga vetë dhënia e penaltetit një shkelje e së drejtës së lirisë së shprehjes. Megjithëse, rekomandimi 10 parashikon dhënien e sanksioneve penale në rrugë përjashtimore, ai njuh gjithashtu se dhënia e tyre në rrethana të përshtatshme nuk duhet të vështirësohet nga mangësi në kryerjen e hetimeve apo procedimeve. Kjo thekson nevojën për efikasitet në monitorimin e dhënies së sanksioneve. Efikasiteti mund të sjellë shpesh hapësira për bashkëpunim dhe bashkërendim të mirë ndërmjet autoriteteve të përfshira (përfshirë ato në Shtete të tjera) dhe atyre që punojnë për to pasi të trajnohen në mënyrë të përshtatshme, dhe rekomandimi 10 thekson këto çështje si të rëndësishme për vëmendje të veçantë nga ana e Shteteve anëtare.

Rrethana që kërkojnë përgjegjësi penale

173. Faktorët e rëndësishëm në një rast të posaçëm të përdorimit të gjuhës së urrejtjes të cilët tregojnë se është arritur **pragu i përgjegjësisë penale** evidentohen kur përdorimi në fjalë shfaq natyrë të rëndë – konkretisht, përdoret qëllimisht apo, në mënyrë të arsyeshme, parashikohet se mund të nxisë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi – dhe ai zhvillohet në një kontekst publik. Sikundër shprehur qartë dhe në paragrafët më lart të cilët japin përkufizimin e gjuhës së urrejtjes⁹², faktori i mëparshëm shkon përtej formulimit të përdorur në pikën 18 a-f të Rekomandimit nr. 7 të Politikës së Përgjithshme i cilin parashikon përgjegjësinë e përcaktuar nëse ka elemente të pakujdesisë ndaj dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit si pasojë e një përdorimi të posaçëm të gjuhës së urrejtjes dhe jo vetëm atëherë kur përdorimi është i qëllimshëm. Për më tepër, megjithëse kërcënimet – përkundrajt sjelljeve të tjera të mbuluara nga Rekomandimi nr. 7 i Politikës së Përgjithshme nuk duhet të jenë bërë detyrimisht në publik për qëllimet e ngarkimit me përgjegjësi penale, rekomandimi 10 kërkon një kontekst publik për përdorimin e gjuhës së urrejtjes për ngarkimin e përgjegjësisë penale.
174. Kjo është çështje e trajtuar në mënyrë të posaçme në legjislacionin penal të secilit Shtet anëtar për mënyrën se si kjo përgjegjësi do të ngarkohet. Në veçanti, ndonjëherë mund të mbështetet në **dispozita me karakter më të përgjithshëm**, sikundër janë ato që lidhen me fyerjen, në vend të mbështeten në ato specifike për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, është tepër themelore që, përveç përputhshmërisë me dy faktorët e diskutuar më lart, të ekzistojnë një apo disa dispozita të cilat mundësojnë ngarkimin me përgjegjësi penale për secilin prej elementeve të ndryshme që përbëjnë gjuhën e urrejtjes sipas qëllimit të Rekomandimit. Lidhur me këtë, kujtojmë se ciklet monitoruese kanë treguar se kjo nuk ka qenë gjithmonë kështu sa i takon përgjegjësi penale për aktet e ndryshme referuar në pikën 8 të Rekomandimit nr. 7 të Politikës së Përgjithshme. Si pasojë e boshllëqeve në legjislacion, ka pasur raste në të cilat nuk ka qenë e

⁹² Shih pikat 14-18 më lart.

mundur të procedohen persona të cilët janë shfaqur duke kryer disa prej këtyre akteve. Për më tepër, është e rëndësishme që, nëse veprat penale të tjera përveç atyre që lidhen specifikisht me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, përdoren si bazë në procedime lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, të mos të dobësohet rëndësia e sjelljes së përdorur si në terma të këndvështrimit ndaj një sjellje të rëndë dhe në terma të nivelit të sanksionit që mund të jepet. Megjithëse sanksionimi për përdorim të rëndë të gjuhës së urrejtjes është i dëshirueshëm në vetvete, kjo masë ka një përfitim shtesë pasi në thelb nuk është e pranueshme në një shoqëri demokratike. Ky përfitim nuk duhet, për pasojë, të humbasë duke e kualifikuar sjelljen në mënyrë të papërshtatshme.

Hartimi i veprave penale

175. Nevoja për të siguruar se dispozitat përkatëse janë hartuar në mënyrë të qartë dhe të saktë ka një rëndësi themelore. Pa **qartësinë dhe saktësinë** në fjalë, do të ketë me shumë mundësi mungesë të qartësisë ligjore në objektin e sjelljes së ndaluar. Këtu do të mbështeten si pasojë ankesat lidhur me ndërhyrje në lirinë e shprehjes e cila nuk përcaktohet me ligj dhe në këtë mënyrë – pavarësisht se dhënia e një sanksioni penal do të ishte në koherencë me të drejtën e lirisë së shprehjes – do të gjenden shkelje të Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (si dhe potencialisht të ndalimit, sipas nenit 7, të dhënies së një dënimi pa ligj). Ndaj, në hartimin e dispozitave përkatëse, duhen marrë rregullisht në konsideratë përkufizimet e dhëna më lart për termat e ndryshme të përdorura në kuptimin e çfarë përbën gjuhë urrejtjeje sipas qëllimeve të Rekomandimit⁹³.
176. Për më tepër, vëmendje e veçantë duhet kushtuar në momentin e hartimit të dispozitave përkatëse të cilat përcaktojnë qartazi **çfarë konsiderohet e përshtatshme për dhënien e sanksioneve penale** në një përdorim të caktuar të gjuhës së urrejtjes. Këto konsiderata lidhen me faktin (a) nëse ekziston faktikisht një qëllim për të nxitur akte dhune, frikësimi, armiqësi apo diskriminimi apo nëse ka gjasë që këto të fundit të nxiten⁹⁴ dhe (b) nëse ka mjete të tjera më pak kufizuese por gjithsesi efikase për t'u përgjigjur ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes (sikundër ngarkimi me përgjegjësi civile dhe administrative⁹⁵).
177. Gjithashtu, në hartimin e dispozitave përkatëse, është themelore **të shmanget vendosja e kushteve të mëtejshme** për ngarkimin e përgjegjësive penale veç atyre që janë tashmë vendosur, si për shembull prishja e rendit publik, masa e audiencës për gjuhën e urrejtës së përdorur apo masa e përhapjes së kësaj të fundit. Këto kushte mund të jenë shumë të rëndësishme në vlerësimin e rrezikut për ndonjë nxitje e cila mund të paraprihet në mënyrë të arsyeshme, por detajimi i tyre specifik si elemente që sigurojnë përgjegjësi penale është venë re në ciklet monitoruese se përbën një pengesë shtesë në dhënien e dënimeve.
178. Në përfundim, megjithëse qartësia dhe saktësia janë themelore, gjuha e veçantë e përdorur në format e ndryshme të shprehjes përmes së cilës përdoret dhe gjuha e urrejtjes duhet të jenë mjaftueshëm të gjera për **t'ju përshtatur zhvillimeve teknologjike**. Për këtë arsye, gjuha nuk duhet të varet nga forma të njohura të shprehjes (si për shembull shprehja në shtyp apo në rrjete sociale) por duhet të

⁹³ Shih pikat 8-21 më lart.

⁹⁴ Shih të dhënat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në *M'Bala M'Bala kundër Francës* (vendimi), nr. 25239/13, 20 tetor 2015 sipas të cilave një shfaqje e pafytyrë e urrejtjes dhe antisemitizmit të fshehura nga një produksion artistik ishin po aq të rrezikshëm sa një sulm i drejtpërdrejtë dhe i papritur për këtë arsye dhe nuk meritonin mbrojtje sipas Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁹⁵ Shih të dhënat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në *Lehideux dhe Isorni kundër Francës* [Dhomë e Madhe], nr. 24662/94, 23 shtator 1998 sipas të cilave, "duke konsideruar se ekzistojnë mjete të tjera të ndërhyrjes dhe kundërshtimit, veçanërisht nëpërmjet mjeteve juridike civile" (pika 57), një dënim penal ishte në shpërpjesëtim.

fokusohet më shumë në natyrën thelbësore të shprehjes dhe në këtë mënyrë të ketë mundësi të përfshijë dhe forma të tjera që mundet të lindin rishtazi.

179. Përpos ngarkimit me përgjegjësi penale bazuar në sa më lart, do duhej të jepeshin dhe **disa baza shtesë lidhur me përgjegjësinë**. Këto baza janë ato të përcaktuara në pikat 18g dhe 20 të Rekomandimit nr.7 të Politikës së Përgjithshme, konkretisht ngarkimi me përgjegjësi për krijimin apo udhëheqjen e një grupi i cili promovon apo mbështet përdorimin e gjuhës së urrejtjes, pjesëmarrjen në aktivitete të një grupi të tillë me qëllim dhënien e një kontributi në përdorimin e gjuhës së urrejtjes për të cilin mund të jepen sanksione penale dhe nxitjen, ndihmën apo inkurajimin me dashje të përdorimit të gjuhës së urrejtjes apo tentativës së përdorimit të saj. Ngarkimi me përgjegjësi për këto raste do të reflektonte si frymën e kuptimit të qëllimit të Rekomandimit si dhe përgjegjësinë për veprime jo koherente të cilat normalisht përcillen me kryerjen e veprave penale. Gjithashtu, sipas pikat 22 të Rekomandimit nr. 7 të Politikës së Përgjithshme, duhet përcaktuar në mënyrë të qartë se përgjegjësia penale në fjalë mund të lind si për persona juridikë dhe për persona fizikë. Potenciali i përgjegjësive së personit juridik është i rëndësishëm pasi organizimet në korporata mund të jenë mjet për përhapjen e gjuhës së urrejtjes⁹⁶.

Masa për të parandaluar procedime abuzive

180. Rekomandimi 10 merr në konsideratë shqetësimin e shprehur edhe më parë lidhur me rrezikun e përgjegjësive penale që mund në mënyrë të pajustificuar të **përdoret për të shtypur kritikën ndaj politikave zyrtare, opozitën politike dhe besimet fetare**^{97,98}. Papranueshmëria e një përdorimi të tillë duhet të jetë i dukshëm në kushtet e përcaktuara më lart për ngarkimin me përgjegjësi penale. Megjithatë, do të ishte e përshtatshme të përforcohej kjo pikë duke përfshirë në legjislacionin përkatës, një përcaktim të qartë sipas të cilit veprat penale nuk zbatohen për kritika, për opozitën apo për besimet. Për më tepër, duke konsideruar shqetësimet e lidhura me ndalimin e gjuhës së urrejtjes i përdorur në mënyrë të shpërpjesëtuar kundër atyre që në fakt janë për t'u mbrojtur⁹⁸, do ishte e përshtatshme të zhvilloheshin disa udhëzime për oficerët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët për të tërhequr vëmendjen ndaj këtij rreziku potencial dhe të kërkohej një vlerësim me bazë periodike për të parë nëse ka ndryshime në qasje për inicimin e procedimeve penale sipas karakteristikave specifike të të akuzuarve për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Objektivi duhet të ishte garantimi se këto karakteristika nuk kanë pasur ndikim në ngritjen e procedimeve në fjalë.

Përfshirja e personave të shënjestruar

181. Rekomandimi 10 nënvizon gjithashtu rëndësinë e mundësisë së **pjesëmarrjes efektive** të personave të shënjestruara nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në çdo procedim penal të ngritur lidhur me këtë përdorim. Kjo pjesëmarrje duhet të ekzistojë nga faza e hetimit për pasojë të një ankese deri në përfundim të procedimit në gjykatë. Rëndësi të veçantë ka informimi ndaj këtyre personave rreth ecurisë së një hetimi dhe të çdo vështirësie të hasur në këtë fazë. Për më tepër, ata duhet të kenë mundësi të sjellin komente përpara lëshimit të çdo vendimi për

⁹⁶ Ndaj, për shembull, në *Sürek kundër Turqisë* (nr. 1) [Dhomë e Madhe], nr. 26682/95, 8 korrik 1999 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk pranoi arsyetimin sipas të cilit pronari i revistës duhet të përjashtohet nga çdo përgjegjësi penale për përmbajtjen e shkresave që ka botuar bazuar në faktin se kishte vetëm një marrëdhënie tregtare dhe jo redaksie me të. Në këndvështrim të tij, pronari ka pasur, për shkak se pronar, kompetenca për t'i dhënë formë drejtimit të redaksisë së revistës dhe në këtë mënyrë "ishte tërthorazi subjekt i "detyrimeve dhe përgjegjësive" të ndërmarra nga personeli i redaksisë dhe gazetarisë në grumbullimin dhe përhapjen e informacionit ndaj publikut, i cili merr edhe më shumë rëndësi në situatë të konfliktit dhe tensionit" (pika 63).

⁹⁷ Shih pikën 62-64 më lart.

⁹⁸ Shih pikën 64 më lart.

pushimin e hetimit apo rrëzimin e akuzave që janë bërë kundër dikujt për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Ky fakt është jetik jo vetëm për të siguruar se autoritetet përkatëse kanë gjithë informacionet materiale lidhur me vendimin në fjalë por edhe për të dhënë besueshmëri ndaj atyre të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes përgjatë gjithë hallkave të funksionimit të sistemit të drejtësisë. Për më tepër, personat e shënjestruara nga gjuha e urrejtjes duhet të njoftohen në kohë të përshtatshme për çdo dëgjuesë në gjykatë dhe dinjiteti tyre duhet të sigurohet kur ata japin prova në cilësinë e dëshmitarëve. Për atë kohë sa mund të paraqitet nga një individ një ankesë për sulme kundër nderit të një personi apo për shpifje, është gjithashtu e rëndësishme të ketë qartësi mbi personin që ka kompetenca për të iniciuar një procedim penal. Për më tepër, rregullat për iniciimin e procedimit duhet të zbatohen në mënyrë koherente.

Penalitetet

182. Në **përcaktimin dhe dhënien e penaliteteve të posaçme** pas një dënimi për përdorim të gjuhës së urrejtjes, rekomandimi 10 identifikon dy pika të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë, konkretisht, pasojat e rënda që rrjedhin nga përdorimi dhe parimi i proporcionalitetit.
183. Ky i fundit përfshin jo vetëm personat që vuajnë pasi janë në shënjestër e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, por edhe ndikimin e përdorimit tek të tjerët në grupin e personave ku ata përkasin dhe efektet e dëmeve që mund të ketë në përgjithësi në kohezionin social. Penalitetet specifike në dispozicion do duhet të reflektojnë rëndësinë e këtyre pasojave. Ndaj duhet të jenë – sipas pikat 23 të Rekomandimit nr. 7 të Politikës së Përgjithshme – si **efikase dhe dekurajuese** në mënyrë që të reflektojnë dëmin e kryer dhe të dekurajojnë shkaktimin e përsëritur të tij. Këto penalitete mund të përfshinë burgimin apo vendosjen e gjobave, si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e publikimeve të përfshira. Megjithatë, ato mund edhe të jepen duke u bazuar në sjelljen objekt të procedimit. Në këtë mënyrë, për shembull, mund të parashikohet një humbje e përkohshme të të drejtave politike, një kusht për të vizituar një apo më shumë përmendore të Holokaustit apo një kusht për të ndërmarrë disa forma të zhdëmtimit praktik të grupit të shënjestruar nga përdorimi i posaçëm i gjuhës së urrejtjes.
184. Megjithatë, dhënia faktike e sanksioneve duhet gjithashtu të marrë në konsideratë rrezikun se një penalitet i veçantë – sipas rrethanave specifike të faktit - mund të sjellë një **ndërrhyrje të papërshtatshme me lirinë e shprehjes**. Megjithëse asnjë kundërshtim në parim nuk është ngritur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ndaj dhënies së gjobave, vendimeve të burgimit, konfiskimeve apo humbjes së të drejtave politike⁹⁹, dhënia e së paku dy të parave ka shërbyer si bazë për të konkluduar se në disa raste ka pasur ndërrhyrje të shpërpjesëtuara në lirinë e shprehjes¹⁰⁰. Qartazi, çdo rast duhet trajtuar sipas meritave përkatëse por vendimet për burgim dhe gjobat e larta ka mundësi mos të konsiderohen si penalitete në përputhje me të drejtën e lirisë së shprehjes sipas Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përveç rastit kur lidhen me një

⁹⁹ Shih, për shembull, *Zana kundër Turqisë* [Dhomë të Madhe], nr. 18954/91, 25 nëntor 1997 (një vit burgim), *Hennicke kundër Gjermanisë* (vendimi), nr. 34889/97, 21 maj 1997, *Sürek kundër Turqisë* (nr. 1) [Dhomë e Madhe], nr. 26682/95, 8 korrik 1999

("një gjobë relativisht modeste"; pika 64), *Incal kundër Turqisë* [Dhomë të Madhe], nr. 22678/93, 9 korrik 1998 (konfiskim, megjithëse nuk zbatohet në këtë rast) dhe *Féret kundër Belgjikës*, nr. 15615/07, 16 korrik 2007 (humbje e së drejtës për t'u paraqitur në zgjedhje për dhjetë vjet por gjyqtari kundërshtues u shpreh duke thënë së i dukej e shpërpjesëtuara).

¹⁰⁰ Shih, për shembull, *Karataş kundër Turqisë* [Dhomë e Madhe], nr. 23168/94, 8 korrik 1999 (burgim një vit, një muaj dhe dhjetë ditë, me gjobë në monedhën TRL 111,111,110), *Aydın Tatlav kundër Turqisë*, nr. 50692/99, 2 maj 2006 (gjobë në monedhën TRL 2, 640, 000) dhe *Sürek dhe Özdemir kundër Turqisë* [Dhomë e Madhe], nr. 23927/94, 8 korrik 1999 (sekuestrim të kopjeve të rivitës në të cilën janë shfaqur botimet e kundërshtuara).

përdorim shumë të rëndë të gjuhës së urrejtjes. Në të kundërt, gjopa relativisht të ulëta por jo të papërfillshme dhe penalitete të tjera të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim të sjelljes – sikundër kushti për të ndërmarrë disa punë në favor të personave të shënjestruara nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes – nuk do të konsiderohen si në shpërpjesëtim dhe nuk do të kundërshtohen në shumicën e rasteve.

Sigurimi i efikasitetit të hetimeve dhe procedimeve

185. Rëndësia e Rekomandimit 10 për monitorimin e efikasitetit të **hetimeve të ankesave dhe procedimeve të subjekteve të veprave penale** shënohet nga mangësitë e gjetura në këtë drejtim gjatë cikleve monitoruese. Pavarësisht disa rasteve ku janë dhënë masa efikase në zbatimin e ligjit kundër atyre që përdorin gjuhën e urrejtjes, ka pasur dhe shumë raste në të cilat veprimet penale janë gjykuar në mënyrë shumë të thjeshtuar, duke pasur si pasojë që shumë pak nga rastet e iniciuara nga një ankesë ndaj autoriteteve ka mbërritur deri në gjykatë. Për më tepër, kur rastet janë sjellë në fakt përpara gjykatës, normat e dënimit faktik duken shpesh të ulëta dhe penalitetet specifike të dhëna nuk janë gjithmonë të përpjesëtuara me përdorimin e gjuhës së urrejtjes në fjalë. Ka disa faktorë që qëndrojnë pas këtij suksesi të kufizuar në dukje në përdorimin e legjislacionit penal për të luftuar gjuhën e urrejtjes kur në fakt përdorimi i tij do ishte një përgjigje e përshtatshme. Në faktorët përfshihen: (a) mangësi nga ana e disa oficerëve të policisë për të marrë këto vepra penale seriozisht dhe për të vepruar në mënyrë të shpejtë; (b) mungesë në kompetenca për të grumbulluar dhe për të pasur akses në prova; (c) një këndvështrim tepër të zgjeruar lidhur me mbrojtjen e së drejtës së lirisë së shprehjes (gjë e cila nuk është në përputhje me qasjen e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe/ose një interpretim tepër të ngurtë të atyre elementeve që përbejnë një vepër penale (si për shembull nxitja ndaj urrejtjes); (d) tentativa të pasuksesshme për të përcaktuar kushte për dhënien e një dënimi të cilat nuk janë të zbatueshme më; (e) moskryerja e një hetimi të mjaftueshëm, sistematik dhe efikas për përdorimin e gjuhës së urrejtjes; (f) dedikimi i burimeve për hetimin e fundamentalistëve fetarë në vend të ekstremistëve të motivuar nga racizmi dhe aspekte të tjera të gjuhës së urrejtjes; (g) mosmarrëveshje territoriale për cilin autoritet ka kompetenca mbi një rast të caktuar; (h) ri-klasifikimi i veprave penale si vepra penale të zakonshme në mënyrë që mos të paragjykohe personat e shënjestruara në arritjen e normave të suksesshmërisë në dhënien e dënimeve; (i) imuniteti i gëzuar nga politikanët; dhe (j) një mungesë e mundshme e paanshmërisë mes anëtarëve të jurisë që përcakton rastet.
186. Disa nga këto mangësi kanë funksionuar edhe si bazë për gjetjen e shkeljeve nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial të Nenit 4 dhe 6 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Gjithë Formave të Diskriminimit Racial. Në veçanti, janë përfshirë mungesa e hetimit të ankesave me kujdesin e duhur dhe në mënyrë të shpejtë¹⁰¹ dhe mos-marrja në konsideratë e kufizimeve ndaj së drejtës për lirinë e shprehjes¹⁰².
187. Gjithë këto mangësi lidhur me trajtimin e ankesave rreth përdorimit të gjuhës së urrejtjes të cilat mund të përbëjnë gjuhë të urrejtjes japin në mënyrë të pashmangshme një mesazh të fortë ndaj publikut duke treguar se **gjuha e urrejtjes nuk po merret seriozisht** dhe mund të përdoret duke mos u ndëshkuar.

¹⁰¹ *L K kundër Holandës*, Komunikimi nr. 4/1991, Opinion i datës 16 mars 1993, *Gelle kundër Danimarkës*, Komunikimi Nr. 34/2004, Opinion i datës 6 mars 2006, *Adan kundër Danimarkës*, Komunikimi Nr. 43/2008, Opinion i datës 13 gusht 2010 dhe *TBB-Unioni Turk në Berlin /Brandenburg kundër Gjermanisë*, Komunikimi Nr. 48/2010, Opinion i datës 26 shkurt 2013.

¹⁰² *Komuniteti Hebre i Oslo-s et al. kundër Norvegjisë*, Komunikimi Nr. 30/2003, Opinion i datës 15 gusht 2005. dhe *TBB-Unioni Turk në Berlin/Brandenburg kundër Gjermanisë*, Komunikimi Nr. 48/2010, Opinion i datës 26 shkurt 2013.

Për këtë arsye nuk mjafton të vendosen vepra penale lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Lind nevoja për të monitoruar në mënyrë të kujdesshme dhe të vazhdueshme mënyrën se si ankesat rreth përdorimit të akuzuar të saj merren në hetim, procedohen apo gjykohen në mënyrë që të mund të kryhen rregullime të përshtatshme në qasjen e ndjekur dhe me qëllim që të sigurohet se procedimet regjistroheshin dhe dënimet sigurohen në të gjitha rastet e përshtatshme.

188. **Qëllimi themelor i çdo hetimi** duhet të jetë sigurimi i zbatimit efikas të ligjit përkatës dhe sigurimi i vënies para drejtësisë së personave përgjegjës për kryerjen e veprës penale përkatëse. Ky hetim duhet të ndërmerret pasi një çështje silltet në vëmendje të autoriteteve dhe në këtë mënyrë nuk varet domosdoshmërisht nga një ankese zyrtare. Kjo është diçka me rëndësi të veçantë në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes pasi personat e shënjestruara nga ky përdorim mund të jenë të frenuar për të paraqitur ankesa. Çdo hetim duhet të kryhet në mënyrë të përshtatshme pasi duhet të sigurojë se ekziston mundësia për të përcaktuar nëse një vepër penale është kryer apo jo dhe të identifikohen personat përgjegjës. Duhet ndërmarrë gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar provat, përfshirë dëshmi me dëshmitarë okularë dhe dokumente përkatëse apo materiale elektronike. Kjo duhet të kryhet në mënyrë të menjëhershme dhe me shpejtësi të arsyeshme. Për më tepër, është nevoja të sigurohet se hetimi dhe rezultatet e tij janë subjekte të verifikimit publik në mënyrë që të garantohet dhënia e llogarisë dhe ruajtja e besimit të publikut. Kjo përfshin – sikundër referuar më parë¹⁰³ – informimin e vazhdueshëm të çdo ankuesi lidhur me ecurinë e hetimeve dhe dhënia e mundësisë së referimit të komenteve përpara marrjes së një vendimi për ta përfunduar atë apo për të rrezuar akuzat. Në përfundim, përfundimet e hetimit dhe vendimi i çdo procedimi duhet të bazohen mbi një analizë gjithëpërfshirëse, objektive dhe të paanshme të të gjithë materialit në dispozicion.
189. **Qasjet për të nxitur hetimin dhe procedimin efikas** të përdorimit të gjuhës së urrejtjes përfshijnë: (a) përdorimin e një mjeti i cili lejon sinjalizimin *online* të përdorimit të gjuhës së urrejtjes; (b) analizë të rregullt të ndjekjes së ankesave për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga momenti i regjistrimit të tyre nga ana e policisë për të vlerësuar nëse ankesat e paraqitura kanë marrë përgjigjen e duhur; (c) ndërmarrje të një monitorimi sistematik të përdorimit *online* të gjuhës së urrejtjes në mënyrë që hetimet mos të bazohen vetëm në ankesa; (d) krijimin e një njësie me specialistë që të ketë burime teknike dhe njerëzore të përshtatshme me kompetenca për hetim dhe procedim të rasteve që përfshijnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes; (e) një përgjigje të qëndrueshme për rastet në të cilat politikanët dhe personalitetet e tjera publike përdorin gjuhën e urrejtjes në mënyrë që anëtarët e publikut të gjerë të mos të ndihen të inkurajuar për të ndjekur shembuj të tillë; (f) heqja e çdo imuniteti për politikanë lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes; dhe (g) zhvillimi i dialogut, besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë me grupe personash të cilët janë të shënjestruar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në mënyrë që të fitojnë besimin në vetvete dhe të rritet ndërgjegjësimi për të drejtat e tyre.
190. Rekomandimi 10 njuh gjithashtu se efikasiteti i procedimeve të iniciuara lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes varet edhe nga tre faktorë të tjerë.
191. Së pari, palë të interesuara të ndryshme – dhe veçanërisht policia dhe autoritetet kompetente të procedimeve – duhet të jenë të organizuara në mënyrë të mirë dhe të përshtatshme për **bashkëpunim dhe bashkërendim** të aktiviteteve të tyre individuale. Ka disa mënyra më të cilat këto mund të arrihen. Megjithatë, bashkëpunimi dhe bashkërendimi në fjalë do të arrihen në mënyrë më të lehtë përmes krijimit të kanaleve të komunikimit të mirë ndërmjet autoriteteve. Gjithashtu, duhet të ekzistojë një orientim i përbashkët nga ana e atyre në pozicion

¹⁰³ Shih pikën 179 më lart.

udhëheqës që përcakton se kryerja e punës së bashku në trajtimin e përdorimit e gjuhës së urrejtjes në procedime penale – nëse e përshtatshme – është një prioritet i lart për çdo autoritet të përfshirë.

192. Së dyti, të gjithë palët e përfshira në sistemin e drejtësisë penale duhet të kenë **trajtime të përshtatshme** në mënyrë që ata të kenë mundësi të përcaktojnë nëse një vërejtje e caktuar përfshin apo jo përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe, nëse ky është rasti, të përcaktojnë nëse – duke konsideruar të drejtën e lirisë së shprehjes – dhënia e një sanksioni penal do të përbënte një përgjigje të përshtatshme. Për më tepër, trajnimet në fjalë duhet të pajisin personat e interesuar me një vlerësim më të përgjithshëm rreth ndikimit ndaj personave të shënjestruar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe rrezikut të përdorimit të tillë për shoqërinë në tërësinë e saj. Për më tepër, varësisht përgjegjësive të tyre individuale, duhen kryer disa përpjekje për të nxitur aftësitë e tyre në grumbullimin dhe vlerësimin e çdo prove për iniciimin dhe gjykimin e një procedimi penal lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Për më tepër, duhet parashikuar një udhëzim për gjyqtarët lidhur me qasjen që duhet të kenë në përcaktimin e penalteteve të veçanta të cilat do të jepen pas dënimit. Në të gjitha rastet, trajnimet në fjalë dhe zhvillimi i kapaciteteve do të nxitet më shumë me shkëmbimin e praktikave më të mira, veçanërisht kur disa palë të interesuara në sistemin e drejtësisë penale kanë më shumë eksperiencë se sa të tjerë në trajtimin e rasteve që përfshijnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes.
193. Së treti, përhapja e gjuhës së urrejtjes nuk kufizohet brenda kufijve kombëtare të vendit. Për pasojë, procedimet lidhur me të mund ndonjëherë të vështirësohen për shkak se mund të lindin jashtë territorit dhe juridiksionit të një Shteti anëtar të caktuar. Kjo ndodh veçanërisht me përhapjen që ndodh *online*. Është i njohur fakti se nuk ka zgjidhje të thjeshta në këto raste, veçanërisht kur serverët e internetit mund të ndodhen në shtete të cilat nuk kanë kushte të tilla që rregullojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes sikundër në Rekomandim. Megjithatë, bashkëpunimi me autoritetet në këto shtete mund të sjellë veprime të shpejta për kufizimin e kapacitetit të **përhapjes ndërkufitare**. Për më tepër, ky bashkëpunim mund të sjellë informacione të cilat mund të mundësonin iniciimin e çdo procedimi penal të përshtatshëm kundër atyre personave në Shtetet anëtare të përfshira të cilat kanë pasur një rol në përhapjen në fjalë. Për këtë arsye është themelore që gjithë Shtetet anëtare – duke ndjekur shembullin e disa prej tyre – të krijojnë mekanizma rregullues të përshtatshëm për të lehtësuar bashkëpunimin lidhur me përdorimin ndërkufitar të gjuhës së urrejtjes i cili përfshin jo vetëm secilin prej këtyre shteteve por edhe çdo Shtet jo-anëtar të Këshillit të Evropës i cili është i përgatitur për t'ju bashkuar përpjekjeve në përballimin e përhapjeve të tilla.

Shtojca

Rekomandimet në vijim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Rekomandimet dhe Rezolutat të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës lidhur me përdorimin e gjuhës së urrejtjes janë miratuar:

Komiteti i Ministrave

Rekomandimi Nr. R (92) 19 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me video-lojërat me përmbajtjes raciste;

Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me "Gjuhën e Urrejtjes";

Rekomandimi Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me median dhe promovimin e kulturës së tolerancës;

Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

Asambleja Parlamentare

Rekomandimi 1277 (1995) Migrantët, minoritetet etnike dhe mediat;

Rekomandimi 1543 (2001) Racizmi dhe ksenofobia në hapësirën kibernetike;

Rekomandimi 1706 (2005) Media dhe terrorizmi;

Rekomandimi 1768 (2006) Imazhi i azilkërkuesve, migrantëve dhe refugjatëve në media;

Rekomandimi 1805 (2007) Blasfemia, fyerjet fetare dhe gjuha e kundër personave në bazë të fesë së tyre;

Rekomandimi 2052 (2014) Kundërveprim ndaj manifestimeve neo-Naziste dhe ekstremizmit të së djathtës.

Rezoluta 1345 (2003) Fjalimi racist, ksenofob dhe intolerant në politikë;

Rezoluta 1510 (2006) Liria e shprehjes dhe respekti për besimet fetare;

Rezoluta 1563 (2007) Luftimi i antiSemitizmit në Evropë;

Rezoluta 1577 (2007) Drejt dekriminalizimit të shpifjes;

Rezoluta 1605 (2008) Komunitetet myslimane evropiane të përballuara me ekstremizmin; Rezoluta 1728 (2010) Diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor;

Rezoluta 1743 (2010) Islami, Islamizmi dhe Islamofobia në Evropë;

Rezoluta 1754 (2010) Lufta kundër ekstremizmit: arritje, mangësi dhe dështime;

Rezoluta 1760 (2010) Rritja rishtazi e fjalimit mbi sigurinë kombëtare në Evropë: rasti i Romëve;

Rezoluta 1846 (2011) Luftimi i gjithë formave të diskriminimit me bazë fetare;

Rezoluta 1877 (2012) Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe informacionit në internet dhe mediat *online*;

Rezoluta 1928 (2013) Ruajtja e të drejtave të njeriut lidhur me fenë dhe besimin, dhe mbrojtja e komuniteteve fetare nga dhuna;

Rezoluta 1948 (2013) Përballimi i diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor;

Rezoluta 1967 (2014) Një strategji për parandalimin e racizmit dhe intolerancës në Evropë;

Rezoluta 2011 (2014) Kundërveprimi ndaj manifestimeve të neo-Nazizmit dhe ekstremizmit të djathtë;

Rezoluta 2069 (2015) Njohja dhe parandalimi i neo-racizmit.

Translation co-funded
by the European Union



Ky përkthim është prodhuar me fondet e Projektit “Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri” në kuadër të Instrumentit Horizontal II, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu, në asnjë rast nuk mund të pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.